



STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM

2024-2044





Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2024-2044 përcakton një drejtim të qartë për zhvillimin afatgjatë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për herë të parë, vendi ynë fiton një dokument që rezulton nga një proces që përfshin një spektër të gjerë aktorësh – qytetarë, ekspertë, akademikë, komunitetin e biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Me kontributet e tyre, strategjia i zbulon sfidat me të cilat përballemi dhe ofron drejtime konkrete për tejkalimin e tyre.

Dokumenti bazohet edhe në një konsensus më të gjerë shoqëror, që është arritur përmes bashkëpunimit ndërmjet sektorëve dhe subjekteve të ndryshme politike. Pikërisht kjo hapje ndaj opinionëve të ndryshme ka kontribuar për krijimin e një kornize strategjike që përfshin zhvillimin ekonomik, stabilitetin shoqëror, revitalizimin demografik, tranzicionin e gjelbër, si dhe forcimin e kapitalit njerëzor dhe të kapaciteteve novatore.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim nuk është paramenduar si një dokument që do të ekzistojë vetëm në letër. Përmbajtja e saj përfshin mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie. Në këtë mënyrë, përcaktimet strategjike duhet të shndërrohen në politika dhe iniciativa afatgjata që do të zbatohen nga qeveritë e ardhshme, institucionet dhe aktorët shoqërorë.

Edhe pse strategjia përmban qëllime ambicioze, ne jemi të vetëdijshëm se realizimi i saj kërkon kohë, burime dhe koordinim. Megjithatë, me përpjekje të përbashkëta dhe përkushtim të vazhdueshëm, besojmë se mund të vendoset një themel më i fortë për përparim ekonomik dhe për një cilësi më të mirë të jetës për të gjithë qytetarët.

Përgatitja e kësaj strategjie është pjesë e angazhimit tonë për një qasje të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në planifikimin e së ardhmes së vendit. Shpresoj se ajo do të kontribuojë për stabilitet, zhvillim dhe mundësi më të mëdha për çdo qytetar, si dhe për zhvillimin konsekuent të politikave publike në dy dekadat e ardhshme.

Me respekt,

Prof. Dr. Hristijan Mickoski

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkup, janar 2025



Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2024-2044 nuk është vetëm një dokument vizionar, por edhe simbol i unitetit dhe synimit të përbashkët të të gjithë neve – ndërtimit të një Maqedonie më të fortë, më të zhvilluar dhe më të suksesshme. Kjo strategji nuk është vetëm rezultat i analizave teknike dhe të dhënave statistikore, por është një pasqyrë e gjallë e dëshirave, nevojave dhe aspiratave të çdo qytetari. Ajo e pasqyron gjithëpërfshirjen e vërtetë, gjë që e bën atë unike dhe autentike.

Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë me shumë përkushtim dhe profesionalizëm luajti një rol kyç në përgatitjen e strategjisë dhe në përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara. Që nga fillimi e deri në tekstin përfundimtar, strategjia u ndërtua përmes një procesi transparent dhe të hapur, në të cilin morën pjesë më shumë se 200 përfaqësues nga ministritë, mbi 60 deputetë dhe kryetarë komunash, më shumë se 1.000 të rinj, mbi 100 organizata të shoqërisë civile, si dhe institucione të shumta akademike dhe kërkimore dhe përfaqësues nga sektori i biznesit.

Rezultati i këtij konsultimi të gjerë është konsensusi për vizionin tonë të përbashkët – përparimi që do ta formësojë të ardhmen e Maqedonisë në dy dekadat e ardhshme. Strategjia kombëtare për zhvillim hedh themele të reja për një rritje afatgjatë, gjithëpërfshirëse, të fokusuar në qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Në thelbin e kësaj strategjie është vënë përkushtimi për një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse, e cila i përfshin të gjitha palët e interesuara në çdo fazë të zbatimit të saj. Krijimi i një strukture operacionale, e cila do t'i bashkojë institucionet shtetërore, përfaqësuesit nga komuniteti akademik, sektori i shoqërisë civile dhe subjektet afariste, është garanci për realizimin efektiv të synimeve ambicioze. Gjithëpërfshirja dhe konsensusi do të mbeten parimi ynë udhëzues, jo vetëm gjatë miratimit të strategjisë, por edhe gjatë zbatimit të saj.

Ne jemi të përkushtuar që këtë proces ta mbajmë transparent dhe pranë qytetarëve. Platforma www.nrs.mk do të vazhdojë të jetë një mjet për informimin e vazhdueshëm, monitorimin dhe pjesëmarrjen aktive të publikut. Duke e zbatuar këtë strategji, ne krijojmë një bazë për përparim afatgjatë dhe një të ardhme më të mirë për të gjithë ne, veçanërisht për fëmijët tanë.

Kjo nuk është vetëm një strategji. Ky është zotimi ynë i përbashkët - të ndërtojmë një Maqedoni më të ndritshme, më të suksesshme dhe më të fortë për të gjithë. Ju ftojme të jeni pjesë e këtij rrugëtimi drejt një qëllimi të përbashkët, sepse së bashku mund të bëjmë më shumë.

Me respekt,

Igor Janushev

Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkup, janar 2025

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
PROCESI DHE METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË SKZH-së.....	9
2. TENDENCAT DHE SFIDAT PËR ZHVILLIMIN AFATGJATË.....	12
3. VIZIONI.....	16
4. QËLLIMET ZHVILLIMORE KOMBËTARE DHE FAKTORËT KRYESORË.....	18
4.1 QËLLIMET ZHVILLIMORE KOMBËTARE.....	18
4.2 FAKTORËT KRYESORË QË MUNDËSOJNË PROSPERITET	21
5. FUSHAT STRATEGJIKE.....	25
5.1. FUSHA STRATEGJIKE: EKONOMI E QËNDRUESHME, NOVATORE DHE KONKURRUESE	25
5.1.1 Misioni.....	29
5.1.2 Qëllimet.....	29
5.2. FUSHA STRATEGJIKE: ZHVILLIM I QËNDRUESHËM LOKAL DHE RAJONAL.....	35
5.2.1 Misioni.....	37
5.2.2 Qëllimet.....	37
5.3 FUSHA STRATEGJIKE: REVITALIZIMI DEMOGRAFIK DHE ZHVILLIMI SOCIAL DHE KULTUROR.....	42
5.3.1 Misioni.....	44
5.3.2 Qëllimet.....	44
5.4. FUSHA STRATEGJIKE: SUNDIMI I SË DREJTËS DHE MENAXHIMI I MIRË	53
5.4.1 Misioni.....	58
5.4.2 Qëllimet.....	58
5.5. FUSHA STRATEGJIKE: SHOQËRI E SIGURT DHE REZISTENTE.....	66
5.5.1 Misioni.....	69
5.5.2 Qëllimet.....	70
5.6. FUSHA STRATEGJIKE – TRANSFORMIMI I GJELBËR.....	75
5.6.1 Misioni.....	76
5.6.2 Qëllimet.....	76
6. PËRGJIGJA E POLITIKAVE – NDRYSHIME SISTEMORE	82
7. KOORDINIMI DHE IMPLEMENTIMI.....	90
8. PROJEKSIONET DHE KORNIZA FINANCIARE.....	95
8.1. PROJEKSIONET	95
8.2. KORNIZA FINANCIARE	98
9. MENAXHIMI ME RREZIQET	102
ANEKS.....	106



HYRJJE

Në bazë të nenit 5 paragrafi (3) të Ligjit për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 30/24), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 29 tetor të vitit 2024, miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2024 – 2044.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) për periudhën 2024-2044 është një dokument udhëheqës me të cilin përcaktohen **qëllimet kryesore zhvillimore, fushat strategjike dhe prioritetet për zhvillim të pershpejtuar, gjithëpërfshirës, të barabartë, me barazi gjinore dhe të qëndrueshëm të Maqedonisë së Veriut.**

Gjithashtu si dokument strategjik dhe zhvillimor, **SKZH-ja i identifikon sfidat kryesore dhe prioritetet shtetërore, veçanërisht duke e marrë parasysh synimin e Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE) deri në vitin 2030 dhe angazhimin për zhvillim të qëndrueshëm të inkorporuar në Agjendën 2030.** SKZH-ja në esencë i përfshin qëllimet kryesore të përcaktuara në dokumentet strategjike të miratuara, por gjithashtu ofron udhëzime për dokumentet dhe politikat e ardhshme strategjike.

Ideja kryesore e SKZH-së është të mundësojë vazhdimësi në planifikimin strategjik dhe përgjigje konsistente ndaj sfidave kryesore, pavarësisht nga orientimi politik.

SKZH-ja është dokument strategjik i cili e përcakton **vizionin për zhvillimin** e Maqedonisë së Veriut e cila në esencë bazohet mbi tre drejtime zhvillimore kombëtare bazike:

1. Forcimi i konkurrencës së ekonomisë, përmes një ekosistemi funksional dhe novator, përmirësimit të shkathtësive, njohurisë, përfshirjes dhe qëndrueshmërisë së qytetarëve;
2. Modele të qeverisjes që janë të hapura, të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe rezistente, të afta të parandalojnë dhe të reagojnë në mënyrë adekuate, duke nxitur prosperitetet për të gjithë grupet shoqërore;
3. Përfshirja sociale, që nënkupton shërbime të përmirësuara sociale, shëndetësore dhe arsimore në drejtim të sigurimit të dobisë për individë, bizneset dhe shoqërinë në tërësi.

Këto qëllime zhvillimore kombëtare planifikohet të realizohen përmes gjashtë fushave strategjike kryesore:



1. Ekonomia e qëndrueshme, novatore dhe konkurruese;
2. Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rajonal, që siguron kohezion;
3. Rivitalizimi demografik, zhvillimi social dhe kulturor;
4. Shoqëria e sigurt dhe rezistente;
5. Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë dhe
6. Transformimi i gjelbër.

Çdo fushë strategjike ka misionin e saj të përcaktuar që përcakton vendin, dedikimin dhe vlerën e saj në SKZH dhe ofron udhëzime për të gjitha palët e interesuara. Gjithashtu, në fushat strategjike janë qëllimet e përcaktuara, të cilat fokusohen në sektorët kryesorë ku nevojitet përparimi thelbësor dhe që janë mbështetur me një sërë vendimesh sistematike. Gjithashtu, SKZH-ja i përcakton edhe prioritetet për realizimin e çdo qëllimi strategjik, të cilat përfshijnë një sërë aktiviteteve, procesesh dhe nismash. Struktura kryesore e SKZH-së është paraqitur në Figurën 1.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe digjitalizimi i shoqërisë janë elemente qendrore dhe janë parakusht kryesor për progresin në çdo fushë strategjike.

Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është që përgatitja e SKZH-së bazohet mbi disa parime kryesore:

- **Partneriteti dhe bashkëpunimi**, gjithëpërfshirje dhe koordinim i vazhdueshëm për të krijuar konsensus për rrugën e zhvillimit të vendit ndërmjet të gjithë faktorëve në shoqëri në të gjitha fazat e përpunimit;
- **Harmonizimi dhe konsistenca** e politikave të krijuara, qëllimeve dhe rezultateve të dokumenteve të planifikimit të vendosura nivel më të ulët në hierarki ;
- **Afatgjatësia**, përcaktimi i parametrave kryesorë afatgjatë drejt të cilëve duhet të lëvizë shteti bazuar në modelin e largpamësisë strategjike për të identifikuar në mënyrë aktive tendencat dhe sfidat e ardhshme;
- **Qasja sistematike**, bashkëpunimi efektiv ndërmjet institucioneve dhe ndërtimi i kapaciteteve me fokus më të madh në strategjitë horizontale (me shumë sektorë);
- **Përshtatshmëria e integruar**, që do të thotë shqyrtimi se tranzicioni, ndryshimi dhe zhvillimi kërkojnë përpjekje të qëndrueshme, fleksibile dhe konsistente nga të gjithë faktorët përkatës në gjithë periudhën kohore;
- **Komplementariteti, integrimi dhe koherenca** e proceseve dhe prioriteteve aktuale dhe të ardhshme në të gjitha segmentet e zhvillimit të shtetit;
- **Qëndrueshmëria** e bazuar mbi tre shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm (komponentët ekonomikë, socialë dhe ekologjikë);
- **Harmonizimi me politikat e Bashkimit Evropian**, që nënkupton se fushat dhe objektivat janë në përputhje me strategjitë, politikat dhe legjislacionin kombëtar të Bashkimit Evropian;
- **Financimi gjithëpërfshirës dhe inkluziv**, promovimi i burimeve novatore dhe të ndryshme të financimit për realizimin e prioriteteve të parapara;
- **Qëndrueshmëria fiskale** e politikave në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë;
- **Relevanca, besueshmëria dhe bazueshmëria** e provave, që do të thotë se realizohet një analizë gjithëpërfshirëse dhe të besueshme e gjendjeve dhe e faktorëve kryesorë, lëvizjet, kushtet dhe rrethanat në të gjitha sferat e veprimtimit dhe
- **Ekonomizimi, efikasiteti dhe efektiviteti**, të cilat supozojnë se për të gjitha qëllimet dhe prioritetet e vendosura janë tregues të përcaktuar përkatës të suksesit.

Këto parime njihen si kryesore edhe për suksesin e realizimit të SKZH-së.

SKZH-ja së bashku me Kornizën për zhvillim MKD 2030, të miratuar nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, plotësohet dhe përbën bazën për progres afatgjatë ekonomik, social, kulturor dhe institucional. Së bashku, ato formojnë një kornizë gjithëpërfshirëse politike dhe sistemore që synon ta orientojë vendin drejt një qasjeje të re dhe ndërtimit të vazhdueshëm të konsensusit për zhvillim, i cili i tejkalon agjendat individuale politike.

Figura 1: Struktura e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2024-2044



PROCESI DHE METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË SKZH-së

Qëllimi kryesor i SKZH-së është që të jetë dokument gjithëpërfshirës, që do të mundësojë transformim fundamental të Maqedonisë së Veriut.

Ky transformim është i një rëndësie të jashtëzakonshme për zbatimin e ndryshimeve thelbësore kombëtare dhe trasimin e trajektores zhvillimore të vendit. Realizimi i këtij qëllimi është i mundur përmes krijimit **me pjesëmarrje dhe novator të politikave publike, gjë që është një nga parimet kryesore në përgatitjen e SKZH-së.** Qasja gjithëpërfshirëse në përgatitjen e dokumenteve të tilla strategjike lidhet dhe njihet nga përfshirja e qytetarëve dhe institucioneve në zhvillimin e kornizës metodologjike dhe në procesin e konsultimit për përcaktimin e drejtimeve dhe prioriteteve kryesore strategjike. Metodologjia e SKZH-së bazohet mbi përvojat më të mira krahasuese, i merr parasysh leksionet e mësuara nga proceset strategjike kombëtare paraprake, ndërkaq duke futur mjete novator në procesin e zhvillimit dhe implementimit të strategjisë. Qëllimi i saj primar është ndërtimi i një shoqërie të rezistueshme, të sigurt dhe përparimtar, që krijon mundësi zhvillimore.

Gjithashtu, gjithëpërfshirja konsiston në faktin se strategjia përgatitet në bashkëpunim me institucione dhe organizata, shkencëtarë, ekspertë vendore dhe ndërkombëtare, dhe aktivistë civilë. Janë marrë parasysh praktikrat dhe përvojat më të mira të ekonomive me rritje të shpejtë.

Në të njëjtën kohë, **përfshirja e më shumë se 14,000 qytetarëve në 35 punëtori vizionare ("Dream Labs") në të gjithë vendin dha kontribut jashtëzakonisht të rëndësishëm në përgatitjen e SKZH-së.** Këto punëtori mundësuan që pjesëmarrësit të kontribuojnë në strukturimin e strategjisë në bazë të këndvështrimeve të ndryshme në lidhje me qëllimet zhvillimore. Përveç kësaj, këto punëtori mundësuan që pjesëmarrësit të kontribuojnë në mënyrë aktive në krijimin e **24 analizave tematike që lidhen me sektorë të ndryshëm. Konstatimet kryesore nga këto analiza janë përmbledhur në raportin "Strategjia Kombëtare për Zhvillim - Kushtet dhe Sfidat" nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM).** Ky raport paraqet situatën aktuale dhe identifikon një sërë sfidash, dobësish dhe mundësish në fushat e kapitalit njerëzor, mjedisit jetësor, energjisë, infrastrukturës, digjitalizimit, përfshirjes sociale, qeverisjes, rezistencës, barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.

Procesi i përpunimit të SKZH-së u avancua edhe me zbatimin e teorisë së ndryshimeve. Kjo fazë u nda në dy pjesë. Në pjesën e parë u organizuan dhe u realizuan diskutime konstruktive ndërmjet të gjitha palëve të interesuara dhe grupeve eksperte, me qëllim fillimisht të kuptohen problemet, e pastaj të konstatohen sfidat e shtetit për dy dekadat e ardhshme. Me këtë u vendos baza për përmbushjen e qëllimeve afatshkurtër dhe afatgjatë të SKZH-së. Diskutimet u grupuan në gjashtë fusha strategjike: balanca sociale dhe demografia, ekonomia e gjelbër dhe digjitale, siguria dhe rezistenca, ekonomia konkurruese dhe sipërmarrësia, menaxhimi dhe sundimi i ligjit, si dhe zhvillimi territorial.

Faza e dytë karakterizohet nga fakti se u organizuan 15 debate në të cilat morën pjesë më shumë se 200 ekspertë vendas dhe të huaj në të cilat u diskutuan edhe sfidat, por ajo që është veçanërisht e rëndësishme në këtë fazë është se përmes këtyre debateve u përcaktuan gjashtë strategjitë strategjike: 1) ekonomi e qëndrueshme, novatore dhe konkurruese; 2) zhvillim i qëndrueshëm lokal dhe rajonal që siguron kohezion; 3) revitalizimi demografik dhe zhvillimi social dhe kulturor; 4) shoqëri e sigurt dhe rezistente; 5) sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë dhe 6) transformimi i gjelbër. Për çdo fushë është përgatitur një analizë e detajuar e përbërë nga sfidat, shkaqet, pasojat që janë karakteristike për secilën zonë, e po ashtu u dhanë edhe propozim-masa.

Një nga avantazhet më të rëndësishme të këtij dokumenti të rëndësishëm kombëtar është konsensusi politik rreth përgatitjes së tij. Për këtë qëllim, në procesin e përgatitjes kanë marrë pjesë aktive **mbi 50 deputetë** në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe përfaqësues të shumtë të të gjitha partive politike dhe palëve të interesit. Gjithashtu, me qëllim për t'u marrë parasysh pikëpamjet, mendimet dhe propozimet e institucioneve kryesore në nivel qendror dhe vendor, u organizuan punëtori dhe tryeza të rrumbullakëta me mbi 250 përfaqësues nga ministritë, agjencitë, organet rregullatore, njësitë e qeverisjes lokale etj.

Kjo qasje mundësoi të shqyrtohen hollësisht sfidat përmes analizës shkak-pasojë, e cila krijoi bazë për përcaktimin e çështjeve dhe prioriteteve zhvillimore kryesore në vend. Këto konstatime ishin veçanërisht të rëndësishme për përcaktimin e qëllimeve të SKZH-së, për përcaktimin e ndryshimeve sistimore që janë të domosdoshme për t'u realizuar në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe për vendosjen e metrikës së çdo fushe të veçantë strategjike. **Falë kësaj qasje, SKZH-ja bëhet përsheptues edhe për realizimin e Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm (QZHQ), që janë harmonizuar plotësisht me synimin e Maqedonisë së Veriut për aderim në BE.**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi menaxhim gjithëpërfshirës dhe strukturë operative për mbështetje të SKZH-së, me bindje se ajo do të realizohet në mënyrë efektive dhe efektive.

Në atë drejtim, Këshilli Kombëtar për Zhvillim, si trup këshillëdhënës ekzistues i Qeverisë e shqyrtoi draft-tekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2024-2044 dhe atë si propozim-tekst ia dorëzoi Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim dhe dorëzim në Kuvend. Zbatimi i Strategjisë operacionalizohet përmes programit për periudhë pesëvjeçare, të cilin e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.



2. TENDENCAT DHE SFIDAT PËR ZHVILLIMIN AFATGJATË

SKZH-ja u përgatit në një periudhë sfidash dhe pasigurish të mëdha globale, rajonale dhe kombëtare që ndikojnë dukshëm në themelet zhvillimore afatgjate. Kjo e rrit rëndësinë e SKZH-së dhe e përforcon rolin e saj si një kornizë gjithëpërfshirëse kombëtare që lejon të shfrytëzohen sa më shumë nga potencialet e disponueshme dhe të përballen me sukses sfidat aktuale dhe të ardhshme. SKZH-ja në thelb merr parasysh faktet se Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend kandidat për anëtarësim në BE dhe se shteti duhet të drejtojë me sukses procesin e integritit evropian duke iu përshtatur tendencave aktuale dhe të ardhshme globale dhe evropiane.

Sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet Maqedonia e Veriut janë:



1. Demografia është një sfidë të cilën e kanë shumica e vendeve evropiane, e cila ka implikime të mëdha sociale, ekonomike, politike dhe kulturore. Plakja e popullsisë (rritja e kufirit mesatar të moshës), shkallët e zvogëluara të natalitetit, ulja e pjesëmarrjes dhe numrit të popullsisë e aftë për punë, përqendrimi i shtuar i popullsisë në zonat urbane, e veçanërisht emigrimi i të rinjve dhe familjeve të tëra, janë tregues të rëndësishëm të përkeqësimit të pamjes demografike të Maqedonisë së Veriut. Analizat e bëra nga Enti Shtetëror i Statistikës (ESHS) në vitin 2023 tregojnë se tre nga 10 qytetarë pritet të jenë më të vjetër se 65 vjeç në vitin 2044. Ndryshimet demografike të pafavorshme përbëjnë një kërcënim serioz për tregun e punës dhe produktivitetin, sistemin e sigurimeve pensionale dhe për mbrojtje sociale, banim dhe planifikim urban dhe në përgjithësi aftësinë e ekonomisë për të gjeneruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.



2. Presioni i migracionit krijohet si rezultat i paqëndrueshmërisë politike globale dhe krizave humanitare, ndryshimeve klimatike, fatkeqësive natyrore dhe faktorëve ekonomikë. Kjo sfidë lidhet

kryesisht me valët e mundshme të emigrantëve drejt Evropës, përmes ose drejt Maqedonisë së Veriut. Po aq të rëndësishme janë edhe migrimet e brendshme nga zonat rurale në ato urbane, të cilat krijojnë një përqendrim tej mase të popullsisë dhe aktivitetit ekonomik në qytetet më të mëdha. Sfida e emigracionit është jashtëzakonisht e rëndësishme, përkatësisht emigrimi i qytetarëve të aftë për punë dhe fenomeni i largimit të kuadrit intelektual dhe të rinjve, i cili minon vazhdimisht potencialin prodhues dhe kulturor të vendit. Menaxhimi i suksesshëm i kësaj sfide dhe nxitja e zhvillimit të barabartë lokal dhe rajonal do të jetë jashtëzakonisht i rëndësishëm gjatë dy dekadave të ardhshme.



3. Ndryshimi i klimës - një sfidë shumëdimensionale me ndikim të madh në shëndetin e njeriut, produktivitetin, balancën ekologjike dhe stabilitetin makroekonomik. Rreziqet natyrore (përmytjet, veçanërisht shirat e rrëmbyeshëm, periudhat e gjata të thata, valët nxehta, zjarret në pyje dhe në vend të hapur, etj.) janë vetëm një aspekt i ndryshimeve, të cilat imponojnë politikatat për zbutje dhe adaptim. Një përgjigje gjithëpërfshirëse shoqërore kërkon infrastrukturë të qëndrueshme dhe elastike, transformim të modeleve të biznesit, bujqësi të qëndrueshme, transformim të gjelbër, si dhe menaxhim të qëndrueshëm me resurset.



4. Arsimi dhe shëndetësia - si attribute bazë të kapitalit njerëzor, janë parakusht për prosperitetin ekonomik dhe social të vendit. Sfidat lidhur me cilësinë e procesit arsimor në të gjitha nivelet (parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë në arsim/primar dhe sekondar në shëndetësi) i cakton trendët tendencat në tregun e punës, niveli i investimeve/prosperiteti ekonomik, social, politik. stabiliteti, migrimet dhe zhvillimi demokratik. Sfidat dhe tendencat shëndetësore lidhen me rreziqet nga pandemitë e reja, përhapja gjithnjë më e madhe e sëmundjeve kronike, rreziqet e rritura lidhur me shëndetin mendor dhe mirëqenien, mbipeshën, keqpërdorimi i shpeshtë i substancave, rezistencën ndaj antibiotikëve, qasjen e pabarabartë në kujdesin shëndetësor, etj. Sfidë serioze është edhe mungesa e personelit mjekësor për shkak të emigrimit.



5. Siguria energjetike është e lidhur me varësinë e lartë të importit të burimeve të energjisë. Nevojitet Është e nevojshme të kërkohen zgjidhje në investime të mençura dhe afatgjate në burime të qëndrueshme, të diversifikuara dhe ekonomikisht të pranueshme. Rritja e burimeve të rinovueshme të energjisë, përfshirë edhe hidrogjenin, si dhe mundësitë e ruajtjes së energjisë dhe rritjen e efikasitetit të energjisë kanë potencial për të përmirësuar ndjeshëm sigurinë energjetike dhe sigurimin e furnizimit me energji, por në të njëjtën kohë këto zgjidhje krijojnë sfida të reja, veçanërisht në pjesën e sigurisë kibernetike.



6. Furnizimi me ushqim dhe siguri të ushqimit. Furnizimi me ushqim, veçanërisht në kushte të prodhimit të zvogëluar ushqimor dhe tensioneve gjeopolitike, mbetet sfida e rëndësishme afatgjate. Në kushte të ndotjes së mjedisit jetësor, nevojitet të ndiqet me vëmendje zinxhiri i furnizimit me ushqim në drejtim të sigurimit të ushqimit me vlerë shëndetësore dhe ushqyese për popullsinë. Siguria e ushqimit ndikon dukshëm mbi pozitën konkurruese të produkteve bujqësore-ushqimore në tregun vendor dhe tregjet e huaja.



7. Gjeopolitika krijon pasiguri politike dhe socio-ekonomike, i cenon dhe i riorienton flukset e tregtisë dhe kapitalit ndërkombëtar, imponon shpenzime të larta buxhetore për mbrojtje, për siguri etj. Ndryshimet gjeopolitike mund të manifestohen në valë të reja migrimi, sfida ekonomike (p.sh., goditje çmimesh, prishje të zinxhirëve globale të furnizimit, shpenzime të rritura për hua të reja), konflikte rajonale, polarizim shtesë politik, etj. Goditjet gjeopolitike kontribuojnë gjithashtu edhe për agjendat në kundërshtim lidhur me të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, të cilat mund të ngadalësojnë ose prolongojnë procesin e integritit të këtij rajoni në BE.



8. Ndryshimet teknologjike dhe transformimi digjital. Momentalisht, por edhe në dekadat e ardhshme priten ndryshime revolucionare lidhur para së gjithash me inteligjencën artificiale (IA), teknologjitë për punë nga distanca, interoperabilitetin, teknologjitë block-chain dhe valutat digjitale, mjekimi nga distanca (telemjekësia), realiteti i zgjeruar dhe virtual, teknologjia financiare (fintech), kompjuterët kuantikë etj. Njëkohësisht, hiperlidhshmëria e ekonomive pritet ta riformësojë tregun e fuqisë punëtore, tregtinë ndërkombëtare dhe financat ndërkombëtare dhe të imponojë ndryshime të vazhdueshme të rregullimit juridik.

Këto sfida kërkojnë përshtatje të politikave veçanërisht në drejtim të sigurimit të fleksibilitet dhe rezistencës më të madhe të shtetit.

Në të njëjtën kohë, **numër i madh i sfidave** ofrojnë një numër të madh avantazhesh për pozicionimin e Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj në lidhje me hendekun në shkathtësitë dhe ndarjen e botës do të jetë një nga faktorët vendimtarë për përparim (fjali plotësisht e paqartë). Në këtë drejtim, shteti me rritëm të përshpejtuar t'i shfrytëzojë potencialet e progresit teknologjik, i cili pashmangshëm është i lidhur edhe me transformimin digjital. Një faktor kryesor në përballjen me sfidat është edhe zbutja e rreziqeve që rrjedhin, për shembull, nga ndryshimet klimatike dhe trazirat gjeopolitike, të cilat rrisin cenueshmërinë në aspektin e sigurisë dhe sigurisë ushqimore, qasjes në ujë dhe shëndetin publik, zgjidhja e vende kritike ekologjike, pastaj përdorimi i digjitalizimit, veçanërisht rreziqet që lidhen me kërcënimet kibernetike asimetrike, krimin kibernetik, ruajtjen e sigurt të të dhënave, sigurinë e sistemeve të informacionit, etj.



3. VIZIONI

Njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë një standard të lartë jetese, duke u realizuar në një ekonomi që është e qëndrueshme, konkurruese dhe ofron mundësi të barabarta për të gjithë.

Institucionet janë efikase, llogaridhënëse, të përgjegjshme, novatore dhe të hapura për pjesëmarrjen e qytetarëve. Komunitetet në të cilat jetojmë janë të gjelbra, të sigurta, rezistente ndaj rreziqeve dhe rreziqeve moderne, të lidhura në mënyrë infrastrukturore dhe të digjitalizuara.

Këto kushte kontribuojnë në krijimin e bazës për të rinjtë përparimtarë, individë që janë të kënaqur, të lumtur, të shëndetshëm dhe njerëz që plaken në mënyrë aktive. Arti dhe kultura janë shtyllat e shoqërisë sonë dhe kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies kolektive dhe perceptimit ndërkombëtar të vendit.

Vendi ynë është një anëtar aktiv dhe i respektuar i organizatave ndërkombëtare dhe nismave rajonale, ku promovon vlera, norma dhe procese që rezultojnë në përmirësimin e jetës së të gjithë njerëzve.

4. QËLLIMET ZHVILLIMORE KOMBËTARE DHE FAKTORËT KRYESORË

4.1 QËLLIMET ZHVILLIMORE KOMBËTARE

Përforcimi i konkurrencës dhe zhvillimi i vendit përmes ekosistemit funksional dhe novator, përsosja e shkathtësive, njohurisë, përfshirja dhe rezistenca e qytetarëve.



	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044
Indeksi i novitetit në Evropë (përqindja e mesatares evropiane)	46,3% (2023) Novator në zhvillim	75% novator mesatar	110% Novator i fuqishëm
Eksporti me teknologji të lartë (% nga eksporti total i produkteve industriale)	4,18% (2020)	5%	7%
Indeksi i kapitalit njerëzor	0,56 (2020)	0,7	0,8
Produktiviteti i punës	20,64\$ (2021)	30\$	40\$

Modelet e menaxhimit që janë të hapura, llogaridhënëse dhe të forta, të afta për të parandaluar dhe për të reaguar në mënyrë adekuate, duke nxitur prosperitetet për të gjitha grupet shoqërore.



Përfshirja sociale që nënkupton sisteme të përmirësuara sociale, shëndetësore dhe arsimore në drejtim të sigurimit të dobive për individët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi.



	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar
Indeksi i zhvillimit njerëzor	0,770 (2021)	0,850	0,910
Koeficient i pabarazisë së të ardhurave (koeficienti i Xhinit)	33,5% (2019)	30%	25%
Aktiviteti i grave në tregun e fuqisë punëtore në lidhje me aktivitetet e meshkujve në tregun e fuqisë punëtore (në %)	66,2% (2022)	75%	85%

4.2 FAKTORËT KRYESORË QË MUNDËSOJNË PROSPERITET

Krijimi i kornizës për zhvillim të qëndrueshëm kërkon fokusimin në disa faktorë kryesorë, të cilët marrin parasysh dimensionet ekonomike, sociale, ekologjike dhe kulturore. Këta faktorë, që në masë të konsiderueshme mund të formësojnë ardhmërinë e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut mund të quhen edhe aftësi, përkatësisht kapacitete për të kryer ose për të arritur detyrë të caktuar ose funksion të caktuar. Ajo nënkupton që potenciali njerëzor duhet të ketë një natyrë dinamike, për t'u përmirësuar, por edhe për të ndryshuar dhe përshtatur sipas nevojave. Së këndejmi, faktorët kryesorë ose aftësitë dhe kapacitetet kombëtare, të cilët janë me rëndësi të jashtëzakonshme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në secilën prej fushave kryesore strategjike janë:

1. Mirëmbajtja e stabilitetit makroekonomik

Mirëmbajtja e stabilitetit makroekonomik është supozim kryesor për sigurimin e shkallëve të qëndrueshëm të rritjes edhe për realizimin e qëllimeve kryesore të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut. Maqedonia e Veriut është vend i cili në periudhën pas vitit 1995 mban shkallë të ulët njëshifror të inflacionit dhe ajo është një prej karakteristikave të rëndësishme dhe të njohura në kornizë të saj makroekonomike. Në periudhën nga 2002 deri në vitin 2021, mesatarja historike e inflacionit është nën 2%. Pas krizës të shkaktuar nga pandemia me covid 19, paraqitja e krizës energjetike dhe rritja e çmimeve të ushqimit, çoi në rritje të dukshme të presionit të inflacionit në vend. Lëvizjet më të reja, por edhe parashikimet e (Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut) BPRMV-ja tregojnë se inflacioni zvogëlohet gradualisht në afat të mesëm deri në vitin 2025 e njëjta do të kthehet në mesataren historike prej afro 2%.

Vlera e denarit maqedonas është e lidhur me euron, gjë që i mundëson BPRMV-së të importojë besueshmërinë e politikës monetare të Bankës Qendrore Evropiane. Ky regjim i kursit të këmbimit i shërben mirë vendit sepse mundësoi që denari të jetë i qëndrueshëm në periudhën nga viti 1998 e deri më sot. Stabiliteti i sistemit financiar të Maqedonisë së Veriut kushtëzohet më drejtpërdrejt nga stabiliteti i sistemit bankar, i cili është segmenti dominues i tij. Sot, sistemi bankar i Maqedonisë së Veriut është stabil, me pjesëmarrje të madhe të kapitalit të huaj në totalin e kapitalit të bankave, me kapitalizim të shkëlqyer (adekuat të kapitalit) dhe me progres të vazhdueshëm në fushën e menaxhimit të korporatave. Deri në vitin 2008, shteti realizoi deficite të ulëta buxhetore dhe krijoi një hapësirë solide fiskale. Me fillimin e recesionit të madh të viteve 2007-2009 dhe me politikën fiskale ekspansioniste në vitet në vijim, deficiti buxhetor filloi të rritet, duke bërë që borxhi publik të rritet dukshëm. Borxhi publik në vitin 2006 ishte vetëm 33% e PBB-së, ndërsa në vitin 2014 arriti në nivelin 46% (Ministria e Financave).

Më vonë, me fillimin e recesionit të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit (shkurt 2020), pati një ngushtim të mëtejshëm të hapësirës fiskale të vendit. Politikës fiskale dhe monetare dhe koordinimit të tyre të mirë u përket roli i rëndësishëm në mirëmbajtjen e kornizës së qëndrueshme dhe të volitshme. Në periudhën afatmesme dhe afatgjate, reformat në sferën fiskale do të vazhdojnë në Maqedoninë e Veriut dhe ato do të fokusohen në: rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në mbledhjen e të ardhurave publike në nivel qendror dhe lokal; përballja efikase me ekonominë joformale, optimizimi i sistemit tatimor duke rritur njëkohësisht drejtësinë e tij, duke përfshirë pagat minimale, pensionet dhe transferimet sociale që synojnë mbrojtjen e kategorive të cënueshme të popullsisë; vendosja e taksave ekologjike që do të mbështesin tranzicionin e gjelbër; racionalizimi dhe ridizajnimi i strukturës së shpenzimeve publike duke shkurtuar shpenzimet jo thelbësore dhe joproductive dhe rritjen e shpenzimeve kapitale, konsolidimin gradual fiskal etj. Regjimi ekzistues i kursit të këmbimit, përkatësisht lidhja e denarit me euron siguron lidhje dhe korrelacion të qartë ndërmjet rritjes së ofertës monetare në ekonominë vendase dhe politikës së ofertës monetare të Bankës Qendrore Evropiane, dhe ruajtjes së stabilitetit të lartë të çmimeve. Koordinimi i mirë i politikave kryesore makroekonomike është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ruajtjen dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik.

Vazhdimi i reformave në sferën fiskale dhe forcimi i disiplinës së politikës fiskale janë një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e një politike monetare efikase, duke marrë parasysh se politika fiskale ka një rol të rëndësishëm edhe në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Goditjet e njëpasnjëshme të 15

viteve të fundit (Recesioni i madh i 2007-2009, kriza e pandemisë dhe kriza e energjisë) patën pasoja, por nuk kërcënuan stabilitetin makroekonomik. Politikëbërësit në Maqedoninë e Veriut, në periudhën pas vitit 1995, fituan përvojë të konsiderueshme në vendosjen dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Përdorimi dhe ndërtimi i përvojave të fituara në të ardhmen është një garanci e fortë që hartuesit e politikave kryesore do të sigurojnë vazhdimësi në krijimin e një kuadri makroekonomik të favorshëm, të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm.

Zhvillimi i vazhdueshëm i kapitalit njerëzor në përputhje me revitalizimin demografik - faktori themelor krijues i zhvillimit të një vendi. Cilësia dhe sasia e kapitalit njerëzor janë me rëndësi kryesore për zhvillimin e secilës prej fushave strategjike. Kështu, investimi në kapitalin njerëzor (arsim, shëndetësi, siguri sociale, siguri, mundësi të barabarta, etj.) duke marrë parasysh specifikat dhe tendencat demografike të tij, do të mundësojë këtë faktor në një ekonomi të vogël dhe të hapur me burime të tjera të kufizuara/faktorë zhvillimi për ta kthyer atë në një avantazh krahasues kryesor që do të sigurojë të prosperitetin afatgjatë të vendit. Rigjallërimi demografik është i lidhur ngushtë me mundësinë e zhvillimit të vazhdueshëm të kapitalit njerëzor dhe për këtë arsye janë në fokus të një pjese të madhe të prioritetëve në SKZH.

2. Institucionet e fuqishme të fokusuar në nevojat e qytetarëve janë faktori kryesor për sigurimin e parakushteve dhe zbatimin e iniciativave, ideve strategjike dhe politikave. Ky është një nga faktorët më të përmendur si një sfidë/mundësi për zhvillimin e përshpejtuar të vendit në të ardhmen. E njëjta gjë konfirmohet edhe në simulimet/projeksonet afatgjata të bëra në kuadër të SKZH-së, ku tregohet qartë se politikat në fushën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit janë një faktor kryesor që do të “zhbllokojë” potencialin e vendit për prosperitet afatgjatë. Institucionet efikase, transparente, të përgjegjshme që i ofrojnë shërbimet e nevojshme për qytetarët në kohën e duhur janë bazë si për zbatimin e SKZH-së ashtu edhe për mirëqenien afatgjatë të Maqedonisë së Veriut.

3. Organizimi territorial dhe decentralizimi funksional. Nevojat e qytetarëve dhe shpërndarja e burimeve përcaktohen më së miri në nivel lokal dhe rajonal. Zbatimi efektiv i secilës prej politikave dhe përcaktimi i reagimeve për suksesin e saj lidhet me nevojat lokale/rajonale dhe specifikat territoriale. Prandaj, organizimi i suksesshëm territorial dhe decentralizimi funksional janë parakushte për krijimin e një lidhjeje vertikale të të gjithë procesit të krijimit, zbatimit të politikave dhe shpërndarjes së burimeve, gjë që krijon më tej bazën për mirëqenie dhe prosperitet më të madh të qytetarëve. Decentralizimi funksional siguron faktorët dhe burimet e nevojshme për veprim lokal efektiv brenda kornizës më të gjerë kombëtare për zhvillim.

4. Përfshirja dhe kohezioni social - lidhur me mirëqenien sociale, aq më e madhe produktivitetit dhe zhvillimit më të shpejtë ekonomik. Ofrimi i mbështetjes gjithëpërfshirëse financiare, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve bazë për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara të qytetarëve, duke përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, dhe ata që përballen me vështirësi ekonomike. Me promovimin e përfshirjes sociale, reduktimin e pabarazive dhe qasjen e lehtë në mbështetjen e nevojshme, do të krijohet një sistem që synon të krijojë një rrjet sigurie sociale që ofron qasje të barabartë për të gjithë qytetarët. Me këtë rast do të përmirësohet pozita e atyre që kanë nevojë për të, do të zvogëlohet varfëria dhe do të forcohet kohezioni social. Duke i përfshirë në mënyrë aktive këto grupe, shteti mund të shfrytëzojë potencialin e të gjithë popullsisë së tij. Kjo strategji maksimizon potencialin e fuqisë punëtore dhe kontribuon në përmirësimin e kohezionit social, duke inkurajuar një shoqëri aktive ku secili mund të kontribuojë në progres dhe prosperitet sipas mundësive të tij.

5. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe përballimi i suksesshëm me problemet ekologjike në fakt nënkupton sigurimin e qëndrueshmërisë dhe rezistencës afatgjate të ekonomisë, mbrojtjen e mirëqenies së qytetarëve të saj dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj si aktor në ndryshimet globale. Vendi duhet të forcojë kapacitetet për përshtatje, ta përmirësojë infrastrukturën dhe të ndërtojë kapacitete për të krijuar politika parandaluese dhe për të zbatuar në mënyrë efektive praktikë ekonomike dhe sociale që e rrisin qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Për këtë nevojitet përforsimi i ndërgjegjësimit publik, popullsi e arsimuar dhe partneritete të forta globale. Maqedonia e Veriut do të duhet të përmirësojë rregullativën për mjedis jetësor dhe të nxisë praktika të qëndrueshme

me strategji konkrete për përshtatje dhe zbutje, ndërkaq duke marrë parasysh të gjitha grupet sociale në proces. Mbrojtja dhe restaurimi i ekosistemeve që veprojnë si mbrojtës natyrorë kundër ndikimeve klimatike do të bëhet një prioritet i lartë dhe do të duhet të zhvillohen mekanizma të përmirësuara financiare për të mbështetur masat e përshtatjes dhe zbutjes.

6. Konsensusi politik për drejtimet kryesore strategjike të zhvillimit është baza për krijimin e vazhdimësisë në zhvillimin kombëtar, veçanërisht kur bëhet fjalë për strategjitë e zhvillimit afatgjatë. Pa përfshirjen dhe konsensusin e gjerë të aktorëve politikë për drejtimet kryesore të zhvillimit, zbatimit të politikave/masave strategjike vështirësohet dhe përballet me kufizime dhe sfida të përcaktuara nga ciklet dhe interesat politike. Prandaj, një nga faktorët kryesorë për suksesin e dokumenteve të tilla strategjike afatgjata është konsensusi i gjerë politik. Për ta arritur atë, nevojitet ngritja e mekanizmave specifike për të siguruar qëndrueshmërinë e tij për drejtimet kryesore strategjike, të cilat janë me interes shtetëror dhe realizimi i të cilave tejkalon një ose më shumë cikle zgjedhore.

7. Menaxhimi dhe përdorimi i të dhënave, teknologjive dhe shkalla e lartë e digjitalizimit bëhen jashtëzakonisht të rëndësishme në shoqërinë moderne. Disponueshmëria e të dhënave cilësore, në kohë dhe të ndara është e nevojshme për nxitje të politikave koherente dhe relevante të bazuara në dëshmi. Shteti duhet të investojë gjithashtu në një strategji digjitale që fokusohet në katër shtylla kryesore: zhvillimi i fuqisë punëtore dhe profesionistëve më të mirë digjitalë, ndërtimi i infrastrukturave digjitale të sigurta dhe miqësore me mjedisin, lehtësimi i transformimit digjital të bizneseve dhe ofrimi i shërbimeve publike digjitale me fokus përdoruesit. Digjitalizimi si proces do të kërkojë ndryshim në strukturat administrative dhe menaxhuese për të krijuar kushte për interoperabilitet dhe sisteme që mundësojnë mbledhjen, menaxhimin, mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave për vendimmarrje.



5. FUSHAT STRATEGJIKE

5.1. FUSHA STRATEGJIKE: EKONOMI E QËNDRUESHME, NOVATORE DHE KONKURRUESE

Inovacioni, produktiviteti dhe konkurrueshmëria janë kategori të lidhura ngushtë dhe ndikojnë fuqishëm në dinamikën dhe cilësinë e zhvillimit ekonomik. Në secilën nga tre sferat, Maqedonia e Veriut ka dobësi të dukshme. Sipas të dhënave më të fundit të disponueshme të ESHS¹, në periudhën 2018-2020, pjesëmarrja e subjekteve afariste novatore në numrin e përgjithshëm të subjekteve afariste është 48,2%. Më së shumti inovacione ka pasur në sektorin e marketingut dhe kërkimit të tregut me 76,3% ndërmarrje novatore; më pas vijojnë sektorët e furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 66,7% dhe aktivitetet financiare dhe sigurimet me 67,1% ndërmarrje novatore.

Nga ana tjetër, ekzistojnë dobësi serioze, madje edhe ngecje në segmentin e alokimeve (shpenzimeve) për kërkim dhe zhvillim (KdheZh). Në vitin 2020, këto kosto arritën në 0,37% të PBB-së, me ç'rast veçanërisht brengosëse është pjesëmarrja marginale e sektorit të biznesit në alokimet për KdheZh prej vetëm 25,7% të totalit të alokimeve për kërkim dhe zhvillim. Shqetësues është edhe fakti se, sipas të njëjtave të dhëna nga viti 2020, pak biznese, vetëm 40,7% organizojnë trajnime për zhvillim profesional për punonjësit dhe numri i patentave të regjistruara dhe të drejtave të tjera të pronësisë industriale është i ulët.

Kjo tregon pse vendi mbetet një novator në rritje me një performancë prej 46,3% të mesatares së BE-së. Në fakt, ky tregues (indeksi total i inovacionit 46,3%) është nën mesataren e vendeve të përfshira në grupin e novatorëve në zhvillim (70%)².

Inovacioni është një tipar thelbësor i sipërmarrjes dhe kulturës sipërmarrëse. Megjithëse në Maqedoninë e Veriut u formua një popullsi relativisht e pasur e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në periudhën nga pavarësia e deri më sot, numri mesatar i NVM-ve aktive për 1000 banorë është 39, që ende është nën mesataren për një ekonomi tregu funksionale (mesatarja është rreth 50 deri në 60 NVM për 1000 banorë)³.

Gjithashtu, numri i NVM-ve me potencial të shpejtë rritjeje (shumë novatore, konkurruese dhe me performancë të mirë eksporti) është shumë i ulët, ndërmjet 5% dhe 6%. Po ashtu pak të përfaqësuar janë të ashtuquajturat proceset cilësore të sipërmarrjes: nënkontraktimi, institucionet për të mbështetur bizneset në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre - përsheptuesit, inkubatorët e biznesit dhe parqet teknologjike.

Gjithashtu, megjithëse qasja e bizneseve në financa për zhvillim, sot, krahasuar me vitet e hershme të tranzicionit, është përmirësuar ndjeshëm, mungojnë forma më novatore të financimit të biznesit, si kapitali i rrezikut joformal (engjëjt e biznesit), kapitali i rrezikut formal (fondet zyrtare të rrezikut), lizingu etj. Sipas madhësisë së ndërmarrjeve, më novatore janë kompanitë e mëdha me më shumë se 250 të punësuar, pas tyre renditen ndërmarrjet e mesme që kanë nga 50 deri në 249 të punësuar, dhe më pak novatore janë ndërmarrjet e vogla, numri i të punësuarve të të cilave varion nga 10 deri në 49. Përqindja

¹ ESHS (Enti Shtetëror i Statistikës – njoftim: Subjektet afariste novatore (stat.gov.mk)

² ESHS (Enti Shtetëror i Statistikës – njoftim: Subjekte afariste novatore (stat.gov.mk); European Innovation Scoreboard 2023 – Country Profile North Macedonia

³ Blue Ribbon Commission Report - Macedonia (Team Leaders Josef Brada and Taki Fiti) Towards 21 Dynamic and Sustainable Economic Growth – Growth Supportive Policies, United Nations Development Programme (UNDP), Skopje 2006

relative e ndërmarrjeve novatore në grupin e ndërmarrjeve të mëdha është 61,5%, në grupin e ndërmarrjeve të mesme 51% dhe në grupin e ndërmarrjeve të vogla 47%. Në Maqedoninë e Veriut, 33,9% e të punësuarve janë të angazhuar në industri me komponentë teknologjike të lartë dhe të mesme dhe në sektorin e shërbimeve të bazuara në njohuri, që është një nivel dukshëm më i ulët se ai i 27 vendeve anëtare të BE-së, ku kjo përqindje është 46,3%. Ky vend po përballlet me sfida në fushën e digjitalizimit të ekonomisë, e cila, nga ana tjetër, është parakusht për të ecur në hap me të ashtuquajturat revolucioni industrial, i cili ka potencialin për të ndryshuar rrënjësisht ekonominë përmes teknologjive të tilla si "të dhënat e mëdha", cloud computing, interneti, mësimi i makinës dhe të tjera. Në vitin 2023, 91,6% e bizneseve me 10 ose më shumë punonjës kishin qasje në internetin me brez të gjerë.

Sipas madhësisë së ndërmarrjeve, përqindjen më të lartë të porosive të marra përmes rrjeteve kompjuterike e shënojnë ndërmarrjet e mëdha (35,4%), të ndjekura nga ndërmarrjet e mesme me 24,6%, ndërsa ndërmarrjet e vogla kanë pjesën më të vogël të porosive të marra përmes rrjeteve kompjuterike, që është vetëm 12,5%. Digjitalizimi dhe transformimi digjital nuk janë më të disponueshme vetëm për kompanitë e mëdha, por ato po bëhen të nevojshme edhe për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Këta dy komponentët janë të rëndësishëm veçanërisht për zhvillimin dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve novatore dhe për përmirësimin e konkurrencës së tyre jo vetëm në tregun vendas, por edhe më gjerë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Pabarazia gjinore është tipar tipik i tregut të punës në Maqedoninë e Veriut dhe del në pah në fushën e veprimtarisë sipërmarrëse. Gjegjësisht, nga numri i përgjithshëm i punëdhënësve në vend në vitin 2021, vetëm 19% janë gra.

Ka statistika të ngjashme gjinore mes atyre që punojnë për llogari të tyre. Prej tyre, 78% janë meshkuj, ndërsa pjesa tjetër 22% janë femra. Sipas statistikave zyrtare, gratë menaxhojnë vetëm 2,6% të ndërmarrjeve ekzistuese⁴.

Të gjithë treguesit për produktivitetin e ekonomisë maqedonase (produktiviteti i punës i matur sipas PBB për punonjës, produktiviteti i matur sipas vlerës së shtuar të krijuar për punonjës dhe produktiviteti total i faktorëve) në mënyrë eksplicite tregojnë se ai është mbajtur në nivel jashtëzakonisht të ulët për një kohë të gjatë. Ngecja pas mesatares së BE-së është e madhe dhe varion nga 2.5 deri në 4 herë në periudha të ndryshme për sa i përket produktivitetit të matur me vlerën e shtuar për punëtor.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, në periudhën 1993-2017, me përjashtim të periudhës 2002-2008, produktiviteti i përgjithshëm i faktorëve tregon një rënie të vazhdueshme, përkatësisht ka një kontribut negativ në rritjen e ekonomisë. Ndërsa në vlerësimet e fundit të Bankës Botërore nga viti 2023, konfirmohet se produktiviteti total i faktorëve në të gjithë periudhën pas vitit 2011 ka qenë i ulët dhe negativ. Kontributi i produktivitetit total të faktorëve në dinamizimin e rritjes mbetet i vogël, që do të thotë se puna dhe kapitali fizik janë krijuesit kryesorë të rritjes së PBB-së⁵.

Kjo është, para së gjithash, për shkak të aftësisë së ulët novatore të ekonomisë dhe prirjes në rënie të cilësisë së kapitalit njerëzor⁶.

Duhet të theksohen edhe dy tendenca të tjera të pavolitshme lidhur me produktivitetin e ekonomisë maqedonase. Njëra vë në dukje ekzistencën e pabarazive jashtëzakonisht të mëdha midis firmave më produktive dhe më pak produktive në vend (firmat më produktive janë pothuajse shtatë herë më produktive se ato më pak produktive), në kontrast me situatën në vendet e zhvilluara ku këto diferenca janë shumë më pak e theksuara. Tjetra i referohet një rritjeje të hendeikut midis rritjes së produktivitetit dhe rritjes së pagave, përkatësisht rritja e pagave, produktiviteti i punës në sektorin real të ekonomisë. Kushtet

⁴ https://www.stat.gov.mk/publikacii/2023/ZeniteMazite_2023.pdf

⁵ Ministria e Financave (2022). Programi për reforma ekonomike 2022 – 2024

⁶ World Bank Group (2018) FYR Macedonia Systematic Country Diagnostic: Seizing a Brighter Future for All, November 29; World Bank Group (2023) North Macedonia Systematic Country Diagnostic

update – Navigating challenges, embracing opportunities / North Macedonia Systematic Country Diagnostic Update 2023

e tilla në sferën e inovacionit dhe produktivitetit determinojnë edhe konkurrencën e ulët të ekonomisë maqedonase. Sipas Raportit të Konkurrencës Globale të Forumit Ekonomik Botëror, Maqedonia e Veriut, me rezultatin 57,3 (rezultati varion nga 0 deri në 100, ku 100 është rezultati më i mirë) nga gjithsej 141 vende, renditet në vendin e 82-të, që është rezultati më i ulët midis vendeve të rajonit më të gjerë të përfshirë në hulumtim⁷.

Arsyet për situata të tilla në fushën e inovacionit, produktivitetit dhe konkurrencës janë të shumta, por dy grupe faktorësh janë veçanërisht të rëndësishëm: cilësia e ulët e kapitalit njerëzor dhe kapaciteti i dobët novator i shtetit.

Vlera e Indeksit të Kapitalit Njerëzor (IKNJ)⁸ për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020 është 0,56 dhe është në nivelin e mesatares botërore, por është më i ulët se mesatarja për Evropën, Azinë Qendrore dhe vendet e grupit me të lartë të ardhura mesatare (0,63) dhe dukshëm më të ulëta se mesatarja e BE-së (0,74). Produktiviteti i ulët i kapitalit njerëzor dhe shkallët e larta të emigrimit, kryesisht të popullsisë e aftë për punë, kanë efekte të forta deformuese në tregun e punës. Pavarësisht përmirësimit të situatës së tregut të punës në periudhën e fundit, vendi ende përballet me dobësi të shumta në këtë fushë. ESHS sipas regjistrimit të vitit 2021 publikoi të dhëna ku në vitin 2022 shkalla e aktivitetit të popullsisë së aftë për punë është vetëm 55,2%, shkalla e punësimit 47,3%, ndërsa shkalla e papunësisë është ende në një nivel relativisht të lartë prej 14,4% (veçanërisht te të rinjtë), pra është dukshëm më i lartë se mesatarja e BE-së dhe vendeve të rajonit⁹.

Punësimi joformal vazhdon të jetë në nivel të lartë, përkatësisht në vitin 2021 mbi 96.000 të punësuar, përkatësisht 12% janë të punësuar joformal, pa pasur sigurim pensional dhe shëndetësor¹⁰.

Shkalla e lartë e emigrimit të popullsisë së punës shkakton një mospërputhje ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë në tregun e punës. Kjo është veçanërisht e vërtetë për personelin me arsim të lartë të profileve të caktuara, si mjekë, informatikanë, inxhinierë mekanikë dhe inxhinierë ndërtimi, si dhe për personelin me arsim të mesëm profesional, si infermierët, teknikët, inxhinierët e makinerisë, ndërtimit dhe elektrikës¹¹.

Emigrimi, veçanërisht ai intelektual, është kryesisht i një natyre të përhershme dhe për këtë arsye duhet të zhvillohet një sistem që do të përfshijë aktivisht në tregun e punës të huajt e imigruar për të plotësuar nevojat e fuqisë punëtore, të cilat, nga ana tjetër, janë një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e sektorëve individualë ekonomikë dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Kapaciteti i dobët novator i Maqedonisë së Veriut kushtëzohet në radhë të parë nga pjesëmarrja shumë e ulët, e papërfillshme e investimeve në Kërkim dhe Zhvillim, nga presioni i dobët konkurrues në ekonomi dhe nga mungesa e një politike të planifikuar mirë dhe të strukturuar të inovacionit, duke përfshirë mjedisin/rrethinën (ekosistemin novator) që do të mbështesë ose ofron kushte dhe mundësi për ndërtimin e një kulture sipërmarrëse, përkatësisht novatore. Gjithashtu, përfaqësimi i lartë i ekonomisë gri (33% e

⁷ World Economic Forum (2019)

⁸ Shih sqarimin më të gjerë metodologjik për IKNJ: <https://www.worldbank.org/en/publication/human-capital#Index>

⁹ Popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut 1) Rezultatet nga Anketa për fuqinë punëtore, 2022, ESHS 2023, https://www.stat.gov.mk/pdf/2023/2.1.23.05_mk.pdf

¹⁰ Baza e të dhënave e ESHS-së për punonjësit joformalë sipas statusit ekonomik, sektorëve të veprimtarisë, https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStatPazarNaTrudTrimesecniARS/098_PazTrud_NefVRab_Sektor_i_kvartalno_ml.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef

¹¹ IOM (2021). Migracionet në Maqedoninë e Veriut: Profili i vendit 2021.

PBB-së, kundrejt 15% në vendet e zhvilluara)¹², ka një efekt të fuqishëm negativ në klimën e biznesit dhe më gjerë në potencialin zhvillimor të vendit¹³.

Gjendjet e përshkruara në fushën e inovacionit, produktivitetit dhe konkurrencës kanë implikime të rëndësishme në shkëmbimin tregtar të vendit dhe veçanërisht në strukturën e eksporteve dhe importeve të Maqedonisë së Veriut. Ekzistojnë disa karakteristika thelbësore që përshkruajnë situatën në sferën e tregtisë ndërkombëtare të Maqedonisë së Veriut. Së pari, eksporti dhe importi i përgjithshëm i mallrave në periudhën ndërmjet vitit 2015 dhe 2022 tregojnë një trend konstant të rritjes - nga 9,8 miliardë euro në vitin 2015 në 20,4 miliardë euro në vitin 2022, që paraqet një rritje mbi 100% (indeksi i transparencës së ekonomisë së Maqedonisë së Veriut tejkalon 160%).

Ndërkaq, dinamika e rritjes së importeve është më e madhe se ajo e eksporteve, që rezulton me thellimin e deficitit tregtar të Maqedonisë së Veriut nga 1,7 miliardë euro në vitin 2015 në 3,8 miliardë euro në 2022 (burimi BAPRMV-së 2023). Së dyti, struktura e shkëmbimit të jashtëm tregtar sipas produkteve, në të dyja anët - import dhe eksport, është dobët e diversifikuar. Nga ana e eksportit, 25 eksportuesit më të mëdhenj përbëjnë 66% të totalit të eksporteve të vendit.

Struktura e importeve sipas produkteve është disi më e larmishme - dhjetë produktet më të importuara në vitin 2020 përbënin rreth 30% të totalit të importeve. Së treti, në periudhën pas vitit 2008, kompanitë e huaja të vendosura në zonat e zhvillimit industrial dhanë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e eksporteve të vendit dhe në përmirësimin e strukturës së tij, në drejtim të përfaqësimit më të madh të produkteve të eksportit me një vlerë të shtuar më të lartë.

Pjesëmarrja e kompanive vendase në prodhimin e pjesëve të këmbimit, komponentëve dhe të hyrave të tjera për nevojat e kompanive të huaja mbetet e papërfillshme, për çka mungojnë efektet e përfshirjes së tyre në zinxhirët e vlerës së shtuar rajonale dhe globale.

Së katërti, përkundër progresit të përmendur, shitja e produkteve novatore nga Maqedonia e Veriut, në raport me mesataren e BE-së, kushton vetëm 22,6%, dhe shitja, d.m.th. eksporti i shërbimeve të bazuara në njohuri, sërish në raport me mesataren e BE-së, përbën 55,1%.

Së pesti, Maqedonia e Veriut ka bilanc pozitiv të transaksioneve me shërbime (punë kreditore, transport, turizëm, shërbime financiare, intelektuale, informative kompjuterike), me të cilat shërbimet japin kontributin e tyre në uljen e deficitit të llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave (burime BPRMV 2023, ESHS 2023, EIS 2023, Oda Ekonomike e Maqedonisë së Veriut).

Së gjashti, rreth 78% e eksporteve të Maqedonisë së Veriut drejtohen në BE dhe rreth 11% në vendet e CEFTA-s, nga ana e importit dominojnë gjithashtu BE-ja (46%) dhe CEFTA (11%).

Rreziqet e recesioneve të thella dhe të rënda janë reale, siç është recesioni i madh ndërmjet vitit 2007 dhe 2009 dhe kriza e shkaktuar nga pandemia e Kovidit, si dhe kriza e fundit e çmimeve dhe energjisë. Në periudhën pas vitit 2008, në më pak se gjashtë vjet, Maqedonia e Veriut dyfishoi borxhin e saj publik dhe me shfaqjen e pandemisë Kovid-19, ai u rrit më tej në 60% të PBB-së. Kjo lloj hapësire fiskale kufizon mundësitë e politikës fiskale dhe monetare për ndërhyrje dhe për të përballuar krizat në rast të recesioneve të reja, më të rënda në të ardhmen. Disa ndryshime u realizuan duke përmirësuar legjislacionin, duke futur rregulla fiskale dhe duke ndërmarrë hapa të caktuar për konsolidimin fiskal,

¹² ULJA E EKONOMISË GRI ËSHTË KOMPONENT THELBËSOR I REFORMAVE TATIMORE DHE RITJES EKONOMIKE - Ministria e Financave (finance.gov.mk)

¹³ Në Strategjinë për formalizimin e ekonominë joformale në RMV 2023 – 2027 sipas përlogaritjeve të fundit të shkallës së ekonomisë joformale në Maqedoninë e Veriut, me përdorim të Metodës së konsumit të energjisë elektrike (Electricity Consumption Method), aktivitetet ekonomike në kuadër të ekonomisë joformale në vitin 2021 përfshijnë afro 24,7% të PBB-së. Burimi: Trpeski et al. (2022), What Determines Informal Economy and Informal Employment – the case of North Macedonia, Shaping Post-COVID World – Challenges for Economic Theory and Policy.

megjithatë rreziqet fiskale janë ende relevante dhe menaxhimi i tyre është i një rëndësie të jashtëzakonshme për realizimin e synimeve afatgjata të zhvillimit të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e vendit.

5.1.1 Misioni

Në vitin 2045, ekonomia e Maqedonisë së Veriut do të jetë novatore, efikase, konkurruese, e gjelbër dhe shumë e integruar në tregtinë ndërkombëtare dhe financat ndërkombëtare, me kulturë të zhvilluar sipërmarrëse, e aftë për të krijuar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Do të ketë një ekuilibër të pranueshëm në tre komponentët e zhvillimit (rritja ekonomike, përfshirja sociale dhe komponenti ekologjik), vende të reja pune produktive dhe të paguara mirë në kompanitë që ndjekin zhvillimin teknologjik dhe prodhojnë mallra dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar dhe njohin se burrat dhe gratë duhet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në të gjitha proceset dhe në të gjitha nivelet.

5.1.2 Qëllimet

Për realizimin e misionit, janë përcaktuar qëllimet në vijim:

1. Ekonomia e bazuar në njohuri, inovacione dhe digjitalizim;
2. Ekonomia e me integritet të lartë në tregtinë ndërkombëtare dhe në financat ndërkombëtare dhe
3. Fuqia punëtore që i përmbush nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës

QËLLIMI – Ekonomia e bazuar në njohuri, inovacione dhe digjitalizim

Në periudhën e ardhshme, një nga qëllimet do të jetë ndërtimi i një ekonomie të bazuar në njohuri dhe inovacion duke zhvilluar një sistem ekonomik në të cilin prodhimi i mallrave dhe shërbimeve më shumë do të bazohet në aktivitete të bazuara në njohuri (knowledge-intensive), të cilat kanë një kontribut të rëndësishëm në nxitjen e inovacioneve teknologjike. Maqedonia e Veriut do të ketë një ekonomi të gjelbër, të digjitalizuar dhe novatore, e cila do të dominohet nga inovacioni si një tipar thelbësor i sipërmarrjes dhe kulturës së sipërmarrjes. E gjithë kjo do të sigurojë një rritje të kontributit të produktivitetit total të faktorëve dhe nënkomponentëve të tij më të rëndësishme (progresi teknologjik dhe struktura arsimore dhe njohuritë e fuqisë punëtore) në dinamikën e rritjes dhe zhvillimit në të gjitha pjesët e vendit. Ndërkaq, politika e inovacionit dhe specializimi i zgjuar theksojnë avantazhet e rritjes së qëndrueshme të sektorëve me potencial të lartë zhvillimi, përkatësisht të bujqësisë dhe industrisë ushqimore, industrisë elektromekanike dhe metalike, turizmit dhe TIK-ut, duke mbështetur digjitalizimin e ekonomisë dhe shoqërisë, konstruksionet e mençura të ndërtesave dhe materialet e qëndrueshme, përfshirë konceptin e ekonomisë qarkulluese dhe e njëj rëndësinë e dallimeve gjinore. Është e nevojshme të mbështetet energjia bazuar në zgjidhjet ekologjike, burimet e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, të cilat inkurajojnë tranzicionin e gjelbër. Për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të mundësuar qëndrueshmërinë e tij në afat të gjatë, theksi megjithatë do të vihet në zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë zhvillimi.

Prioritetet

1. MODELI I RRRITJES EKONOMIKE TË BAZUAR NË SPECIALIZIMIN E MENÇUR DHE TRANSFORMIMIN E GJELBËR

Nga një model rritjeje i bazuar në një pjesë të lartë të punës dhe kapitalit fizik në rritjen e bazuar në një pjesë më të lartë të produktivitetit total të faktorëve (përparimi teknologjik në kuptimin më të gjerë të fjalës, përfshirë digjitalizimin dhe transformimin e gjelbër) me fokus në sektorët që janë një pjesë përbërëse e specializimit të mençur. Potencial të rëndësishëm për përmirësimin e situatës në këtë fushë

kanë edhe sektorët prioritarë të vendosur në Strategjinë për Specializimin e zgjuar: Prioritetet vertikale dhe horizontale të sektorit. Parametrat vertikal të sektorit janë bujqësia dhe ushqimi i zgjuar me vlerë të shtuar të lartë; teknologjitë e informacionit dhe komunikimit; industria elektro-mekanike (4.0) dhe materialet e qëndrueshme dhe ndërtesat e mençura ndërsa prioritetet e sektorit horizontal janë energjia e së ardhmes dhe turizmi.

2. REZULTATET NGA HULUMTIMI, ZHVILLIMI DHE INOVACIONET SI BAZË PËR RITJE TË PËRSHPEJTUAR DHE TË GJELBËR EKONOMIKE

Rritja e vazhdueshme e investimeve publike në KdheZh, nxitja e sektorit të biznesit për rritjen e investimeve në KdheZh, inovacionet me fokus kryesor në zhvillimin e inovacioneve të gjelbra.

3. BASHKËPUNIM I VENDOSUR NDËRMJET SEKTORIT SHKENCOR-HULUMTUES DHE BIZNESIT

Përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit të biznesit dhe shkencor-hulumtues të vendit dhe qendrave shkencore-hulumtuese të kompanive, përfshirë edhe shfrytëzimin e platformave digjitale dhe zgjidhjet.

4. EKOSISTEMI QË MBËSHTET SIPËRMARRËSI DHE STARTAPE

Zhvillimi i njohurive dhe aftësive sipërmarrëse, përhapja e kulturës sipërmarrëse, mbështetja e sipërmarrjes së grave, zhvillimi i sipërmarrësisë sociale, nxitja e inovacioneve të gjelbra, intensifikimi i bashkëpunimit me diasporën dhe përmirësimi i qasjes së kompanive në fonde për financimin e zhvillimit (kredi nga burime vendase dhe të huaja për të mbështetur aktivitetin novator të kompanive, kredi për rritje të gjelbër, kapital risku, tërheqje kapitali nga diaspora etj.), forcimi dhe zgjerimi i infrastrukturës novatore ekzistuese për të mbështetur sipërmarrjen (qendrat startup, përshpejtuesit, inkubatorët, qendrat, parqet teknologjike, etj.), duke njohur specifikën e sfidave dhe mundësive me të cilat përballen gratë në fushën e sipërmarrjes.

QËLLIMI - Ekonomia me integritet të lartë në tregtinë ndërkombëtare dhe financat ndërkombëtare

Rritja e inovacionit, produktivitetit dhe përforcimit të presionit konkurrues brenda, në ekonominë vendore, janë faktorë kryesorë për rritjen e konkurrencës dhe për arritjen e integritetit të lartë të vendit në sferat kryesore të tregtisë ndërkombëtare dhe financave ndërkombëtare – eksporti i të mirave dhe shërbimeve me shkallë të lartë të finalizimit, investime të huaja të drejtpërdrejta dhe transferimi i teknologjisë. Vëmendja e veçantë do t'i përkushtohet tërheqjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta nga korporatat me teknologji të lartë si dhe në bashkëpunim me kompanitë vendore me qëllim përfshirjen aktive në zinxhirët globalë të vlerës së shtuar të lartë.

Prioritetet

1. SIGURIA RREGULLATORE QË KRIJON PRESION TË LARTË KONKURRIMI NË TREGUN VENDOR

Përmirësimi cilësor i segmenteve kryesore të klimës së biznesit, me fokus parandalimin e korrupsionit, ekonominë gri dhe konkurrencën e pandershme, rregullimin e drejtë të bizneseve (ekonomike dhe sociale), një sistem të drejtë tatimor, një politikë të strukturuar mirë për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) etj., për të krijuar një klimë të volitshme biznesi dhe për të nxitur dhe forcuar konkurrencën e shëndetshme në tregun e brendshëm. Lehtësimi i tregtisë, heqja e kufizimeve jotarifore,

digjitalizimi i proceseve tregtare dhe forcimi i integritetit tregtar. Adresimi i sfidave që ndikojnë në mënyrë disproporcionale ndaj grave, si dhe paragjykimet e inkorporuara në rregullativën e biznesit.

2. HYRJE E LARTË E IHD-ve NË PAJTIM ME SPECIALIZIMIN E MENÇUR DHE TRANSFORMIMIN E GJELBËR TË VENDIT

Krijimi i politikave të strukturuar për tërheqjen e IHD-ve në përputhje me proceset e specializimit të mençur dhe transformimit të gjelbër të vendit, të cilat do të sigurojnë ndryshime në drejtimin e shpërndarjes së burimeve nga sektorë teknologjikisht më pak të zhvilluar në sektorë teknologjikisht më të zhvilluar.

“Nearshoring” si proces mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në krijimin e kushteve të volitshme për investime, diversifikimin e ekonomisë, stimulimin e zhvillimit teknologjik, rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së fuqisë punëtore në vend. Ky proces afrimi mund të përdoret në mënyrë optimale duke krijuar kushte të volitshme tregtare dhe ekonomike për kompanitë, duke zhvilluar sektorë atraktiv të biznesit, duke avancuar programet arsimore dhe programet e zhvillimit të aftësive, duke promovuar inovacione dhe aktivitetet kërkimore, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe të produkteve, duke investuar në infrastrukturë (transport, komunikime dhe parqe të teknologjisë), etj.

Maqedonia e Veriut, me strategjinë dhe investimet e duhura, mund të shfrytëzojë dukshëm mundësitë që i ofron procesi “nearshoring” për të përmirësuar ekonominë dhe zhvillimin e saj.

3. KOMPANITË VENDORE TË PËRFSHIRË NË ZINXHIRËT E VLERAVE

Krijimi i politikave stimuluuese dhe ofrimi i ndihmës për kompanitë vendase, të cilat kanë potencialin për të bashkëpunuar me kompani të huaja brenda dhe jashtë zonave industriale, bazuar në nënkontraktime, trajnime dhe trajnime të përbashkëta me kompani të huaja me qëllim përvetësimin dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive të punonjësve, lehtësimin e hyrjes së kompanive vendase të inovacionit në ZZHIT-të, etj.

4. QASJA NË SHËRBIMET DHE KAPITALIN KONKURRUES DHE TË DIVERSIFIKUAR

Ridefinimi dhe diversifikimi i sistemit financiar në mënyrë që ai të mund të plotësojë më lehtë nevojat e kompanive në faza të ndryshme të ciklit të jetës. Modernizimi i tregut financiar, i cili dominohet nga kreditë klasike, me mjete të gjelbra (produkte), kredi për mbështetjen e rritjes së gjelbër dhe digjitalizimin, rritjen e disponueshmërisë dhe shfrytëzimit të burimeve të financimit nga fondet evropiane, zhvillimin e formave të ndryshme të kapitalit të rrezikut që do të reflektohen kryesisht në krijimin e kompanive të vogla novatore të sapothemeluara (start-up) dhe në rritje (scale-up) të bazuara në njohuri. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të njihen nevojat specifike financiare dhe sfidat me të cilat përballen gratë në biznes.

5. STRUKTURA EKSPORTUESE E VENDIT ME PËRFAQËSIM TË TË MIRAVE ME SHKALLË TË LARTË TË FINALIZIMIT DHE SHËRBIMEVE ME PËRMBAJTJE TË LARTË TË NJOHURIVE

Mbështetja e kompanive vendase novatore që prodhojnë mallra dhe shërbime me vlerë të shtuar më të lartë përmes masave të politikave të inovacionit, duke u mundësuar kompanive vendase të marrin pjesë aktive në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve për investitorët e huaj për të mbështetur procesin e nisur të përmirësimit të strukturës së eksportit të vendit dhe trajtim më të mirë të kompanive vendase nga sektori i TIK-ut. Mbështetja e kompanive me potencial eksporti përmes reduktimit të rrezikut dhe ndihmës në standardizimin, brendimin dhe rrjetëzimin.

6. SHKALLA E LARTË E FORMALIZIMIT TË EKONOMISË

Rritja e kapaciteteve dhe efikasitetit të administratës tatimore për zbulimin e bizneseve joformale dhe uljen e evazionit, si një nga kushtet për rritjen e kapaciteteve fiskale të vendit pa ngarkesa fiskale shtesë. Përmirësimi i rregullores në të gjitha segmentet, veçanërisht në tregun e punës, ndërkohë që ndjekja e tendencave të reja të krijuara dhe të mundësuar nga procesi i digjitalizimit mund të ndihmojë gjithashtu në formalizimin e flukseve ekonomike. Masat e integruara në politika për të inkurajuar dhe përsheptuar procesin e formalizimit.

Qëllimi: Fuqia punëtore e cila i përmbush nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës

Arsimi duhet të harmonizohet me nevojat e tregut të punës, dhe veçanërisht me aftësitë dhe kompetencat që kërkohen aktualisht nga kompanitë, si dhe me identifikimin aktiv të aftësive dhe kompetencave të ardhshme. Gjëja më e rëndësishme në këtë drejtim është vendosja e bashkëpunimit, komunikimit dhe koordinimit efikas të palëve të interesuara në tregun e punës, përkatësisht sektorin e biznesit dhe arsimin. Ndryshimet e vazhdueshme dhe të shpejta në tregun e punës imponojnë nevojën e planifikimit të zhvillimit profesional, ndaj vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të sistemit të të mësuarit të vazhdueshëm dhe të përjetshëm, i cili është kusht i rëndësishëm për rritjen e produktivitetit dhe punësisë. Në këtë drejtim rëndësi të veçantë ka rritja e edukimit digjital dhe financiar në botën e ndryshueshme digjitale.

Njëkohësisht, theksi do të vendoset edhe në orientimin profesional të të rinjve, nxënësve dhe studentëve për të vazhduar në mënyrë të duhur shkollimin e tyre dhe për të gjetur më shpejt vende të paguara mirë. Lëvizje të dukshme ka në arsimin dhe aftësimin profesional, futja e arsimit të dyfishtë, mësimi përmes punës. I kombinuar me udhëheqjen dhe këshillimin në karrierë, roli i Qendrave të reja Rajonale të Arsimit dhe Formimit Profesional është të paraqesin nxitje, të tërheqin nxënësit që do të mësojnë profesionalisht, por edhe për të krijuar opsione fleksibël dhe të shpejta për rikualifikim dhe kualifikim plotësues. Për të rritur normat e aktivitetit dhe punësimit, do të reduktohet pasiviteti i popullsisë që punon, do të krijohen sisteme për të tërhequr profesionistë të kualifikuar (brain gain) dhe përfshirjen aktive të imigracionit legal në tregun e punës, si dhe barazinë gjinore në mundësitë dhe mundësi dhe në rezultatet.

Prioritetet

1. PROGRAMET MËSIMORE ME LËNDË TË INTEGRUARA DHE PËRMBAJTJE TË LIDHURA ME INOVACIONET DHE SIPËRMARRËSINË

Pasurimi i programeve mësimore dhe përmbajtjeve që krijojnë shkathtësi sipërmarrëse dhe novatore, kompetenca dhe kultura në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë dhe formimin e qendrave sipërmarrëse (akceleratorë, habe, parqe teknologjike) në universitete.

2. MËSIMI I DETYRUESHËM PRAKTIK NË ARSIMIN E MESËM DHE TË LARTË:

Mësimi praktik i detyrueshëm në arsimin e mesëm, i cili do të realizohet në shkolla dhe në vetë kompanitë, dhe përmirësimi i cilësisë së tij përmes përfshirjes së sektorit të biznesit në përgatitjen e programeve mësimore. Shprehje e qartë e nevojave që i ka biznesi për llojin e profesioneve dhe për zanatet, si dhe sigurimin e masave nxitëse për kompanitë që organizojnë mësimin praktik dhe kompensimet e duhura për praktikantët. Përmirësimi i cilësisë së praktikës së detyrueshme në fakultete, e cila është shumë e formalizuar, nëpërmjet rritjes së kontrollit të praktikës nga fakultetet dhe stimujve financiarë për kompanitë që do të angazhohen për punësimin e studentëve të mirë pas praktikës së kryer.

3. ZHVILLIMI I KARRIERËS SË NXËNËSVE DHE STUDENTËVE

Me sigurimin e shërbimeve për orientim në karrierë dhe për këshillim vendi mund t'u ndihmojë të rinjve të bëjnë zgjedhje në pajtim me interesat e tyre dhe të fitojnë shkathtësi dhe njohuri që i kërkon tregu i punës.

4. ARSIMI FORMAL DHE JOFORMAL DHE TENDENCAT TREGTARE

Përcaktimi i hendekut ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë në tregun e punës për sa u përket njohurive, aftësive dhe profileve të punës, si dhe përafrimi i programeve të arsimit dhe trajnimit me ndryshimet dhe trendët teknologjikë, përkatësisht me ndryshimet dhe kërkesat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës.

Në këtë drejtim, veçanërisht i rëndësishëm është zhvillimi i sistemeve funksionale për vlefshmërinë e të mësuarit joformal dhe informal, përgatitja dhe promovimi i gjurmuesve dhe/ose analiza e parashikueshmërisë në lidhje me ofertën dhe kërkesën në tregun e punës, modulet fleksibël dhe të shpejtë për arsimin e të rriturve, forcimi i vazhdueshëm i rëndësishëm në këtë drejtim dhe investimi në qendrat rajonale të arsimit dhe formimit profesional, koncepti i qëndrueshëm i të mësuarit gjatë gjithë jetës, koncepti i zbatueshëm për arsimin pas arsimit të mesëm, transit i qetë dhe lëvizshmëri në sistemin e të mësuarit dhe partneritete për vende pune në nivel lokal.

5. MOBILITETI I VENDOSUR I FUQISË PUNËTORE ME FOKUS NË TËRHEQJEN E PROFESIONISTËVE TË KUALIFIKUAR (“BRAIN GAIN”):

Krijimi i kushteve në të cilat procesi i ikjes të rinjve dhe kuadrove me arsim të lartë jashtë vendit do të bëhet i dykrahshëm, përkatësisht do të sigurohet se një pjesë e atyre kuadrove do të rikthehen në vend.

Vendosja e bashkëpunimit me diasporën shkencore që të sigurohet mbështetje e emigrantëve për zhvillim të ekonomisë vendore përmes investimeve të tyre dhe lidhjes me kompanitë e njohura dhe qendrat kërkimore-shkencore.

6. IMIGRIMI I RREGULLUAR LEGAL PËR PËRBALLJE ME MUNGESËN E TREGUT TË PUNËS

E formulimin e kornizës gjithëpërfshirës të politikave, vendi mund të menaxhojë në mënyrë efektive me dhe ta shfrytëzojë potencialin e migracioneve dhe të sigurojë integrimin e tyre në tregun e punës dhe në shoqërinë.

7. PJESËMARRJA E RRIATUR E GRAVE DHE GRUPEVE TË CENUESHME NË FLUKSET EKONOMIKE TË SHTETIT

Krijimi i kushteve dhe masave nxitëse për rritjen e shkallës së aktivitetit të fuqisë punëtore, veçanërisht me fokus në aktivimin e grave dhe grupeve të cenueshme. Zhvillimi rural dhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike rurale dhe promovimi i grupeve lokale të veprimit. Rregullativa mbështetëse dhe mjedisi për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet ekonomike.

8. INVESTIMET NË NXËNËSIT DHE STUDENTËT E TALENTUAR

Miratimi i programeve për bursa për të mbështetur nxënës dhe studentë të talentuar nga fusha të ndryshme në përputhje me prioritetet kombëtare. Grante për kërkimin dhe inovacionin dhe inkurajimin e studentëve për të marrë pjesë në projekte kërkimore dhe zhvillimore.

Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet komunitetit akademik dhe industrisë/biznesit për krijimin e rezultateve kërkimore që do të kontribuojnë në gjetjen e zgjidhjeve praktike për sfidat shoqërore. Zhvillimi i programeve praktike të trajnimit, miratimi i iniciativave për mentorim, krijimi i inkubatorëve dhe përshejtuesve për të zhvilluar aftësitë sipërmarrëse midis studentëve si dhe organizimi i shkëmbimeve me institucionet ndërkombëtare për t'u ofruar studentëve përvojë nga një perspektivë globale.

Roli i procesit të digjitalizimit dhe teknologjive të reja në krijimin e një ekonomie të qëndrueshme, novatore dhe konkurruese.

Zhvillimi i një ekonomie dhe shoqërie të qëndrueshme që është rezistente, gjithëpërfshirëse dhe konkurruese varet nga të dhënat dhe teknologjitë. Ato mundësojnë krijimin e modeleve të reja të biznesit, produkteve dhe shërbimeve që rrisin produktivitetin, inovacionin dhe konkurrencën në të gjithë sektorët e ekonomisë. Ndërsa vendi përpiqet të krijojë një ekonomi që bazohet në njohuri, inovacione dhe mbrojtjen e mjedisit, potenciali i kërkimit të kryer me ndihmën e inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave të mëdha del në pah. Platformat e tregtimit digjital i kalojnë kufijtë gjeografikë dhe ofrojnë qasje të lirë në tregjet globale, ku edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të bëhen më konkurruese. Transparenca dhe efikasiteti i teknologjisë "block-chain" jo vetëm që thjeshton transaksionet, por gjithashtu rrit besimin në tregtinë globale. Në fushën e politikave ekonomike, modelimi i politikave parashikuese dhe platformat e fuqishme të qeverisjes elektronike e trasojnë rrugën drejt qëndrueshmërisë.

Planifikimi i sistemit arsimor digjital që do të jetë në pajtim me nevojat e ardhshme në tregun e punës dhe shoqërinë në tërësi është në thelbin e vizionit të Ekonomisë së qëndrueshme dhe shoqërisë.

Deri në vitin 2044, vendi ynë do të kalojë në një mjedis ku ndërmarrjet afariste do të funksionojnë kryesisht në domenin digjital, ndërsa ekonomitë do të lidhen reciprokisht në rrjetet e ndërlikuara virtuale.¹⁴

¹⁴ Plani kombëtar operacional i brezit të gjerë 2019 përcakton objektivat kombëtare të brezit të gjerë që duhet të arrihen në periudhën e ardhshme dhe përcakton masat dhe aktivitetet për arritjen e tyre: deri në fund të vitit 2029, të gjithë duhet të kenë mundësinë për të hyrë në internet nëpërmjet 5G me një shpejtësi minimale prej qasje në internet prej të paktën 100 Mbps; deri në fund të vitit 2029, të gjitha familjet me një çmim të përballueshëm kanë mundësinë të kenë qasje në rrjet që lejon një shpejtësi shkarkimi prej të paktën 100 Mbps me mundësinë e përmirësimit në një shpejtësi gigabit; deri në fund të vitit 2029, të paktën 50% e numrit total të kontratave të abonimit të familjeve në të gjithë vendin duhet të jetë për qasje në internet të paktën 100 Mbps, etj.

5.2. FUSHA STRATEGJIKE: ZHVILLIM I QËNDRUESHËM LOKAL DHE RAJONAL

Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rajonal është një nga fushat kryesore strategjike që mund të përdoret për të nxitur dhe siguruar kohezion më të madh në vend, si dhe lidhje më të forta me vendet fqinje. Shikuar në kontekstin e vendndodhjes së saj në Evropën Juglindore, Maqedonia e Veriut është në udhëkryq mes dy korridoreve kritike evropiane: Korridorit 10 (veri-jug) dhe Korridorit 8 (lindje-perëndim). Ndërsa Korridori 10 ka shënuar progres të rëndësishëm si në rrugë ashtu edhe në segmentin hekurudhor, Korridori 8 mbetet prapa në të dyja aspektet, ku sektori hekurudhor përballet me sfida të veçanta pasi ende nuk ka mbuluar të gjithë territorin e vendit.

Korridoret energjetike janë një sfidë, por në të njëjtën kohë mundësi për një lidhje më optimale energjetike në tregun e përbashkët rajonal të energjisë. Nga ana tjetër, rrjeti i kanaleve të ujësllësit për ujitjen e tokave bujqësore është një problem i veçantë për rajonet bujqësore rurale dhe kompakte, të cilave u mungon ky burim i rëndësishëm për zhvillimin rural.

Infrastruktura turistike duhet të forcohet me një referencë të veçantë për liqenet natyrore të Ohrit, Prespës dhe Dojranit dhe peizazhet e bukura malore, si dhe potencialin për turizëm dimëror, i cili përfshin sportin dhe rekreacionin. Para tri e më shumë dekadash, disa nga qendrat dimërore, si Kodra e Diellit, Molika dhe Mavrova, ishin shumë më të zhvilluara dhe tërhoqën shumë turistë sportivë nga rajoni i gjerë i Evropës Juglindore dhe Evropës Qendrore. Maqedonia e Veriut ka një infrastrukturë transporti relativisht të krijuar mirë, por ajo është shumë e amortizuar dhe ky rrjet duhet të rinovohet dhe modernizohet urgjentisht dhe në mënyrë cilësore.

Vendi renditet në vendin e 81-të globalisht për nga gjatësia e rrugëve dhe autostradave për banor, ka 7,2 metra për banor. Njëkohësisht është në pozitën e 50-të për nga gjatësia e rrjetit hekurudhor për banor. Për frymë, Maqedonia e Veriut ka 2,7 herë më pak makina në krahasim me BE-në dhe, për fat të keq, ato me moshë mesatare shumë më të madhe, gjë që tregon se qytetarët nuk kanë para të mjaftueshme për vetura dhe përdorin mënyra të ndryshme transporti. Vendi përballet me një sfidë të madhe në fushën e sigurisë në komunikacion, duke pasur parasysh se numri i viktimave në aksidente trafiku ndërmjet viteve 2007 dhe 2021 nuk ka rënë dhe mbetet pothuajse i pandryshuar. Megjithatë Maqedonia e Veriut përdor ujë të freskët, i cili si përqindje e burimeve të ripërtëritshme të ujit të freskët është tre pikë përqindje më shumë se BE-ja (8,39%), megjithatë, joefikasiteti i rrjetit të furnizimit me ujë e përkeqëson problemin, me një humbje shumë të lartë prej 62% në vitin 2020.

Gjithashtu, mosrespektimi i detyrimeve ligjore çon në një shkallë të konsiderueshme të ndotjes së ujit prej 75%, mbi të gjitha, në zonat pranë rajoneve të urbanizuara dhe industriale, si dhe në zonat me aktivitet të përqendruar bujqësore.

Infrastruktura e TIK-ut është më e zhvilluara me një shkallë solide të depërtimit të saj në të gjithë territorin e vendit¹⁵. Përveç infrastrukturës së zhvilluar, potenciali i rritjes së sektorit të TIK-ut është ende i pashfrytëzuar. Përdorimi i infrastrukturës TIK mbetet modest me 15% përdorim të brezit të gjerë me shpejtësi të lartë dhe vetëm 1,2% të rrjeteve me brez të gjerë ultra të shpejtë.

Vendi gjithashtu mbetet shumë prapa në përdorimin e brezit të gjerë prej të paktën 100 Mbps, vetëm 2%, krahasuar me 34% në BE.

¹⁵ Plani kombëtar operacional i Brezit të gjerë 2019 përcakton objektivat kombëtare të brezit të gjerë që duhet të arrihen në periudhën e ardhshme dhe përcakton masat dhe aktivitetet për arritjen e tyre: deri në fund të vitit 2027, të gjitha qytetet e vendit duhet të mbulojnë me një sinjal të pandërprerë 5G. Në fund të vitit 2029, të gjitha institucionet publike (shkollat, universitetet, qendrat kërkimore dhe institucionet e tjera arsimore, institucionet shëndetësore, ministrinë, gjykatat, vetëqeverisjet lokale dhe organet dhe organet e tjera shtetërore) duhet të kenë qasje simetrike në internet me një shpejtësi prej të paktën 1 Gbps.

Maqedonia e Veriut është një vend relativisht i vogël i ndarë në tetë rajone të planit ndërmjet të cilave ka dallime të konsiderueshme territoriale dhe socio-ekonomike. Me përshtatjen e vendit me proceset integruese, shfaqen rrethana/nevoja të ndryshme për formimin e njësive të tjera territoriale, të cilat nuk përkrijnë me ndarjen e rajoneve të planifikimit. Kjo vihet re veçanërisht në rastin e "zonave të mbrojtura", duke përfshirë parqet kombëtare dhe thesaret natyrore të përcaktuara për mbrojtje nga UNESCO, si liqeni i Ohrit. Dallimet zhvillimore midis rajoneve ekzistuese të planit janë evidente. Sipas Indeksit të Zhvillimit Rajonal, hendeku midis rajonit më të zhvilluar, që është Shkupi, dhe rajonit më pak të zhvilluar verilindor është dy me një. Ajo që është edhe më shqetësuese është se kjo pabarazi nuk është statike, por zbulon një prirje të vazhdueshme të thellimit të dallimeve brenda dhe ndërmjet rajoneve, pavarësisht përpjekjeve të bashkërenduara për të reduktuar ndarjet rajonale. Gjithashtu, ka dallime të theksuara në shkallën e zhvillimit brenda rajoneve, pra ndërmjet komunave. Si rrjedhojë, këto kushte nxisin shtimin e migrimit të brendshëm, jo vetëm nga zonat rurale drejt kryeqytetit, por edhe nga qytetet e vogla drejt qendrës kryesore urbane. Sidomos fshatrat dhe vendbanimet rurale nuk ofrojnë një nivel të kënaqshëm të cilësisë së jetës dhe kjo është një nga arsyt kryesore që të rinjtë i braktisin në mënyrë masovike. Këto situata janë gjithashtu rezultat i politikave të pamjaftueshme ekonomike, fiskale dhe sociale, të cilat nuk ishin të suksesshme në tejkalimin e sfidave rajonale të lidhura me infrastrukturën joadekuate, shërbimet publike cilësore të pamjaftueshme, si shëndetësia dhe arsimiti, mundësitë e kufizuara të punësimit dhe dallimet në cilësinë e jetës që i përfshin kulturën, artin dhe sportin.

Me qëllim të tejkalimit të këtyre dallimeve dhe për të krijuar politika dhe masa të përshtatshme, ministritë e financave dhe të vetëqeverisjes lokale përgatisin Indeks zhvillimor komunal, i cili do të ofrojë një bazë solide për zbulimin e pikave dhe pengesave kryesore në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale dhe në mënyrë indirekte ndërmjet rajoneve.

Dispozitat e Kartës për Vetëqeverisje Lokale të Këshillit të Evropës janë transponuar pothuajse plotësisht në Ligjin për vetëqeverisje lokale të vitit 2002. Në bazë të këtij ligji është bërë transferim simetrik i kompetencave në të gjitha komunat, pavarësisht nga tipologjia e tyre. Nëpërmjet procesit të decentralizimit janë transferuar edhe një sërë institucionesh me të punësuar, si shkolla fillore dhe të mesme, kopshte, disa shtëpi për të moshuarit dhe pjesë e rrjetit të institucioneve në fushën e kulturës. Për zgjidhjen efektive të pabarazive në kapacitetet njerëzore dhe financiare ndërmjet komunave, u miratua Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal. Megjithatë, edhe pas pothuajse dy dekadash që nga fillimi i procesit të decentralizimit, pushteti lokal ende po përballet me sfida të shumta

Komunat rurale kanë të ardhura (për krye banori) rreth 20% nën mesataren e vendit, ndërsa Qyteti i Shkupit me komunat rreth 35% të mesatares kombëtare. Autonomia fiskale e qeverisjes vendore është ende dukshëm e kufizuar duke pasur parasysh se të ardhurat nga taksat lokale janë rreth 25% e të ardhurave totale, me dallime të konsiderueshme midis komunave të ndryshme. Të ardhurat vendore janë vetëm ndërmjet 5 dhe 6% të PBB-së dhe ndërmjet 15 dhe 17% të të ardhurave totale të buxhetit qendror, fondeve dhe të ardhurave lokale. Transferimet kapitale të marra nga komunat nuk mundësojnë zhvillim dhe mirëmbajtje të shpejtë të infrastrukturës lokale. Një pjesë e madhe e vetëqeverisjeve lokale kanë mungesë të personelit të kualifikuar dhe në këtë drejtim janë të theksuara edhe dallimet në cilësinë e shërbimeve lokale që u ofrohen qytetarëve.

Së këndejmi, modelet ekzistuese të decentralizimit fiskal nuk ofrojnë një balancë ndërmjet kompetencave të përcaktuara me ligj dhe burimeve të financimit të tyre. Pavarësisht dy dekadave të vendosmërisë për decentralizim më të shpejtë, më të drejtë dhe më efikas, situata aktuale ende e pozicionon Maqedoninë e Veriut në mesin e shteteve të centralizuara në BE. Prandaj nevojiten ndryshime më dinamike në sistem, si në pjesën e menaxhimit ashtu edhe në atë të përcaktimit dhe financimit të kompetencave vendore me referencë të veçantë në kriteret e përcaktimit dhe ndarjes së bllok-dotacioneve nga pushteti qendror.

Adresimi i këtyre sfidave shumështrësore kërkon një strategji gjithëpërfshirëse, afatgjatë, e cila kushton shumë. Politikat dhe masat efektive në përputhje me standardet, praktikat dhe kriteret e BE-së janë thelbësore, së bashku me përfshirjen e institucioneve dhe instrumenteve funksionale. Përveç kësaj, inkurajimi i një bashkëpunimi më të madh ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe lokal është një pikënisje në përpjekjet për të ndalur fillimisht tendencat rënëse dhe pastaj gradualisht për të punuar në ndryshime progresive. Frymëzimi nga modeli multicentrik i zhvillimit rajonal në Slloveni, i cili siguron një cilësi të krahasueshme të jetës në rajone të ndryshme, si dhe midis zonave urbane dhe rurale, mund të shërbejë si një paradigmë udhëheqëse për Maqedoninë e Veriut.

5.2.1 Misioni

Të gjithë qytetarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht se ku jetojnë, kanë qasje të barabartë në mundësitë për cilësi të lartë të jetës. Partneriteti dhe bashkëpunimi me komunitetet lokale rezulton në forcimin e infrastrukturës dhe shërbimeve që nxisin rritjen ekonomike dhe përparimin social, si dhe adresimin e pabarazive të mundshme gjinore.

Duke marrë parasysh qasjen me ndryshimin e sistemit mbi të cilin bazohet SKZH-ja, kjo fushë strategjike duhet të konsiderohet në kombinim me të gjitha të tjerat.

5.2.2 Qëllimet

Për realizimin e misionit, janë përcaktuar qëllimet në vijim:

1. Pabarazi të zvogëluara në kuadër të dhe ndërmjet rajoneve të planit;
2. Infrastruktura kapitale në funksion të një jetë më të mirë;
3. Komuna të qëndrueshme funksionale dhe fiskale.

Qëllimi: Pabarazi të zvogëluara në rajonet dhe ndërmjet rajoneve

Tejkalimi i hendekut midis zonave urbane dhe rurale, si dhe midis rajoneve të ndryshme në Maqedoninë e Veriut. Me promovimin e investimeve të synuara, krijimin e politikave dhe zhvillimin e infrastrukturës, Maqedonia e Veriut përpiqet të krijojë një mjedis në të cilin çdo qytetar mund të gëzojë cilësi të mirë të jetesës, pavarësisht se ku jeton, duke marrë parasysh nevojat dhe përvojat specifike të burrave dhe grave në lokacionet e ndryshme gjeografike. Nëpërmjet këtij qëllimi strategjik, migrimi i brendshëm nga fshati në qytet do të reduktohet dhe kohezioni social do të përmirësohet, gjë që do të kontribuojë në një stabilitet më të madh kombëtar dhe rritje të qëndrueshme. Reduktimi i dallimeve rajonale dhe ndërkomunale është një instrument për shfrytëzimin e plotë të potencialit të kapitalit njerëzor dhe burimeve të Maqedonisë së Veriut, i ndjekur nga një qasje e përgjegjshme gjinore, e cila promovon qasje të barabartë në mundësi për gratë dhe burrat për të kontribuar në një shoqëri të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe konkurruese. Ky objektivi strategjik promovon gjithashtu një shpërndarje më të barabartë të aktiviteteve ekonomike, duke parandaluar përqendrimin e tepërt në qendrat e mëdha urbane dhe duke zbutur sfidat sociale dhe mjedisore. Përqendrimi i Maqedonisë së Veriut në zvogëlimin e dallimeve brenda dhe ndërmjet rajoneve jo vetëm që kontribuon në një shoqëri më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse, por gjithashtu e pozicionon vendin drejt rezistencës dhe konkurrencës më të madhe në skenën globale.

Prioritetet

1. ZHVILLIMI HAPËSINOR POLICENTRIK DHE SHKALLA E LARTË E KOHEZIONIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TERRITORIAL

Inkurajimi i zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në të gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut duke reduktuar dallimet ndërmjet dhe brenda rajoneve të planit. Harmonizimi i politikave me parimet e kohezionit territorial, sipas qasjes së Bashkimit Evropian, dhe me perspektivë të ndjeshme gjinore dhe inkluzive. Përveç kësaj, sinkronizimi i përpjekjeve lokale dhe rajonale me nismat e kohezionit të jashtëm territorial (ndërkufitar) siguron një qasje të koordinuar që promovon rritje të barabartë, lidhje dhe zhvillim ekonomik. Kjo e përmirësoi mirëqenien sociale dhe ekologjike të rajoneve të ndryshme, duke kontribuar në zhvillim rajonal më harmonik dhe gjithëpërfshirës, i cili merr parasysh specifikat dhe avantazhet e secilit prej rajoneve.

2. VENDBANIMET ME INFRASTRUKTURË TË ZHVILLUAR DHE JETË DINAMIKE SOCIO-EKONOMIKE DHE KULTURORE

Nxitja e qyteteve dhe zonave rurale moderne dhe të lidhura mirë me infrastrukturë cilësore, përfshirë transportin dhe shërbimet komunale për të mbështetur rritjen ekonomike dhe cilësinë e jetës, duke respektuar nevojat dhe rolet specifike të burrave dhe grave në zonat rurale. Nëpërmjet nismave dhe investimeve të synuara, zonat rurale do të forcohen, ndërsa me harmonizimin strategjik të përpjekjeve zhvillimore me burimet dhe mundësitë lokale, do të përmirësohet siguria ushqimore, qëndrueshmëria ekologjike dhe prosperiteti ekonomik në zonat rurale. Kjo qasje mundëson nxitjen e zhvillimit rural për rajonet dhe kontribuon në qëndrueshmërinë e përgjithshme bujqësore dhe ekonomike të shtetit.

3. SHËRBIME PUBLIKE CILËSORE DHE INKLUZIVE

Theksi i cilësisë në ofrimin e shërbimeve si shëndetësia, arsimi, mbrojtja sociale, mbrojtja e fëmijëve dhe infrastruktura, duke siguruar njëkohësisht kushte në të cilat nuk do të anashkalohen komunitetet e marginalizuara dhe të cenueshme.

Integrimi i zgjidhjeve digjitale do të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e ofrimit të shërbimeve duke kapërcyer boshllëqet gjeografike dhe duke siguruar që edhe komunitetet e vështira për t'u arritur të kenë kujdes shëndetësor cilësor, mbështetje sociale dhe shërbime për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe kushte për zhvillimin e biznesit. Kjo qasje inkurajon inkluzivitetin dhe pasqyron të menduarin e përparuar për mirëqenien publike.

Qëllimi: Infrastruktura kapitale në funksion të jetës më të mirë

Ky qëllim strategjik mbulon një gamë të gjerë nismash, duke përfshirë zhvillimin dhe modernizimin e rrjeteve të transportit, infrastrukturës së energjisë dhe TIK-ut, infrastrukturës bujqësore, sportive dhe turistike, objekteve shëndetësore, institucioneve arsimore dhe shërbimeve komunale. Duke u dhënë përparësi këtyre investimeve, Maqedonia e Veriut përpiqet të krijojë një mjedis më efikas, të qasshëm dhe gjithëpërfshirës, duke reduktuar kështu dallimet socio-ekonomike dhe duke u mundësuar banorëve të saj të kenë një jetë më të shëndetshme dhe më përparimtare. Gjithashtu, zhvillimi i infrastrukturës kapitale është në linjë me qëllimet më të gjera të Maqedonisë së Veriut, si forcimi i konkurrencës dhe pozitës globale. Lidhja e përmirësuar, e lehtësuar nga infrastruktura më moderne, e bën më të lehtë për bizneset hyrjen në tregje dhe për individët që të gëzojnë shërbimet thelbësore.

Prioritetet

1. KORRIDORE TË NDËRTUARA DHE TË MIRËBAJTURA EVROPIANE INFRASTRUKTURE DHE RRJETI I SIGURT DHE MODERN RRUGOR DHE HEKURRUDHOR

Me pjesëmarrjen aktive në zgjerimin dhe modernizimin e korridoreve kryesore të transportit, Maqedonia e Veriut do të forcojë pozicionin e saj si një udhëkryq jetik në zemër të Ballkanit Perëndimor. Këto përpjekje janë kyçe për nxitjen e rritjes ekonomike, tregtisë dhe bashkëpunimit rajonal duke përmirësuar lëvizshmërinë e qytetarëve të saj. Paralelisht, me fokus të veçantë, do të përmirësohet dhe mirëmbahet autostrada dhe infrastruktura lokale, si dhe do të sigurohet transport publik i disponueshëm dhe cilësor.

2. PLANIFIKIMI I DIGJITALIZUAR DHE FUNKSIONAL HAPËSINOR DHE URBANISTIK

Me harmonizimin e infrastrukturës së saj institucionale dhe komunale me standardet evropiane, Maqedonia e Veriut synon të menaxhojë në mënyrë efektive zhvillimin e saj urban dhe hapësinor brenda të cilit projektet janë hartuar në një mënyrë gjithëpërfshirëse me fokus në qëndrueshmëri, duke marrë plotësisht parasysh nevojat e qytetarëve dhe perspektivën gjinore.

3. SISTEMI I QËNDRUESHËM I FINANCIMIT AFATGJAT DHE NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS SË REZISTUESHME KAPITALE

Vendosja e këtij sistemi do të mundësojë prioritetimin dhe planifikimin afatgjatë/të qëndrueshëm të financave të nevojshme për projektet kryesore kapitale dhe maksimizimin e efektivitetit të alokimeve buxhetore (vlera për para), duke i orientuar resurset në projekte që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik, mirëqenien publike dhe përparimin social, duke pasur parasysh ndikimet e ndryshme që i kanë ato mbi gratë dhe burrat.

Qëllimi: Komuna të qëndrueshme funksionale dhe fiskale

Ky qëllim strategjik vendos theks të fuqishëm mbi fuqizimin e komunave për të ofruar shërbime bazë, për të përmirësuar qeverisjen lokale dhe për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të jetës së banorëve të tyre, duke përfshirë edhe perspektivën gjinore. Duke forcuar qëndrueshmërinë fiskale të komunave, Maqedonia e Veriut synon të nxisë një mjedis ku pushtetet lokale mund të financojnë në mënyrë të pavarur kompetencat e tyre, të investojnë në infrastrukturën kritike dhe të plotësojnë nevojat e komuniteteve të tyre, gjë që përfundimisht do të nxisë zhvillimin socio-ekonomik në të gjithë vendin. Në këtë drejtim, është veçanërisht e nevojshme të merren parasysh tendencat demografike në nivel lokal dhe rajonal, të cilat sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2021, kanë treguar tendenca të theksuara rënëse, që më tej mund të kenë ndikim përkatës, si në strukturën administrative, ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve në nivel lokal. Është veçanërisht e rëndësishme për funksionalitetin që të vendoset një fokus më i fuqishëm në qeverisjen e mirë në komuna dhe në forcimin e sundimit të ligjit në nivel lokal, si dhe vendosjen e praktikave kundër korrupsionit.

Prioritetet

1. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE TË CILAT NË MËNYRË EFEKTIVE I KRYEJNË KOMPETENCAT E TYRE

Inkurajimi i menaxhimit të decentralizuar, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike lokale dhe promovimi i zhvillimit të komunitetit do të kontribuojë në një qeverisje lokale më të përgjegjshme dhe më efikase, duke krijuar një bazë solide për demokraci pjesëmarrëse, qytetarë të kënaqur dhe rritje të qëndrueshme lokale dhe rajonale. Krijimi i sistemeve të qëndrueshme të qeverisjes së mirë dhe krijimi i

njësive të vetëqeverisjes lokale rezistente ndaj korrupsionit, të cilat do të kontribuojnë më tej në ofrimin më efikas të shërbimeve dhe zhvillimin e përshtetshëm socio-ekonomik.

Kryerja e kompetencave do të harmonizohet me strukturën demografike dhe nevojat e popullatës. Për kryerjen efikase të kompetencave, komunat do të kenë mundësi për bashkëpunim të gjerë reciprok, i cili do të mundësojë edhe më tej shfrytëzimin efikas të burimeve lokale.

2. NJËSI AUTONOME FISKALE TË VETËQEVERISJES LOKALE ME BURIME TË FUQISHME PERSONALE TË TË ARDHURAVE

Sigurimi i shkallës më të lartë të autonomisë fiskale (ligjore dhe funksionale) me qëllim forcimin e kapaciteteve fiskale të komunave, paralelisht me forcimin e kapaciteteve të tyre menaxhuese, dhe në drejtim të ofrimit në kohë dhe efikas të shërbimeve për qytetarët.

Gjithashtu, për të siguruar stabilitet afatgjatë ekonomik dhe aftësi për të përmbushur nevojat e qytetarëve, duhet të krijohet sistem për të rritur të ardhurat personale dhe për të promovuar bashkëpunimin/asociacionin ndërkomunal me qëllim të zhvillimit më intensiv dhe të balancuar gjinore lokal. Burimet alternative dhe novatore të financimit do të përdoren për financimin e zhvillimit komunal. Njëkohësisht do të forcohet monitorimi dhe kontrolli në funksionim dhe në qëndrueshmërinë fiskale të qeverisjes lokale, gjë që do të stimulojë punën e mirë në komunat.

3. TRANSFERIME FISKALE TË BAZUARA NË PERFORMANSAT DHE NEVOJAT E VETËQEVERISJEVE LOKALE

Sistemi i transferimeve fiskale i cili do t'i marrë parasysh specifikat/diferencat dhe nevojat e vetëqeverisjeve lokale, ndërkaq duke siguruar një rritje të performancës së tyre. Sistemi i transferimeve kapitale është veçanërisht i rëndësishëm, i cili do të duhet të sigurojë forcimin e pavarësisë financiare dhe kapacitetin e komunave për të investuar në fusha kritike, si infrastruktura, aktivitetet komunale, arsimi dhe shëndetësia.

4. QASJA ME PËRGJEGJËSI GJINORE NË QEVERISJE DHE BUXHETIMI NË VETËQEVERISJET LOKALE

Me zbatimin e praktikave të përgjegjshme gjinore në menaxhimin do të ofrohen mundësi për të përcaktuar nevojat që rrjedhin nga hendeqet gjinore në nivel lokal, ndërkaq duke mundësuar njëkohësisht krijimin e politikave të përshtatshme. Buxheti i përgjegjshëm gjinor do të sigurojë që financat publike të përdoren në mënyra në të cilat në mënyrë aktive i marrin parasysh dhe i zgjidhin nevojat dhe perspektivat unike të grave dhe burrave. Kjo qasje synon të avancojë barazinë sociale dhe të nxisë një sistem më gjithëpërfshirës dhe përfundimtar të qeverisjes lokale që përfundimisht do të kontribuojë në një shoqëri më progresive.

Roli i procesit të digjitalizimit dhe teknologjitë e reja për krijimin e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal i cili siguron kohezion

SKZH-ja thekson faktin se të dhënat dhe teknologjitë janë shtytësit kryesorë për arritjen e zhvillimit lokal dhe rajonal që siguron kohezion në zona dhe komunitete të ndryshme gjeografike. Me ndihmën e analizës së sofistikuar të të dhënave, mund të identifikohen pikat e forta dhe sfidat individuale lokale dhe rajonale në të gjithë vendin, të cilat do të mundësojnë ndërhyrje të synuara që synojnë zhvillimin e mëtejshëm të zonave të pazhvilluara pa penguar rritjen e zonave më të zhvilluara. Platformat digjitale janë kryesore në procesin e ndarjes së praktikave më të mira, forcimit të bashkëpunimit dhe mobilizimit të burimeve nëpër rajone. Detyra e tyre është të pajisin të gjitha komunitetet lokale me mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të qenë të begatë. Me ardhjen e teknologjive digjitale, përkufizimi i infrastrukturës po zgjerohet. Qytetet inteligjente që janë të integruara me pajisjet "IoT" (Internet of Things)

mund të optimizojnë rrjedhën e trafikut, të përmirësojnë efikasitetin e transportit publik, të menaxhojnë furnizimin me ujë dhe mbetjet në mënyrë më efektive dhe madje të monitorojnë gjendjen e mjedisit në kohë reale. Financat digjitale dhe teknologjia “block-chain” mund të ndryshojnë procesin e decentralizimit fiskal. Digjitalizimi në çdo kuptim nuk është vetëm një shtytës, por edhe një pikë kthese. Duket se e ka aftësinë për të transformuar strukturën e zonave lokale dhe rajonale në Maqedoninë e Veriut.

5.3 FUSHA STRATEGJIKE: REVITALIZIMI DEMOGRAFIK DHE ZHVILLIMI SOCIAL DHE KULTUROR

Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me shumë sfida sa i përket popullsisë, zhvendosjes dhe plakjes së saj, si dhe përqendrimit të banorëve në një pjesë të vendit. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2021, plakja e kombit reflektohet në të dhënat që tregojnë se popullsia e re është në rënie, ndërsa në të njëjtën kohë numri i të moshuarve në totalin e popullsisë po rritet. Pjesëmarrja e popullsisë në moshë zero deri në 14 vjeç është 17,0%, nga 15 në 64 vjeç është 65,9%, dhe pjesëmarrja e popullsisë në moshë 65 vjeç e lart është 17,2%. Nga viti 2005 deri në vitin 2021, migrimet e brendshme në Maqedoninë e Veriut drejtohen nga zonat rurale në qytetet e mëdha, veçanërisht në Shkup. Nga 19 komuna me bilanc pozitiv të migracionit, 10 komuna janë në rajonin e planit të Shkupit. Tendencat e tilla kontribuojnë në një përqendrim të madh të popullsisë dhe aktivitetit ekonomik në rajonin e planit të Shkupit. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, 205 vendbanime janë bosh, dhe 218 kanë më pak se 10 banorë.

Zgjidhja e mirëqenies ekonomike dhe përfshirjes sociale të qytetarëve në Maqedoninë e Veriut është një sfidë e shumanshme. Megjithëse ka pasur progres në uljen e papunësisë afatgjate, me normën që ka rënë nga 26% në 2010 në 13,1% në 2023¹⁶, kjo shifër mbetet ende dukshëm më e lartë se mesatarja e BE-së, e cila është 2,5 %. Kjo tregon se pavarësisht përmirësimeve, ka ende shumë punë që Maqedonia e Veriut t'u përmbahet standardeve evropiane të destinuar për tregun e punës. Gjithashtu, ajo që është shqetësuese është përqindja e lartë e personave të cenueshëm social me prag të lartë të varfërisë, që sipas regjistrimit të vitit 2020 përbëjnë 21,8% të popullsisë. 42,1% e popullsisë është e ekspozuar ndaj pragut të varfërisë përpara transferimeve sociale. Krahasuar, Maqedonia e Veriut ka afërsisht 50% më shumë njerëz të cenueshëm social sesa BE-ja, gjë që e vendos vendin në një pozitë sfiduese, ku vetëm Shqipëria, Mali i Zi dhe Bullgaria përballen me situata të ngjashme ose më të këqija në rajon.

Të dhënat për popullsinë 15 deri në 29 vjeç janë shqetësuese. Në këtë grup-moshë një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk janë as të punësuar, as në proces arsimimi apo trajnimit. Maqedonia e Veriut është ndër vendet me shkallën më të lartë në këtë drejtim dhe kjo reflekton sfidat e mundshme në punësim dhe arsimim të të rinjve. Në tregun e punës, dallimet sektoriale janë evidente, ku numri më i madh i të punësuarve është i përqendruar në sektorë si tregtia me shumicë dhe pakicë, bujqësia, industria dhe administrata publike.

Megjithatë, duhet theksuar se numri i të punësuarve në këta sektorë jo gjithmonë korrespondon me kontributin e tyre në ekonomi. Ekziston një hendek gjinor në paga në Maqedoninë e Veriut, pra gratë fitojnë më pak se burrat për të njëjtën punë. Përveç kësaj, gratë merren në mënyrë disproporcionale me punë të papaguara të përkujdesjes familjare, duke kufizuar zhvillimin e tyre profesional. Në vitin 2021, numri më i madh i punëtorëve të papaguar të familjes ishin gratë rurale, në total 18,634. Për më tepër, 59% e grave të moshës 20-64 vjeç janë joaktive në tregun e punës për shkak të përgjegjësisë në shtëpi krahasuar me 2,3% të meshkujve¹⁷.

Analiza e sistemit shëndetësor të Maqedonisë së Veriut tregon tendenca të ndryshme. Ana pozitive është se vendi ka bërë përparim të konsiderueshëm në ofrimin e kujdesit shëndetësor për qytetarët e tij, që në shifra do të thotë se afërsisht 90% e popullsisë është e mbuluar nga skema e sigurimeve shoqërore shëndetësore, përkatësisht që shumica e qytetarëve kanë mbrojtje financiare gjatë qasjes në shërbimet shëndetësore. Megjithatë, pagesat e larta private, të ashtuquajturat "pagesat nga xhepi", të bëra nga të siguruarit në Maqedoninë e Veriut, në 41% krahasuar me mesataren e BE-së prej 15%, paraqesin një pamje shqetësuese financiare. Pabarazi të tilla tregojnë se një pjesë e

¹⁶ Njoftimi i ESHS-së për popullsinë aktive në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla e papunësisë është 13,1%,. Burimi ESHS <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=98&rbr=14599>

¹⁷ Statistical Office data, available at: <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=24>

konsiderueshme e popullsisë mbart barra të rënda financiare kur kërkon kujdes mjekësor, duke çuar në qasje të pabarabartë dhe barra financiare, si dhe në dobësim të shëndetit publik.

Fakti që jetëgjatësia mesatare në Maqedoninë e Veriut është afërsisht 76 vjet, përkatësisht është 5,5 vjet më e shkurtër se mesatarja e BE-së, thekson nevojën për ndërhyrje shëndetësore gjithëpërfshirëse, strategji për parandalimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme të popullatës. Megjithëse mbulimi është i lartë, ekzistojnë mangësi në cilësinë dhe efektivitetin e ofrimit të kujdesit shëndetësor. Edhe pse ka pasur progres të konsiderueshëm dhe një ulje të shkallës së vdekshmërisë neonatale, me një rënie drastike nga 10,17 për 1000 lindje të gjalla në 2016 në 4,2 në 2020 dhe 3 në 2021, ajo që shqetëson veçanërisht është shkalla ende e rëndësishme e vdekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve. Edhe pse ka pasur një progres në vitet e fundit, të dhënat tregojnë se vdekshmëria e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut është ende më e lartë se mesatarja e BE-së dhe sipas ESHS-së, në vitin 2022. është 3,2 foshnja të vdekura për 1000 lindje të gjalla, ndërsa shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç është 3,8 për 1000 lindje të gjalla.

Këto të dhëna tregojnë qartë dallime të rëndësishme në rezultatet e kujdesit shëndetësor për anëtarët më të rinj të popullatës. Arsimi në Maqedoninë e Veriut ka disa aspekte pozitive, por edhe një numër të konsiderueshëm fushash që vlerësohen si shqetësuese. Përqindja e fëmijëve të moshës tre deri në pesë që marrin pjesë në arsimin parashkollor është jashtëzakonisht e ulët, përkatësisht është pothuajse tre herë nën mesataren e BE-së - sipas UNESCO-s, mbulimi i fëmijëve nga 0-6 vjeç është 27%, ndërsa sipas Bankës Botërore, mbulimi i fëmijëve nga 3-6 vjet është 46%. Studimi i fundit Kombëtar i Cilësisë së të nxënies dhe arritjeve të hershme të fëmijët parashkollorë, i kryer sipas metodologjisë MELCO, tregoi boshllëqe të hershme që korrespondojnë me sfidat e të mësuarit në moshë më të vonshme dhe i përcakton nevojat për investime për të rritur cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit parashkollor. Në Maqedoninë e Veriut u regjistrua një përqindje relativisht e lartë e studentëve që përfundojnë arsimin e detyrueshëm (90%), megjithëse është pak nën mesataren e BE-së. Nga ana tjetër, shqetësuese janë rezultatet e studimit të fundit ndërkombëtar PISA të vitit 2022, i cili tregoi se një përqindje e lartë alarmante e 15-vjeçarëve, gati 55%, kanë një nivel minimal të njohurive gjuhësore, matematikore dhe shkencore. Tregues të tillë e renditin vendin në krye të renditjes "famëkeqe", si në rajon ashtu edhe në BE, prandaj është i nevojshëm përmirësimi i menjëhershëm i situatës. Në të njëjtën kohë, vendi regjistroi një shkallë të ulët të braktisjes së hershme të shkollës në krahasim me vendet anëtare të BE-së, gjë që tregon se shumica e të rinjve të moshës 18 deri në 24 vjeç janë të përfshirë në një formë edukimi ose trajnimit. Për më tepër, një pjesë e madhe e popullsisë së moshës 25 deri në 34 vjeç ka arsim të lartë, gjë që e vendos Maqedoninë e Veriut ndër vendet me rezultate më të mira në rajon. Në fushën e shkencës dhe kërkimit, ka sfida të rëndësishme, ndër të cilat më seriozet janë numri dukshëm i vogël i individëve të angazhuar në aktivitete kërkimore-zhvilluese, si dhe përqindja e ulët, e pamjaftueshme e financave të alokuara për kërkimin dhe zhvillimin, e cila ka dukshëm negj pas mesatares së BE-së.

Në fushën e kulturës, parimet bazë mbi të cilat duhet të bazohen politikat e ardhshme kulturore janë ato që duhet të nxisin krijimtarinë e lirë të bazuar në autonominë dhe lirinë e shprehjes dhe krijimit, e cila, nga ana tjetër, çon në demokratizim më të madh dhe zhvillim të qëndrueshëm shoqëror të individit dhe grupet sociale. Në këtë mënyrë do të zhvillohet një kulturë aktive dhe dinamike si pjesë e vlerave kulturore evropiane (Deklarata e Bledit dhe Deklarata e Davosit).

Specifikat e kulturës sonë pasqyrohen më së miri nëpër të gjitha format e trashëgimisë kulturore dhe sfidat për ruajtjen e saj janë të shumta dhe specifike, ndaj kërkojnë një qasje thelbësore dhe ndryshime në mënyrën e organizimit të institucioneve dhe individëve në këtë fushë. Duke analizuar sektorin e kulturës nga pikëpamja e punësimit, duhet theksuar se në vendin tonë është vetëm 0,5% e punësimit total, që është nën mesataren në BE ku është 3,8%. Në kulturë, të punësuarit janë kryesisht në institucionet publike, por pjesa tjetër - punonjësit në industrinë kulturore dhe krijuese janë të angazhuar

në ndërmarrje mikro dhe të vogla të bazuara në vetëpunësim. Artistët, profesionistët e kulturës dhe krijuesit shpesh kanë karrierë të bazuar në realizimin e projekteve.

Për sektorin e kulturës në vitin 2021 është ndarë nga buxheti i shtetit 1,23%, që është në nivelin e mesatares evropiane. Megjithatë, qasja aktuale ndaj trashëgimisë kulturore dhe kulturës në përgjithësi duhet të ndryshohet për të krijuar kushte që ato të trajtohen si një faktor që mund të kontribuojë në zhvillimin e vendit. Kjo mund të arrihet më së miri me zhvillimin e industrive kulturore dhe krijuese (IKK), për të krijuar një hapësirë të hapur për krijuesit, që ata të bashkohen dhe të lidhen përmes platformave të brendshme për bashkëpunim, por edhe platformave të jashtme me sektorë të tjerë. Në këtë mënyrë do të krijojnë kushte që IKK të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit. Nxitja e investimeve, subvencioneve, lehtësimit të taksave, zhvillimi i partneriteteve publiko-privat, si dhe masat e synuara sistematike për të mbështetur industrinë kulturore dhe krijuese, do të kenë efekte të rëndësishme ekonomike. Në atë mënyrë, kultura, multikulturalizmi, trashëgimia kulturore do të jenë funksion i turizmit dhe zhvillimit ekonomik.

Turizmi në Maqedoninë e Veriut përballlet me një sfidë të madhe, megjithëse kontributi i tij në PBB është pothuajse në të njëjtin nivel si në BE. Në vitin 2019, gjysma e totalit të bujtjeve është përqendruar në Rajonin Planifikues Jugperëndimor, i ndjekur nga Shkupi me 21%, dhe ai juglindor me 17%. Kjo pabarazi zbulon një mundësi për të promovuar turizmin edhe në rajone të tjera. Sfidë është shkalla e ulët e zënies së shtretërve, e cila është dukshëm më e ulët se mesatarja në BE (50%), ndërsa nga ana tjetër janë vërejtur tendenca pozitive, si rritja e vazhdueshme e numrit të turistëve të huaj. Më shumë turistë ka pasur në vitin 2019 kur janë realizuar 1,58 milionë bujtje. Duke i shfrytëzuar përvojat e rajoneve individuale, turizmi ka potencialin për të stimuluar rritjen ekonomike, bujqësinë, prodhimin e ushqimit dhe zhvillimin e turizmit rural.

5.3.1 Misioni

Inkurajimi i revitalizimit demografik dhe zhvillimit social në Maqedoninë e Veriut, duke krijuar mjedis të qëndrueshëm në të cilin të gjithë individët dhe komunitetet mund të avancohen. Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme të zbatohet qasja që promovon menaxhimin e koordinuar, planifikimin proaktiv dhe strategjitë novatore për t'u përballur me ndryshimet demografike dhe sfidat sociale. Fokusi ynë primar është në përmirësimin e zhvillimit shoqëror dhe stabilitetit demografik përmes bashkëpunimit me të gjithë sektorët relevantë me rëndësi thelbësore për mirëqenien e shoqërisë sonë, duke njohur nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat. Në misionin tonë, parimi i shkëmbimit efektiv të informacioneve dhe bashkëpunimit ndërsektorial është më i rëndësishmi, pasi siguron që politikat tona të fuqizimit dhe përfshirjes së të gjithë individëve, promovimit të identitetit kulturor dhe ndërtimit të rezistencës sociale të kenë përparësi. Ideja bazë është krijimi i shoqërisë së revitalizuar demografikisht, ekonomikisht të begatë, të integruar në rrjedhat ndërkombëtare dhe kohezive sociale, duke garantuar siguri dhe stabilitet për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

5.3.2 Qëllimet

Për realizimin e misionit janë përcaktuar këto qëllime:

1. Lëvizjet demografike të balancuara dhe të qëndrueshme;
2. Njerëz të shëndetshëm dhe të lumtur;
3. Sistemi gjithëpërfshirës dhe efikas i mbrojtjes sociale dhe sigurimit social;
4. Shoqëria e bazuar në njohuri, mendim kritik dhe vlera;
5. Identiteti dhe vlerat e njohura kulturore.

Në Maqedoninë e Veriut është e nevojshme të krijohen politika që do t'i mbajnë të rinjtë, por edhe njerëzit e aftë për punë në vend, politikat për mbështetjen e familjeve për rritjen e shkallës së natalitetit, si dhe masa konkrete për mbajtjen e njerëzve në vendbanim të caktuar, të kenë kushte solide jetese dhe mundësi për zhvillimin personal dhe profesional.

Më tutje, nevojiten politika për të ruajtur mjediset rurale tashmë relativisht të ndërtuara dhe të zhvilluara dhe për të mbajtur popullsinë lokale. Nga ana tjetër, janë të nevojshme politika që do të lehtësojnë kthimin dhe/ose bashkëpunimin me diasporën dhe integrimin e personave që janë pjesë e rrjedhave të migrimit, në përputhje me mundësitë. Kjo strategji e menaxhimit të popullsisë do të sigurojë ekuilibër midis stabilitetit demografik dhe rritjes së qëndrueshme, forcimit të fuqisë punëtore të popullsisë, inkurajimit të diversitetit dhe mbrojtjes së indit të saj social, me fokus të veçantë në pabarazitë gjinore dhe barrierat specifike gjinore.

Prioritetet

1. EKUILIBRI NDËRMJET DETYRIMEVE FAMILJARE DHE PROFESIONALE

Duke garantuar me vendosmëri të drejtat e punëtorëve dhe duke ofruar mekanizma mbështetës për familjet dhe prindërit, Maqedonia e Veriut mund të inkurajojë rritjen e popullsisë, t'i lehtësojë ngarkimet financiare që lidhen me edukimin e fëmijëve dhe t'u mundësojë individëve të balancojnë jetën profesionale dhe private dhe të përmirësojë disponueshmërinë dhe kushtet e banimit.

2. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT DHE KOORDINIMIT INSTITUCIONAL ME DIASPORËN DHE PROMOVIMI I RIINTEGRIMIT TË DIASPORËS

Lidhja me diasporën për të shfrytëzuar njohuritë, ekspertizën dhe burimet e saj për të përmirësuar praninë e vendit në tregjet globale dhe për të lehtësuar transferimin e njohurive, investimeve dhe shkëmbimin kulturor që është gjithëpërfshirës dhe përgjegjës ndaj nevojave dhe mundësive specifike gjinore për të kontribuar.

3. ZONAT RURALE TË RIVITALIZUARA DEMOGRAFIKISHT

Nevojitet qasja e shumanshme, duke filluar nga zhvillimi i infrastrukturës rurale, më pas forcimi i shërbimeve, nxitja e zhvillimit të agrobiznesit dhe diversifikimi i ekonomisë rurale duke mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe duke zhvilluar turizmin rural. Në mënyrë shtesë, promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe praktikave ekologjike mund të tërheqë brezat e rinj pas në jetën rurale, duke ruajtur traditat dhe trashëgiminë kulturore. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të njihen dhe të adresohen sfidat dhe mundësitë specifike me të cilat përballen gratë dhe vajzat.

4. BANIMI I DISPONUESHËM DHE CILËSOR

Politikat dhe stimujt që inkurajojnë ndërtimin e banesave me çmime të përballueshme, duke përfshirë subvencionet, stimujt tatimorë dhe rregullativat e racionalizuara, duhet të zbatohen për të reduktuar barrën financiare për pronarët e mundshëm, duke marrë parasysh sfidat dhe mundësitë e ndryshme me të cilat përballen burrat dhe gratë. Kjo duhet të përfshijë edhe zhvillimin e programeve të banimit social për individët dhe familjet me të ardhura të ulëta. Zgjidhja e çështjeve që lidhen me efikasitetin energjetik dhe me qëndrueshmërinë në banim mund të zvogëlojë shpenzimet afatgjate të banimit dhe të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës.

5. MENAXHIMI SISTEMATIK I RRJEDHAVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME TË MIGRACIONIT

Duke mbledhur dhe analizuar të dhënat, vendi mund të kuptojë më mirë trendet e migracionit, të identifikojë shtytësit kryesorë dhe t'u përgjigjet në mënyrë proaktive sfidave të brendshme dhe të jashtme të migracionit, si dhe të menaxhojë sfidat që lidhen me të rinjtë dhe potencialin e tyre të migrimit, përkatësisht synimet e tyre të migrimit, si dhe faktorët që kontribuan në vendimet e tilla.

Qëllimi: Njerëz të shëndetshëm dhe të lumtur

Sistemi shëndetësor efikas dhe i qëndrueshëm në Maqedoninë e Veriut është vendimtar për të siguruar mirëqenien e qytetarëve të saj. Duke përmirësuar disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore, të cilat njohin nevojat specifike shëndetësore të burrave dhe grave, mund të garantohet që qytetarët do të marrin mbrojtjen e nevojshme shëndetësore kur do t'u nevojitet. Në këtë drejtim, një fokus i veçantë u kushtohet personave me aftësi të kufizuara që janë pjesë e prioritetëve në kuadër të këtij qëllimi. Sistemi i qëndrueshëm shëndetësor e nxit stabilitetin ekonomik, duke e zvogëluar barrën financiare mbi shtetin, por edhe mbi njerëzit.

Fokus të rëndësishëm në kuadër të këtij qëllimi do të vihet edhe në zhvillimin e sportit dhe infrastrukturës së sportit si vlerë përgjithësisht e njohur e cila ka përfitime të rëndësishme sociale, shëndetësore, ndërkaq duke e afirmuar vendin në kuadër ndërkombëtar.

Prioritetet

1. QYTETARËT QË PRAKTIKOJNË MËNYRË JETESE TË SHËNDETSHME

Duke u fokusuar në masat parandaluese, si është edukimi për të ushqyerit dhe sportin dhe për rëndësinë e mënyrës aktive të jetës, vendi mund të luftojë shkallët në rritje të obezitetit dhe problemet shëndetësore që vijnë prej saj. Këto përpjekje mund të çojnë në popullsi më të shëndetshme dhe më aktive, si dhe të zvogëlojnë barrën në sistemin shëndetësor. Në mënyrë shtesë, duke futur programe gjithëpërfshirëse që do të parandalojnë abuzimin me substancat dhe do të ndërgjegjësojnë për pasojat negative të varësisë, mund të reduktohen ndjeshëm pasojat sociale dhe shëndetësore të përdorimit të cigareve, drogës dhe alkoolit.

Sporti të paraqesë një prej faktorëve kryesorë të përditshmërisë së qytetarëve dhe filozofi të veçantë të jetesës ndërkaq duke realizuar përfitime të konsiderueshme për cilësinë e jetës në vendin tonë.

2. QYTETARËT E FOKUSUAR NË MBROJTJEN SHËNDETSORE PARANDALUESE PËR TË GJITHË FAKTORËT E RREZIKUT

Duke adresuar këta faktorë të rrezikut nëpërmjet iniciativave të shëndetit publik, arsimit shëndetësor të përgjegjshëm gjinor dhe ndërhyrjes së hershme, vendi mund të reduktojë ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga sëmundje të tilla si diabeti, sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri. Kjo qasje jo vetëm që e përmirëson mirëqenien e qytetarëve, por edhe e lehtëson barrën e sistemit shëndetësor, duke rezultuar në uljen e shpenzimeve të mbrojtjes shëndetësore dhe cilësi më të mirë të përgjithshme të jetës.

3. QYTETARËT QË JETOJNË NË MIRËQENIE MENDORE

Me fokus në shëndetin emocional dhe psikologjik, Maqedonia e Veriut do të krijojë mjedis mbështetës dhe gjithëpërfshirës që u mundëson qytetarëve të saj të bëjnë jetë të përmbushur, brenda shoqërisë në të cilën mirëqenia mentale njihet dhe respektohet si aspekt themelor i shëndetit dhe lumturisë së përgjithshme. Nevojitet zbatimi i politikave shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme gjinore, ndërgjegjësimi i shtuar për shëndetin mendor dhe shërbime të disponueshme. Në mënyrë shtesë, pranohet kultura e ekuilibrit mes punës dhe jetës, duke inkurajuar angazhime fleksibile të punës dhe duke promovuar praktika për të reduktuar stresin në vendin e punës, si dhe duke mbrojtur shëndetin mendor të fëmijëve, ndër të tjera, duke parandaluar dhe ndëshkuar dhunën e bashkëmoshatarëve.

4. SISTEMI SHËNDETËSOR PUBLIK QË PARASHIKON DHE PËRBALLET ME SFIDAT SHËNDETËSORE DHE FINANCIARE EKZISTUESE DHE TË ARDHSHME

Financimi adekuat që mundëson institucione shëndetësore të pajisura mirë dhe të menaxhuara me cilësi, personal mjekësor me pagesë adekuate dhe shërbime bazë lehtësisht të disponueshme. Më tutje, çdo qytetar duhet të ketë qasje në mbrojtjen shëndetësore me cilësi të lartë, pavarësisht nga gjinia dhe statusi i tij ekonomik. Është e nevojshme të ofrohet kujdesi strategjik për fuqinë punëtore të kualifikuar në mbrojtjen shëndetësore, e cila qytetarëve do t'u sigurojë qasje në kujdesin mjekësor cilësor. Pas pandemisë globale të Covid-19, është treguar qartë nevoja për të ndërtuar sisteme shëndetësore që do t'i parashikojnë dhe përballojnë rreziqet.

Shëndetësia gjithëpërfshirëse (publike dhe private) me teknologjitë e avancuara dhe sistemin funksional të informacioneve është vendimtare për përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe disponueshmërisë së sistemit shëndetësor në Maqedoninë e Veriut. Ky transformim digjital mund të çojë në rezultate më të mira të pacientëve, vendimmarrje më të informuar dhe përvojë më të madhe shëndetësore.

Qëllimi: Sistemi gjithëpërfshirës dhe efikas i mbrojtjes sociale dhe sigurimit social

Është e nevojshme të zbatohen masa për mbrojtje sociale, programe të punësimit, si dhe iniciativa arsimore që do të përmirësojnë gjendjen e qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë, duke ulur kështu varfërinë dhe duke e forcuar kohezionin social. Kjo nënkupton ofrimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse financiare, mbrojtjes shëndetësore dhe shërbimeve bazë për individët e cenueshëm dhe të marginalizuar, duke përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe të gjithë ata që përballen me vështirësi ekonomike, duke i marrë parasysh pabarazitë e mundshme gjinore midis këtyre grupeve të qytetarëve.

Duke promovuar përfshirjen sociale dhe duke reduktuar dallimet do të krijohet sistemi që synon të krijojë rrjet të sigurimit që ofron qasje të barabartë në ndihmë për të gjithë qytetarët në nevojë. Më tutje, efikasiteti i sistemit optimizohet duke riorganizuar proceset administrative dhe duke zgjeruar mbulimin e shërbimeve, duke siguruar kështu kushte në të cilat individët mund të kenë lehtësisht qasje në mbështetjen që kanë nevojë, duke kontribuar kështu për shoqëri më të barabartë dhe më të qëndrueshme.

Prioritetet

1. PARANDALIMI PROAKTIV I RREZIQEVE SOCIALE

Zbatimi i politikave dhe iniciativave të synuara dhe të përgjegjshme gjinore, të cilat u referohen çështjeve të tilla si varfëria, papunësia dhe dallimet shëndetësore përpara se ato të bëhen probleme më të rëndësishme. Duke u fokusuar në ndërhyrjen dhe parandalimin e hershëm, zvogëlohet ndikimi negativ i këtyre rreziqeve tek qytetarët dhe krijohet mjedisi social më i qëndrueshëm dhe më i sigurt. Kjo kontribuon në rritjen e mirëqenies sociale dhe rezistencës së përgjithshme të njerëzve në Maqedoninë e Veriut.

2. SISTEMI I DREJTË I MBROJTJES SOCIALE ME SYNIMIN E DUHUR TË KATEGORIVE VULNERABILE

Qasja e strukturuar për të identifikuar dhe ndihmuar grupet e cenueshme në mënyrë që t'i realizojnë potencialet e tyre të plota, duke siguruar që mbështetja të ndahet aty ku është më e nevojshme, duke marrë parasysh situatat e ndryshme në të cilat ndodhen këta individë për shkak të statusit të tyre gjinor.

3. SHËRBIMET E ZHVILLUARA SOCIALE PUBLIKE TË DISPONUESHME PËR TË GJITHË

Investimet në shëndetësi, arsim, mbrojtje sociale dhe shërbime të tjera bazë, me theks në zgjerimin e infrastrukturës, përmirësimin e cilësisë dhe uljen e dallimeve. Zhvillimi i programeve kushtuar kujdesit paliativ, të cilat fokusohen në menaxhimin e dhimbjes dhe kontrollin e simptomave, me qasje gjithëpërfshirëse gjinore që i njeh nevojat e ndryshme të pacientëve femra dhe meshkuj. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe trajnimit i punonjësve shëndetësorë dhe socialë në këtë fushë për të ofruar kujdes të gjithanshëm për popullatën e moshuar, për të lehtësuar vuajtjet e tyre dhe për të ruajtur dinjitetin. Promovimi i formave të reja të shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të moshuarit për të garantuar ruajtjen e të drejtave, dinjitetit dhe mirëqenies së tyre.

4. TRANSFERET SOCIALE TË HARMONIZUARA ME STANDARDIN E JETESËS

Ndihma financiare dhe përfitimet që janë në përpjesëtim me realitetin ekonomik të qytetarëve nëpërmjet përshtatjeve dhe përmirësimeve të programeve të mbrojtjes sociale për të reduktuar hendekun midis rritjes së shpenzimeve të jetesës dhe të ardhurave mujore si dhe për të ruajtur mirëqenien dhe sigurinë ekonomike të individëve dhe familjeve, duke i njohur sfidat specifike gjinore potenciale. Duke harmonizuar transferet sociale me standardet e jetesës, zvogëlohet varfëria, pabarazia dhe vështirësitë financiare dhe sigurohet standardi i pranueshëm i jetesës.

5. GRUPET E CENUESHME TË INTEGRUARA DHE TË AKTIVIZUARA NË SHOQËRI NË PAJTIM ME MUNDËSITË INDIVIDUALE

Duke zbatuar politika që promovojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre grupeve, shteti mund të shfrytëzojë potencialin e të gjithë popullsisë së tij. Kjo strategji e forcon fuqinë punëtore dhe kontribuon në përmirësimin e kohezionit social, duke i kapërcyer barrierat gjinore që e pengojnë pjesëmarrjen e barabartë aktive të grave dhe burrave, duke përfshirë aftësinë e kufizuar, duke inkurajuar shoqëri më aktive në të cilën të gjithë kanë mundësinë të kontribuojnë në përparim dhe prosperitet.

6. SHTYLLAT FINANCIARISHT STABILE DHE TË QËNDRUESHME TË SIGURIMIT PENSIONAL

Sigurimi afatgjatë financiar i popullsisë që ka të drejtë për pension nëpërmjet menaxhimit të kujdesshëm të fondeve pensionale dhe kontributeve, harmonizimit të përfitimeve pensionale me realitetin

ekonomik dhe zbatimit të politikave që garantojnë aftësinë paguese të sistemit pensional. Duke siguruar qëndrueshmërinë financiare të sigurimit pensional, sigurohet burimi i besueshëm i të ardhurave për pensionistët dhe reduktohet rreziku i varfërisë në pleqëri, duke siguruar njëkohësisht qëndrueshmërinë e sistemit për brezat e ardhshëm.

7. RUAJTJA E FUQISË BLERËSE TË TË ARDHURAVE PENSIONALE

Garancia që pensionistët do të ruajnë standardin e jetesës dhe t'i plotësojnë nevojat e tyre financiare duke zbatuar politika dhe aftësi që i mbajnë përfitimet pensionale në përputhje me shpenzimet e jetesës dhe inflacionin, duke parandaluar kështu erozionin e të ardhurave reale të pensionistëve.

8. KONCEPTI I ZBATUAR I PLAKJES AKTIVE

Zhvillimi i programeve për plakje aktive dhe krijimi i kushteve për përfshirjen e tyre në të gjitha aspektet profesionale dhe sociale të jetës për të inkurajuar dhe aftësuar qytetarët e moshuar që të bëjnë një jetë aktive dhe të angazhuar, dhe vendi do të jetë në gjendje të përdorë përvojën, mençurinë dhe aftësitë e tyre. Përmirësimi i kushteve në institucionet e pensionistëve, mjedisi afarist e social që stimulon veprimtarinë dhe lidhjen dhe veprimin e tyre etj. Në këtë mënyrë do të përmirësohet dukshëm cilësia e jetës së të moshuarve dhe do të mundësohet një komunitet ndërmjet brezave dhe harmonik.

9. SISTEMI FUNKSIONAL I PARANDALIMIT DHE MBROJTJES NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE

Forcimi i sistemeve për parandalimin dhe raportimin e dhunës me bazë gjinore. Rritja e besimit në sistemet dhe shërbimet ekzistuese dhe forcimi i kapacitetit institucional për vlerësimin e saktë të rrezikut të dhunës dhe marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e viktimave. Sigurimi i shërbimeve të disponueshme për gratë me aftësi të kufizuara dhe mbrojtja efektive e viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Qëllimi: Shoqëria e bazuar në njohuri, mendim kritik dhe vlera

Shoqëria e bazuar në njohuri, mendim kritik dhe vlera, në të cilën promovohet arsimit dhe kultura, përgjegjësia gjinore, si dhe parimet etike dhe morale. Ky qëllim nënkupton avancimin e arsimit dhe nxitjen e qasjes holistike ndaj të mësuarit që avancohen njohuritë dhe zhvillimi i aftësive të mendimit kritik me vlera të integruara morale. Duke edukuar shoqërinë të bazuar në këto themele, vendi përpiqet të inkurajojë qytetarët e tij që të miratojnë vendime të bazuara në informacionet e verifikuara, të përfshihen në dialogë konstruktivë dhe të kontribuojnë në mirëqenien dhe përparimin e të gjithë popullsisë, duke krijuar shoqëri të ndërgjegjshme, kritike, të edukuar dhe shoqëri të përgjegjshme.

Prioritetet

1. ARSIMI I DETYRUESHËM PARASHKOLLOR

Gradualisht sigurohet qasja në arsimin e fëmijërisë së hershme për të gjithë fëmijët prej tre deri në pesë vjeç (duke marrë parasysh nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara), duke miratuar politika dhe rregullativa që kërkojnë praninë e programeve parashkollore, duke theksuar rëndësinë e mësimin të hershëm, socializimit dhe zhvillimit të aftësive, duke marrë parasysh faktorët specifikë gjinorë që ndikojnë në mundësitë e barabarta dhe rezultatet për djemtë dhe vajzat. Arsimit i detyrueshëm parashkollor siguron bazë të fortë arsimore për të gjithë fëmijët, zvogëlohen dallimet në qasjen në mësimin e hershëm dhe përmirësohet përgatitja e përgjithshme për shkollë, gjë që në fund do të kontribuojë në përmirësimin e performancave akademike dhe zhvillimin social në vitet e mëvonshme.

2. REZULTATET E MËSIMIT NË ARSIMIN FORMAL TË HARMONIZUAR ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Nxënësit që i përmbushin standardet globale për njohuri dhe aftësi. Reformat themelore në të gjitha shkallët e sistemit të arsimit formal, duke inkurajuar kreativitetin, duke përfshirë faktorët e ndjeshëm gjinorë, të cilët duhet të sigurojnë që vajzat dhe djemtë të kenë qasje të barabartë në arsimin cilësor dhe që mjedisi i mësimi të jetë mbështetës për nevojat dhe interesat e tyre të ndryshme. Aspekti i gjithëpërfshirjes në të gjitha nivelet e arsimit është veçanërisht i rëndësishëm. Kjo përfshin revidimin e programeve mësimore, mbështetjen e zhvillimit të karrierës dhe forcimin e kapaciteteve të kuadrit mësimdhënës, përdorimin e gjerë të metodave moderne të mësimdhënies, zbatimin e metodave/kritereve moderne të vlerësimit dhe evalvimit me qëllimin përfundimtar përmbushjen e praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare. Harmonizimi përmirëson konkurrencën e nxënësve në nivel global dhe forcon pozicionet e sistemit tonë arsimor në lidhje me integrimin e tij ndërkombëtar, si dhe konkurrencën globale. Për realizimin me sukses të këtij prioriteti nevojiten investime në avancimin e cilësisë së procesit arsimor - avancimi i mësimi, mësimdhënësit, kuadrit profesional dhe drejtues, si dhe zbatimi i politikave të qarta afatgjata në procesin edukativo-arsimor në nivele të ndryshme. Është veçanërisht e rëndësishme të vendoset financimi i qëndrueshëm dhe efikas i procesit arsimor në të gjitha nivelet për të realizuar në mënyrë efektive prioritetin.

3. INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË DHE ATO SHKENCORE TË NJOHURA NDËRKOMBËTARISHT DHE KONKURRUESE

Racionalizimi i rrjetit të gjerë të institucioneve të arsimit të lartë, vendosja e kritereve të rrepta për akreditimin dhe riakreditimin e tyre, vlerësimi dhe nxitja e interesit të institucioneve të arsimit të lartë dhe shkencore për akreditim të jashtëm. Përfshirja në asociacionet evropiane për promovimin e cilësisë në arsim.

4. ARSIMI JOFORMAL I NJOHUR NË SISTEMIN E AFTËSIVE

Është e nevojshme të vlerësohen dhe të njihen njohuritë dhe kompetencat e fituara jashtë institucioneve arsimore. Kjo përfshin vendosjen e mekanizmave për vlerësimin, certifikimin dhe integrimin e aftësive të fituara përmes përvojave jetësore dhe punës, që do të mundësojë që këto aftësi të numërohen dhe njihen në kuadrin kombëtar të aftësive. Me njohjen e tyre, përmirësohen mundësitë për punësim, avancimi në karrierë dhe mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe inkurajohet fuqia punëtore më e kualifikuar dhe e adaptueshme për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe zhvillimin individual.

5. SISTEMI EDUKATIVO-ARSIMOR QË I INKURAJON DHE I ZHVILLON VLERAT DEMOKRATIKE NË SHOQËRI

Krijimi i bazës së fortë të vlerave që do t'u mundësojë të rinjve të fitojnë aftësitë dhe mënyrën e të menduarit të nevojshme për rritjen personale, pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe kontributin në përparimin e përgjithshëm të popullsisë përmes qasjes që i adreson përvojat dhe nevojat e ndryshme të vajzave dhe djemve. Kjo qasje është e nevojshme në formësimin e brezave të ardhshëm, si mishërim i parimeve të integritetit, përgjegjësisë shoqërore dhe angazhimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Qëllimi: Identiteti dhe vlerat e njohura kulturore

Duke ruajtur dhe kultivuar trashëgiminë kulturore kombëtare, traditat, identitetin historik maqedonas dhe karakterin multietnik të vendit, krijohet baza për ndërtimin e përkatësisë së fortë ndaj vendit dhe ndjenjës së unitetit dhe historisë së përbashkët. Më pas, është e nevojshme të njihet kontributi i grave dhe burrave në trashëgiminë kulturore për të garantuar paraqitje të plotë të historisë dhe traditës kombëtare. Pasuria

kulturore dhe industritë kreative e forcojnë indin shoqëror dhe e forcojnë krenarinë kombëtare të komuniteteve të veçanta etnike, por sigurojnë edhe kohezionin e tyre të fortë, duke formuar identitet të gjallë dhe të veçantë që ndërthur dhe promovon karakteristikat multikulturore dhe multi-etnike të shtetit. Në mënyrë shtesë, pasurimi i ofertës së sektorit turistik të vendit do t'i inkurajojë vizitorët të eksplorojnë historinë e tij piktoreske, traditat dhe bukurinë e tij natyrore, njëkohësisht duke inkurajuar shkëmbim më të madh kulturor dhe mundësi ekonomike. Në mënyrë shtesë, theksi do të vihet në afirmimin e potencialeve kombëtare përmes zhvillimit të sportit, gjë që do të ndikojë dukshëm në vendin në korniza ndërkombëtare.

Prioritetet

1. INDUSTRIË E ZHVILLUARA KULTURORE, KREATIVE DHE SPORTI

Sipërmarrësit në sektorin kulturor, industritë kreative dhe sportin, duke përfshirë edhe sipërmarrjen e grave, do të forcohen, ndërsa njëkohësisht pasuria kulturore dhe sporti do të promovohet para publikut global. Kjo forcon sektorin kreativ dhe inkurajon inovacionet, krijimin e vendeve të punës dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Zhvillimi i infrastrukturës së sportit, mbështetja e sportistëve të talentuar dhe zhvillimi i sportit në të gjitha nivelet – nga niveli amator deri te ai profesional. Përmes kësaj, sporti do të luajë rol të rëndësishëm në krijimin e shoqërisë së shëndoshë dhe aktive, dhe do të promovohet krenaria kombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

2. KULTURA, MULTIKULTURA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE NË FUNKSION TË TURIZMIT

Kultura dhe trashëgimia kulturore luajnë rol të madh në turizëm, duke i ofruar Maqedonisë së Veriut mundësinë për të promovuar historinë dhe traditat e saj të pasura në botë, me qasje që i njeh talentet dhe kontributet e ndryshme të grave dhe burrave në kulturë dhe traditë. Duke ruajtur dhe promovuar trashëgiminë e tij kulturore, vendi mund të tërheqë turistë dhe të gjenerojë përfitime ekonomike për komunitetet lokale. Sektori turistik kulturor energjik mund të nxisë ekonominë dhe të mundësojë krijimin e vendeve pune, dhe të ruhet identiteti kulturor i popullit tonë.

3. TRASHËGIMIA KULTURORE REZISTENTE NDAJ RREZIKUT

Zbatimi i strategjive për mbrojtjen e lokaliteteve historike, artefakteve dhe traditave, duke siguruar rezistencë ndaj sfidave të tilla si rreziqet natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, ndryshimet klimatike, urbanizimi dhe ndryshimet kulturore. Në këtë mënyrë, ruhet historia e pasur e vendit tonë.

Roli i procesit të digjitalizimit dhe teknologjive të reja në revitalizimin demografik, zhvillimin social dhe kulturor.

Për të rinjtë, shëndeti dhe prosperiteti janë të lidhura ngushtë me përdorimin e mjeteve digjitale. Platformat edukative online dhe kurset për zhvillimin e aftësive digjitale synojnë t'u mësojnë brezave të rinj se si të funksionojnë në botën ku ka një përqindje të lartë të digjitalizimit. Gjithashtu, aplikacionet e shëndetit mental dhe platformat e mirëqenies digjitale që përdorin inteligjencën artificiale (IA) mund të ofrojnë mbështetje thelbësore dhe të mundësojnë qasje holistike për mirëqenien. Analiza e të dhënave e kombinuar me teknologjitë mjekësore më moderne mundëson kujdesin predikativ dhe identifikon rreziqet e mundshme shëndetësore përpara se të bëhen probleme kronike. Kjo jo vetëm që përmirëson rezultatet e përgjithshme shëndetësore për popullsinë, por edhe e optimizon shpërndarjen e resurseve shëndetësore.

Bazat digjitale të të dhënave e racionalizojnë identifikimin dhe mbulimin e grupeve të cënueshme në shoqëri përmes mbështetjes në kohë dhe të duhur. Kultura dhe trashëgimia kulturore i japin kuptim të ri jetës në epokën digjitale përmes turizmit dhe industrive kreative.

Zgjidhjet digjitale paraqesin qasje të drejtpërdrejtë për t'u përballur me sfidën demografike të ruajtjes së numrit të popullsisë në Maqedoninë e Veriut. Konstatimet e bazuara në të dhënat mund të ofrojnë më shumë informacione për vendimet politike me temën e migracionit të brendshëm dhe të jashtëm, ndërsa platformat online mund të përfshijnë në mënyrë aktive diasporën maqedonase dhe të mundësojnë rrjedhë të dyanshme të njohurive dhe resurseve.

5.4. FUSHA STRATEGJIKE: SUNDIMI I SË DREJTËS DHE MENAXHIMI I MIRË

Maqedonia e Veriut fitoi statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE në dhjetor 2005. Kriteret për anëtarësim në BE u përcaktuan në Samitin e BE-së në Kopenhagë në vitin 1993 dhe u plotësuan në Samitin e Madridit në vitin 1995 dhe përfshijnë: stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave; ekonominë funksionale të tregut dhe aftësinë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut brenda BE-së; aftësinë për të ndërmarrë detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë kapacitetin për të zbatuar në mënyrë efektive rregullat, standardet dhe politikat që e përbëjnë të drejtën e BE-së ("acquis") dhe për të pranuar qëllimet e unionit politik, ekonomik dhe monetar.

Këto janë vlera të përgjithshme të vendeve anëtare që i përcaktojnë postulatet thelbësore të shoqërisë moderne: pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia gjinore. Theksimi i natyrës së vlerave të themeleve dhe qëllimeve të BE-së ka rëndësi të shumëfishtë për reformat e nevojshme përmes të cilave realizohet tranzicioni i Maqedonisë së Veriut. Vlerat që përqendrohen në dinjitetin njerëzor, liritë dhe të drejtat, demokracinë dhe shtetin e së drejtës, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, nuk kanë karakter formal-juridik, por thelbësor të ideve drejtuese. Mbi to duhet të bazohen "arsyeja shtetërore", funksionet e shtetit, sistemi politik, ekonomik dhe juridik. Analizat kombëtare dhe raportet ndërkombëtare tregojnë se ndërtimi i institucioneve dhe marrëdhënieve demokratike është ngadalësuar nga shkalla e lartë e politizimit dhe orientimit populist në veprimet e pushtetit ekzekutiv, të imponuar ndaj pushteteve të tjera. Përkundër kësaj, parimi i sundimit të së drejtës si parim kompleks përfshin legjislacionin e mirë (korrekt), respektimin e vazhdueshëm të parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, integritetin, pavarësinë dhe përgjegjësinë e institucioneve që zbatojnë të drejtën, si dhe krijimin e klimës së respektimit të ligjeve nga subjektet juridike. Raportet e Komisionit Evropian (KE) për progresin në procesin e integritimit evropian, të cilat janë të fokusuar kryesisht në sundimin e së drejtës, shpesh përsërisin konstatimin se Maqedonia e Veriut në masë të madhe ka miratuar ligjet që korrespondojnë me standardet evropiane, megjithatë në masë të madhe mungon zbatimi i tyre efikas. E lidhur drejtpërdrejt me parimin e sundimit të së drejtës është ngritja e gjykatës së pavarur dhe të mëvetësishme si institucion qendror që e garanton zbatimin e qëndrueshëm të saj. Si rrjedhojë, përparimi i reformave gjyqësore në të gjithë sistemin e tranzicionit është matës i vërtetë për përparimin e vendit në procesin e integritimit evropian.

Sundimi i së drejtës dhe menaxhimi i mirë kanë rëndësi vendimtare për zhvillimin e përgjithshëm afatgjatë të Maqedonisë së Veriut. Këto kategori janë vendosur si bazë e sistemit politik, ekonomik dhe juridik në klusterin e parë të negociatave për integritimin e Republikës në BE - Vlerat themelore (para se gjithash, kapitujt 23 dhe 24), i cili hap dhe finalizon procesin e negociatave. Sundimi i së drejtës dhe menaxhimi i mirë janë vlerat themelore të parashikuara në Marrëveshjen e BE-së, të cilat duhet të pranohen plotësisht. Për më tepër, demokracia, rritja ekonomike dhe mirëqenia mund të arrihen vetëm në shoqërinë ku sundimi i së drejtës respektohet shumë. Gjithashtu, vendosja e këtyre parimeve në sistemin politik, ekonomik dhe juridik të Maqedonisë dhe ngritja e kapaciteteve të shtetit, institucioneve publike dhe segmenteve të tjera të shoqërisë për funksionimin e tyre, në përputhje me kriteret politike të Kopenhagës, është parakushti kryesor për zbatimin me sukses të prioritetëve strategjike të përmbajtura në SKZH.

Sipas raporteve dhe vlerësimeve relevante ndërkombëtare, Maqedonia e Veriut për momentin po përballë me sfida serioze në aspektin e respektimit të dobët të sundimit të së drejtës, luftës së kufizuar kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kapjes së institucioneve publike nga partitë politike përmes politizimit ekstrem dhe dominimit të sistemit të "plaçkës" (sistemi "spoils") në emërimin e bartësve të funksioneve publike, si dhe në lidhje me administratën publike jofunksionale.

Sipas matjeve të fundit, të përmbledhura në Indeksin e Sundimit të së Drejtës (2023), vendi është në vendin e 67-të mes 142 vendeve, duke mbajtur të njëjtën notë prej 0,53 pikë indeksi si në klasifikimet e vitit të kaluar (për 2020, 2021 dhe 2022). Sipas kriterit Kufizimi i fuqisë së pushteteve, vendi është në vendin e 97-të me notën 0,47, sipas Mungesës së Korrupsionit është në vendin e 75-të me indeks 0,45, sipas Transparencës së Qeverisë është në vendin e 70-të me notë 0,50, ndërsa sipas të drejtave themelore është në vendin e 56-të me notë 0,60. Sa i përket kriterit të rendit dhe sigurisë, Maqedonia e Veriut është në vendin e 43-të me notë 0,80, sipas Zbatimit të Rregullativës në vendin e 94-të me notë 0,46, sipas Drejtësisë Civile në vendin e 75-të me indeks 0,52 dhe sipas Drejtësia Penale në vendin e 72-të me 0,44 pikë.

Trendet e ngjashme të ngecjes regjistrohen nga Banka Botërore ("The Worldwide Governance Indicators"). Sipas tyre, Maqedonia e Veriut shënoi progres modest në pesë vitet e fundit dhe kjo matet me Indeksin e Kontrollit të Korrupsionit. Pra, nga 40,95 në vitin 2018, vendi kthehet në 34,76 në vitin 2020 për të arritur në 43,87 në vitin 2022. Korrupsioni sistemik është problem i vazhdueshëm në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat renditen poshtë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International (TI, 2022). Në luftën kundër korrupsionit, RMV-ja u ngrit një pozicion nga viti 2021 dhe renditet e 85-ta nga 180 vende, me 40 pikë.

Korrupsioni ka edhe dimensionin e tij gjinor, hulumtimet tregojnë se gratë janë të ekspozuara ndaj korrupsionit në katër fusha: kur kanë qasje në shërbimet bazë, tregjet dhe kreditë, kur angazhohen në politikë, në situatat ku shkelen të drejtat e grave (p.sh., tregtia me njerëz dhe detyrimi seksual, dhe neglizhenca dhe/ose keqmenaxhimi). Sipas hulumtimit të mendimit publik të kryer nga UN Women, korrupsioni është i pranishëm si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik.

Edhe pse burrat dhe gratë konsiderohen të jenë njëlloj të ndjeshëm ndaj korrupsionit, pothuajse një e treta e të anketuarve nga sektori privat dhe një e katërta e të anketuarve nga publiku konsiderojnë se burrat janë më të korruptuar se gratë. Në mënyrë shtesë, fakti që nuk ka mekanizëm të ndjeshëm gjinor për raportimin e korrupsionit kontribuon në trendin e mosraportimit të korrupsionit dhe i ul ndjeshëm garancitë e anonimitetit dhe diskrecionit, besimin në sistemin shtetëror dhe besimin në gjykimin e drejtë, mbrojtjen e vendit të punës dhe të ardhurat. Raportet dhe analizat funksionale, si dhe anketat e mendimit publik tregojnë se qytetarët kanë besim të ulët në institucionet publike dhe veçanërisht në gjyqësor. Sipas matjeve të fundit të mendimit publik, besimi tek gjyqësori ka rënë në nivel të ulët alarmant. Vërejtja kritike kryesore ndaj reformave të zbatuara i referohen zbatimit joefektiv dhe joefikas të legjislationit, i cili është kryesisht i harmonizuar me konventat ndërkombëtare dhe standardet evropiane për fusha të veçanta. Kjo do të thotë se sistemi juridik në tërësi është jofunksional dhe paraqet frenim serioz në zhvillimin e përgjithshëm. Institucionet kompetente për parandalimin e korrupsionit përballen me vështirësi, ndërsa administrata publike nuk është e strukturuar siç duhet dhe shpeshherë ka kapacitete të dobëta profesionale, prandaj nevojat e qytetarëve nuk zgjidhen në mënyrë efektive dhe në kohë.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka arritur shkallë të caktuar të gatishmërisë, përkatësisht është mesatarisht e gatshme të zbatojë të drejtën e BE-së dhe standardet evropiane në fushën e sundimit të së drejtës, të mbuluar nga klasteri i parë (Vlerat themelore, kapitujt 23 dhe 24). Progres është arritur me forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, arritjen e disa qëllimeve nga Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë 2017-2022 (me një plan veprimi për zbatimin e saj) dhe funksionimin më efektiv të prokurorisë publike, i cili vazhdon me zbatimin e rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe të Grupit të lartë të ekspertëve për Çështjet sistematike për Shtetin e së drejtës. Qëllimet e strategjisë nuk janë arritur në masë të madhe për shkak të zbatimit jo të plotë të parimit të pavarësisë financiare të gjyqësorit dhe prokurorisë publike, në lidhje me detyrimin buxhetor për të ndarë 0,8% të BPV-së për gjyqësorin, pasi janë realizuar vetëm 0,3%. Për shkak të planifikimit joadekuat të vendeve të nevojshme dhe të plotësuara gjyqësore, vlerësohet se gjyqësorit të Maqedonisë së Veriut i mungojnë më shumë se 150 gjykatës dhe vetëm në vitin 2022 numri i tyre është zvogëluar për 44 dhe tani kemi 449 gjykatës.

Prandaj, gjykatat nuk mund ta kapërcejnë fluksin e lëndëve të reja, kështu që në vitin 2023 ishin gjithsej 700.000 lëndë gjyqësore aktive, prej të cilave mbi 109.000 janë sjellë nga viti i kaluar pasi kanë mbetur të pazgjidhura. Prokuroria Publike vazhdimisht ballafaqohet me mungesë të resurseve njerëzore, me numër të pamjaftueshëm të prokurorëve publikë dhe nëpunësve të prokurorisë publike. Përkundër kompetencave të gjera ligjore dhe vëllimit të lëndëve, prokuroria gjatë viteve të fundit është përballur me largim të kuadrit për baza të ndryshme, kështu që numri i parashikuar i prokurorëve publikë, i cili duhet të arrijë në gjithsej 262, përfundimisht me fundin në vitin 2022 janë plotësuar gjithsej 174 vende, përkatësisht kjo do të thotë se prokuroria kryen kompetenca me 88 prokurorë publikë më pak se sa ishte planifikuar. Efikasiteti i pamjaftueshëm i prokurorisë publike ndikohet nga mungesa edhe më e madhe e kuadrit ndihmës, siç janë hetuesit dhe nëpunësit. Janë plotësuar vetëm 385 nga gjithsej 1.126 vende pune të parapara në shërbimin e prokurorisë publike. Situata me këto dy institucione, të cilat janë me rëndësi vendimtare për sundimin e së drejtës, e pasqyron neglizhencën e organeve për zbatimin e së drejtës, siç janë shërbimet e inspektimit në nivel lokal dhe shtetëror. Kapacitetet e tyre janë nën çdo minimum të tolerueshëm për zbatim efikas të ligjeve dhe mbikëqyrje mbi institucionet publike dhe qytetarët. Strategjia e re e zhvillimit të gjyqësorit 2024-2028 (miratuar në dhjetor të vitit 2023) synon tejkalimin e dallimeve ndërmjet ligjeve në këtë fushë dhe zbatimin efektiv të tyre, si dhe fuqizimin e mëtejshëm të rolit të pushtetit gjyqësor në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vlerave të përbashkëta, për zbatimin konsekuent të parimit kushtetues të ndarjes së pushtetit dhe garantimit të pavarësisë dhe mëvetësisë, efikasitetit dhe efektivitetit, cilësisë, transparencës dhe përgjegjësisë së institucioneve në sektorin e drejtësisë. Një nga fushat kryesore të planifikimit strategjik të zhvillimit të Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2044 është reforma dhe zhvillimi i institucioneve publike. Ekzistimi i një numri relativisht të madh të institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike, përveç organeve të pushtetit shtetëror, është rezultat i ngritjes ekstensive të rrjetit të tyre nëpërmjet procesit të njëanshëm dhe të pamjaftueshëm të koordinuar të krijimit të institucioneve të reja, pa revizionin e parakohshëm dhe shfuqizimin e revizioneve ekzistuese. Rezultati i trendit të tillë është edhe rritja e vazhdueshme e numrit të të punësuarve në sektorin publik. Sipas të dhënave që disponon Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, gjendja për organet publike është si vijon: në vitin 2016 ishin 1.291 institucione, ndërsa në vitin 2022 numri i tyre u rrit, përkatësisht ishin aktive 1.354 institucione. Në dallim nga reformat në sistemin gjyqësor, reforma e administratës publike po zhvillohet edhe më ngadalë, ndaj gjendja e saj është shumë larg kritereve politike të Kopenhagës për ekzistimin e institucioneve të qëndrueshme, të cilat garantojnë demokracinë, sundimin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave.

Në të gjithë sistemin e administratës publike, ku përfshihen të gjitha institucionet publike në nivel lokal dhe qendror, nuk janë zbatuar në mënyrë konsekuente parimet që e përmbushin përmbajtjen e parimit të menaxhimit të mirë:

- **sundimi i së drejtës**, përkatësisht drejtësia, ligjshmëria dhe paanshmëria në vendimmarrje; udhëheqja **strategjike dhe përgjegjësia, që nënkupton krijimin e politikave dhe vlerësimin e tyre ex-post dhe ex-ante dhe marrjen e vendimeve të bazuara në ligj duke pranuar pasojat që do të lindin prej tyre;**
- **efektiviteti dhe efikasiteti**, që nënkupton realizimin më të mirë të rezultateve të punës dhe përdorimin më të mirë të resurseve të disponueshme;
- **integriteti dhe etika**, që përfshin veprimin e pavarur, profesional, integritetin në arritjen e qëllimeve, veprimin sipas parimeve të larta morale dhe etike në interes të qytetarëve, vendosjen e së mirës publike përpara interesave individuale dhe zbatimin e masave efikase për parandalimin dhe luftën kundër të gjitha formave të korrupsionit dhe konfliktit të interesave;
- **menaxhimi financiar i qëndrueshëm**, i cili imponon maturi në menaxhimin financiar, duke përfshirë lidhjen e kontratave dhe përdorimin e kredive, vlerësimin e mjeteve, të ardhurave dhe rezervave, si dhe në rastin e përdorimit të të ardhurave të veçanta;
- **çiltërsi dhe transparencë** në miratimin e vendimeve që merren dhe zbatohen në përputhje me rregullat, qasja publike në të gjitha informacionet që nuk janë të klasifikuara (sipas kritereve të sakta të përcaktuara me ligj);

- **Ilogaridhënia**, e cila imponon sistem kontrolli të sigurt në ushtrimin e funksioneve dhe krijon detyrimin për të paraqitur raporte për punën e kryer i cili njëherazi siguron edhe cilësi në funksionimin e institucioneve, miratimin e vendimeve që publikohen, shpjegohen dhe mund të jenë lëndë sanksionesh;
- **disponueshmëria dhe pjesëmarrja**, me përfshirje dhe bashkëpunim më të madh në proceset e miratimit të vendimeve, me të gjitha palët e prekura;
- **gjithëpërfshirja**, e cila siguron që shërbimet e qytetarëve të jenë të disponueshme për të gjithë, pa diskriminim; **inovacion, kreativitet dhe transparencë ndaj ndryshimeve**;
- **mësimi i vazhdueshëm dhe përsosmëria** në punë si bazë e veprimit;
- **partneritetet dhe rrjetëzimi** me universitetet, me komunitetin e biznesit, me sektorin civil dhe me të gjithë faktorët relevantë nga të gjitha sferat e jetës shoqërore; barazinë dhe trajtimin e drejtë, si dhe respektimin e dallimeve individuale;
- **përfaqësimi i drejtë** i bazuar në kompetencë dhe profesionalizëm;
- **përgjegjësia shoqërore**, e cila imponon ekzistimin e kornizës etike që inkurajon detyrimin e çdo individi ose institucioni për të vepruar në dobi të shoqërisë në tërësi.

Pavarësisht se këto parime janë të shkruara në dokumentet strategjike për reformën e administratës publike (Strategjia për reformën e administratës publike 2023-2030), procesi i reformës nuk zhvillohet sipas rrugës së përcaktuar nga parimi i menaxhimit të mirë, përkundrazi, kemi punësimin e personave nga listat partiake ose familjare, punësimin në vendet që nuk korrespondojnë me kualifikimet e tyre, avancimin sipas kriterëve subjektive, joefikasitet në punën dhe shkallë të lartë të korrupsionit. Arsyeja kryesore e situatave të tilla është mbizotërimi i sistemit të "plaçkës" (sistemi "spoils"), përmes të cilit punësohen dhe emërohen kuadro partiake në vendet më të larta të administratës publike, përkatësisht njerëz që janë mbështetës të partive në pushtet. Mënyra e tillë e rekrutimit të nëpunësve publikë që në fillim i shtyp kërkesat për efikasitet, paanshmëri, përgjegjësi, integritet dhe moskorrupsion.

Sfidat kryesore për qeverisjen e mirë në funksion të qytetarëve nga perspektiva gjinore të identifikuar në Planin Implementues (CLIP) për Maqedoninë e Veriut, i cili rrjedh nga Plani i Veprimit Gjinor III i Bashkimit Evropian (BE), janë:

- o Dhuna e përhapur gjerësisht ndaj grave: Vendi përballet me një përqindje të konsiderueshme të dhunës ndaj grave.
- o Shkalla e ulët e raportimit të dhunës: Hulumtimi i fundit i OSBE-së tregon se vetëm 2% e dhunës ndaj grave raportohet, gjë që tregon mungesë besimi në sistemet dhe shërbimet ekzistuese, por edhe e bën të vështirë vlerësimin e dimensionit të vërtetë të problemit.
- o Shërbimet joadekuate për viktimat: Mungesa e shërbimeve cilësore që plotësojnë standardet e Konventës së Stambollit është sfidë e rëndësishme. Ekziston nevoja për shërbime të disponueshme, veçanërisht për gratë me aftësi të kufizuara, për të mbrojtur në mënyrë efektive viktimat e dhunës me bazë gjinore.
- o Kapaciteti i policisë: Institucionet e zbatimit të ligjit, si policia, duhet të përmirësojnë kapacitetin e tyre për të vlerësuar me saktësi rrezikun e dhunës dhe të marrin masat e duhura për të mbrojtur viktimat.
- o Korniza juridike dhe zbatimi: Edhe pse është bërë progres me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, nevojiten hapa shtesë. Për zbatimin efikas, është i nevojshëm harmonizimi juridik (p.sh. Kodi Penal), zhvillimi i akteve nënligjore dhe procedurave operative të lidhura.
- o Normat gjinore dhe pronësia e pronës: normat tradicionale gjinore vazhdojnë të ndikojnë në praktikën e pronësisë së pronës, duke favorizuar trashëgimtarët meshkuj, gjë që shpesh çon në regjistrimin e pronës në emrat e bashkëshortëve. Kjo praktikë diskriminon gratë lidhur me pronësinë e pronës. Të dhënat e ndara sipas gjinisë zbulojnë pabarazi të konsiderueshme në pronësinë e pronës, ku shumica e pronarëve janë burra, që e pasqyrojnë pabarazinë gjinore në ushtrimin e të drejtave pronësore.

Pasojë e procesit të ngadalshëm është ngadalësimi i decentralizimit dhe forcimi i pozitës së vetëqeverisjes lokale, në mënyrë që planet për decentralizim dhe zhvillim rajonal të mbeten pa financim adekuat dhe pa efekte të theksuara. Krahas stagnimit të decentralizimit fiskal, mbetet prapa edhe procesi i derregullimit dhe decentralizimit funksional dhe krijimi i menaxhimit të aftë për menaxhim, i cili është i nevojshëm për përfshirje në hapësirën administrative evropiane.

Dobësi e veçantë e sistemit ekzistues është mosekzistimi i kontrollit gjyqësor efikas mbi ligjshmërinë e akteve të administratës publike, i cili kryhet nga gjyqësori administrativ, procedura e të cilit nuk është harmonizuar me standardet e procedurës së drejtë gjyqësore të përcaktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6). Sundimi i ligjit në Maqedoninë e Veriut nuk mund të vendoset pa reformë thelbësore të administratës publike, e cila duhet të përmbajë masa dhe aktivitete të qarta hap pas hapi për të krijuar kornizë ligjore përkatëse, resurse të nevojshme njerëzore, modernizimin dhe digjitalizimin e shërbimeve publike dhe instrumenteve për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, kontrollin mbi punën e institucioneve dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre para gjykatës së pavarur.

Ndikimet e gjyqësorit, prokurorisë publike dhe administratës publike nga ndikimet politike (partiake) dhe ndikimet e lobi-grupeve të tjera patën ndikim të drejtpërdrejtë në shfaqjen e korrupsionit në formë endemike, ose në formën e korrupsionit sistematik, i cili përshkon të gjitha sferat dhe nivelet në shoqëri. Sa i përket luftës kundër korrupsionit, KE-ja në Raportin e saj për Progresin në vitin 2022 vlerëson se vendi ka arritur nivel të caktuar të gatishmërisë, përkatësisht mesatar të përgatitur për parandalimin dhe ndjekjen e korrupsionit.

Është bërë njëfarë progresi duke pasur parasysh se vendi vazhdon të konsolidojë evidencat e hetimit, ndjekjes dhe gjykimit në disa lëndë e korrupsionit, duke përfshirë ato të nivelit të lartë. Në përputhje me rekomandimet e BE-së, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) ofroi në mënyrë aktive udhëzime politike për institucionet publike për parandalimin e korrupsionit dhe hapi disa lëndë, duke përfshirë edhe kundër nëpunësve të lartë, megjithëse u përball me kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe mjete financiare. Megjithatë, organet kompetente për procesimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave po bëjnë përpjekje të pamjaftueshme për zbatimin e plotë të konkluzioneve të raporteve të KSHPK-së. Prandaj, zbatimi i strategjisë kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (2021-2025) dhe planit të veprimit përkatës po ecën ngadalë.

Në vitin 2022 Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) ka përgatitur 223 raporte të revizorit, në të cilat ka konstatuar 1242 situata dhe ka dhënë 775 rekomandime. Shqetësues është fakti që pothuajse gjysma e raporteve kanë mendim jo të favorshëm ose të përmbajtur (75 me mendim të përmbajtur, 35 me mendim jo të favorshëm). Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se përkundër raporteve të shumta të revizorit të ESHR-së, të cilat përmbajnë konstatime dhe rekomandime konkrete për sundimin e së drejtës dhe menaxhimin e mirë të shumë institucioneve publike, ato ende nuk janë zbatuar plotësisht nga institucionet kompetente, nuk janë procesuar dhe nuk ka debat thelbësor për to në komisionet/organet parlamentare.

Gjithashtu, në lidhje me mbrojtjen e pakicave, organet vazhduan zbatimin e strategjisë kombëtare “Një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizmi”. Në lidhje me emigrantët, refugjatët, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drejtën për azil, institucionet shtetërore i harmonizojnë politikat, masat dhe aktivitetet me qëndrimet e BE-së. Në pjesën e të drejtave themelore, ka ende disa pika kritike, prej të cilave i rëndësishëm është qëndrimi pasiv i institucioneve, madje edhe pengimi i punës së Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka reduktuar mjetet buxhetore dhe stafin e pamjaftueshëm administrativ.

Duhet theksuar se nuk po zbatohen zgjidhjet sistematike për tejkalimin e situatës kritike në burgje dhe nuk po veprohet sipas rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), të

publikuara në vitin 2021. Situata në institucionet ndëshkuese përmirësuese do të përmirësohet me qasje adekuate në mbrojtjen shëndetësore, arsimin, kushtet adekuate materiale për jetesë, programet për risocializim dhe riintegrim, kushtet për zbatimin e tyre, ndihmën pas dënimit, të cilat janë ende të paimagjinueshme për personat që janë në vuajtje të dënimit me burg.

Në drejtësinë civile, gjithashtu fushë e rëndësishme e sundimit të së drejtës, mbetet vërejtja e BE-së se Maqedonia e Veriut nuk ka bërë përmirësime të konsiderueshme në procedurat për ushtrimin e së drejtës në pronësi. Këto procedura vazhdojnë të jenë të gjata dhe të shtrenjta për qytetarët, sepse mungon institucioni qendror dhe koordinimi ndërmjet institucioneve që merren me këto të drejta. Pra, më shumë se 6.000 lëndë të denacionalizimit janë ende të hapura dhe përfaqësojnë pjesën më të madhe të ankesave drejtuar Zyrës së Avokatit të Popullit, edhe pse ky proces zyrtarisht ishte shpallur i mbyllur në vitin 2013. Përparim i madh nevojitet gjithashtu në fushën e mbrojtjes së dobët të mjedisit jetësor, duke pasur parasysh cenueshmërinë e fortë ndaj rreziqeve natyrore dhe kërcënimit brutal të të drejtave të njeriut ndaj mjedisit jetësor të shëndetshëm dhe të pastër.

5.4.1 Misioni

Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të zhvillohet si bashkësi e bazuar në sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë, si garancia më e fortë për respektimin e të drejtës së qytetarëve për lumturi dhe cilësi më të mirë të jetës. Deri në vitin 2044, si anëtare e re e BE-së, shteti do t'i sigurojë të gjitha liritë dhe të drejtat e qytetarëve të Maqedonisë, si shtetas të BE-së. Të gjitha institucionet e pushtetit - legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor do t'i ushtrojnë funksionet e tyre bazuar në vlerat dhe standardet evropiane, me gjyqësor shumë efektiv, llogaridhënës, transparent dhe plotësisht të digjitalizuar, me administratë publike të fortë, shumë profesionale dhe të depolitizuar dhe efikase, me qytetarë të cilët janë pjesëmarrës të vërtetë në vendimmarrjen politike dhe në të njëjtën kohë grupet e cenueshme mbrohen në të gjitha nivelet; me pjesëmarrjen thelbësore të komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe partive politike në krijimin e politikave publike nëpërmjet avancimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve demokratike dhe dialogut në të gjitha nivelet dhe me bartësit përgjegjës të funksioneve publike dhe ofruesve të shërbimeve publike. Shteti do të krijojë mjedis ku do të ketë kushte për drejtësi dhe siguri më të madhe sociale për të gjithë qytetarët, të cilët do të jetojnë si në shtetet ekonomikisht më të zhvilluara me demokraci funksionale.

5.4.2 Qëllimet

Për realizimin e misionit janë përcaktuar këto qëllime

1. Sundimi i së drejtës dhe parimi i zbatuar në mënyrë konsekuente i ndarjes së pushtetit dhe kontrollit efektiv parlamentar;
2. Sektori publik transparent, llogaridhënës dhe efikas;
3. Shoqëria e fortë civile dhe mediat e lira dhe të pavarura;
4. Zero korrupsion, siguria juridike dhe drejtësia joselektive;
5. Mbrojtja efikase e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe mbrojtja e komuniteteve.

Qëllimi: Sundimi i së drejtës dhe parimi i zbatuar në mënyrë konsekuente i ndarjes së pushtetit dhe kontrollit efektiv parlamentar

Parimet e sundimit të së drejtës dhe respektimi i lirive dhe të drejtave natyrore të njeriut e plotësojnë kërkesën për qasje të re ndaj politikës dhe partive si protagoniste të saj. Para se gjithash,

vendi duhet të përpiqet të përshpejtojë procesin e integritit evropian dhe të fillojë negociatat për anëtarësim në BE. Fokusi i të gjithë faktorëve shtetërorë duhet të orientohet drejt perspektivës së anëtarësimit në BE, duke pasur parasysh mbështetjen e lartë nga qytetarët. Për të arritur këtë qëllim prioritar, është e nevojshme të zbatohet në mënyrë konsekuente parimi i ndarjes së pushtetit dhe të krijohet korniza solide institucionale për sundimin e së drejtës. Arritja e këtij qëllimi është kusht i domosdoshëm për vendosjen e marrëdhënies së ekuilibrit, koordinimit dhe kontrollit të ndërsjellë të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si parakusht thelbësor për sundimin e së drejtës, përmes të cilit gjendja e mbifugës së pushtetit ekzekutiv dhe ndikimi i tij nga të dy pushtetet do të tejkalohet. Përveç kufizimeve kushtetuese dhe ligjore të pushtetit ekzekutiv, ky qëllim mund të arrihet përmes reformës thelbësore të gjyqësorit dhe administratës publike.

Prioritetet

1. PËRSHPEJTIMI I PROCESIT EUROINTEGRUES

Republika e Maqedonisë së Veriut në vitet e fundit ka bërë përparim të madh në rivendosjen dhe zhvillimin e demokracisë dhe proceseve demokratike dhe duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian sa më shpejt të jetë e mundur. Prandaj, prioritet janë aktivitetet që kanë të bëjnë me intensifikimin e proceseve për vazhdimin e rrugës evropiane të vendit, përmes hapave dhe vendimeve në drejtim të vazhimit të integritit evropian dhe anëtarësimit të plotë në BE.

Përmbushja e detyrimeve në drejtim të rrugës së integritit evropian paraqet një katalizator për proceset e zhvillimit ekonomik dhe social që janë të nevojshme për përafrimin e standardeve evropiane maqedonase të jetës.

2. ZBATIMI KONSEKUENT I PARIMIT TË NDARJES SË PUSHTETIT DHE KRIJIMIT TË INSTITUCIONEVE EFIKASE DHE TË DECENTRALIZUARA

Zhvillimi i mëtutjeshëm i Maqedonisë së Veriut duhet të bazohet në intensifikimin e proceseve për krijimin e institucioneve efikase dhe të decentralizuara, të cilat në afat të gjatë duhet të udhëheqin procesin e tejkallimit të krizës, shkrirjes së integritit euroatlantike dhe zhvillimit të shoqërisë bazuar në parimet liberale të shtetit juridik demokratik. Kjo do të arrihet vetëm duke iu kthyer burimeve të pluralizmit dhe forcës lëvizëse të ndryshimeve demokratike, që janë liria individuale dhe individualizmi demokratik, të drejtat natyrore të njeriut, barazia gjinore dhe parimet e shtetit juridik demokratik si promotor dhe mbrojtës i tyre.

3. PARTITË POLITIKE SI PROMOTORE TË PROCESIVE DEMOKRATIKE

Kriza e vazhduar politike në Republikë i shkeli parimet kushtetuese të ndarjes së pushtetit, kufizimet kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe mbifugës politike të Kuvendit ndaj Qeverisë. Kapja e shoqërisë dhe e institucioneve shtetërore nga partitë që fitojnë zgjedhjet parlamentare dhe pretendojnë pushtetin absolut është abuzim serioz i lirisë së bashkimit politik dhe së drejtës themelore të njeriut për demokraci dhe sundim të së drejtës. Nga situata e tillë mund të dalim vetëm me parti politike që do të jenë promotorët kryesorë të aspiratave demokratike. Ato duhet të kenë parasysh mundësinë e papërsëritshme për ta çuar vendin përpara dhe për të përmbushur kërkesën e qytetarëve, që vendi të bëhet anëtare e plotfuqishme e BE-së.

4. GJYKATA TË PAVARURA, PROKURORI TË PAVARURA DHE EFEKTIVE DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË DREJTËSISË

Parimi i shtetit të së drejtës është i lidhur ngushtë me krijimin e organeve transparente, të pavarura dhe të përgjegjshme të drejtësisë. Gjykata dhe gjykatësi janë protagonistët kryesorë të shtetit juridik dhe të parimit të sundimit të së drejtës. Në kontekst të parimit të ndarjes së pushtetit, ata duhet të

sigurojnë respektimin dhe zbatimin e ligjit, ndër të tjera, dhe të vendosin kontroll efektiv mbi pushtetin ekzekutiv dhe administratën shtetërore në pjesën e shpalljes së të drejtës dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Prandaj, progresi i reformave në gjykata, prokurori publike (si dhe në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë) në të gjithë sistemin e tranzicionit është matës i vërtetë i progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në procesin e integritetit evropian.

Qëllimi: Sektori publik transparent, llogaridhënës dhe efikas

Realizimi efektiv i të drejtave dhe lirive të qytetarëve përmes rritjes së përgjegjësisë së institucioneve është një nga parakushtet themelore në drejtim të forcimit të transparencës së sektorit publik dhe organeve shtetërore, përkatësisht organizatave që u përgjigjen qytetarëve me të gjitha konsekuencat e mëtejshme të kontrollit civil mbi ushtrimin e funksioneve publike, llogaridhënies dhe përgjegjësisë. Sektori publik duhet të njohë nevojat dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave në proceset e forcimit të transparencës dhe llogaridhënies. Në mënyrë shtesë, transparenca ndikon pozitivisht edhe në zhvillimin ekonomik të shtetit, duke kontribuar në racionalitet më të madh në vendimmarrje, si dhe në aspiratat e tij euroatlantike. Ai është plotësues i reformës së administratës publike dhe transformimit të institucioneve publike në shërbim të qytetarëve. Arritja e këtij qëllimi supozon model të sistemit zgjedhor që mundëson shprehjen sa më të gjerë dhe më të lirë të vullnetit të qytetarëve në konstituimin e pushtetit parlamentar dhe garanci solide kushtetuese dhe ligjore, kufizime dhe përgjegjësi të institucioneve në të tre llojet e pushtetit. Me arritjen e këtij qëllimi do të ripërtërihet besimi i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut në sektorin publik.

Prioritetet

1. PROCEDURA TRANSPARENTE DHE DEMOKRATIKE PËR MIRATIMIN E LIGJEVE LEGJITIME DHE VENDIMEVE TË TJERA

Pushteti ligjvënës garanton miratimin e ligjeve në procedurë transparente dhe demokratike të rregulluar me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo procedurë nënkupton legjitimitetin e ligjeve dhe vendimeve të tjera, të cilat duhet të jenë të qarta, të publikuara dhe të disponueshme për të gjithë, të qëndrueshme dhe me pasoja të parashikueshme, kurse zbatimi i tyre duhet të jetë joselektiv dhe të garantojë mbrojtje të barabartë të lirive dhe të drejtave, siguri juridike dhe barazi përpara ligjit.

2. ZBATIMI KONSEKUENT DHE I VAZHDUESHËM I LIGJEVE TË MIRATUARA DHE RESPEKTIMI I OBLIGIMEVE KONTRAKTUESE

Miratimi dhe zbatimi i masave për mbikëqyrjen e procedurave për zbatimin e ligjeve, mekanizmi dhe sistemi i vendosur për ndjekjen e zbatimit konsekuent dhe të vazhdueshëm të ligjeve, por edhe respektimi i detyrimeve që dalin nga marrëveshjet e lidhura në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar përmes bashkëpunimit dhe besimit ndërinstitucional.

3. PËRZGJEDHJA, EMËRIMI, PUNËSIMI DHE AVANCIMI NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË BAZË TË SISTEMIT TË MERITAVE

Zbatimi i parimit të përzgjedhjes, emërimit, punësimit dhe avancimit në administratën publike sipas sistemit të kualifikimeve, njohurive dhe meritave. Sistemi i njohurive dhe meritave duhet të jetë bazë për krijimin e administratës publike të fortë dhe efikase dhe funksionarëve publikë efektivë, transparentë dhe llogaridhënës.

4. RITJA E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Ndërtimi i besimit të publikut në institucionet shtetërore dhe të pushtetit vendor dhe krijimi i një mjedisi transparence, përgjegjshmërie, përgjegjësie dhe besimi në pritje të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

5. KONTROLI GJYQËSOR MBI LIGJSHMËRINË E AKTEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Forcimi i kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe ligjshmërisë së rregullave të organeve publike. Racionalizimi dhe optimizimi i sektorit publik dhe ngritja e kornizës juridike të qëndrueshme, në mënyrë që të mos jetë e mundur të krijohen vazhdimisht organe të reja administrative përtej atyre të parashikuara në rregullat sistematike me ligje të veçanta/materiale.

6. DIGJITALIZIMI I SERVISEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE QASJA E LIRË NË INFORMACIONET E QYTETARËVE PËR FUNKSIONIMIN E TYRE

Digjitalizimi si prioritet nënkupton modernizimin e lartë të vendit nëpërmjet përdorimit të teknologjive informatike në sektorin publik dhe privat, **të disponueshme dhe të përshtatura me mundësitë dhe nevojat specifike të burrave dhe grave**. Veglat digjitale, janë mjet për modernizimin e ekonomisë dhe për rrjetëzim më të mirë të saj në ekonominë botërore, ato janë të dobishme edhe për tranzicionin në shoqëri të bazuar në dije në drejtim të menaxhimit, si dhe për krijimin e industrive novatore që prodhojnë vlerë të lartë të shtuar. Maqedonia e Veriut duhet të përshpejtojë transformimin digjital, të promovojë ekonominë dhe arsimin digjital, të rrisë arsimimin digjital dhe të digjitalizojë plotësisht shërbimet publike. Kjo do të mundësojë qasje të lirë në informacionet e qytetarëve për funksionimin e tyre.

7. ADMINISTRATA PUBLIKE E ORIENTUAR DREJT ARRITJES SË REZULTATEVE

Mirëqeverisja e institucioneve publike është e lidhur ngushtë me qëllimin e reformës së administratës, pra ekzistencën e një administrate publike efikase, efektive, cilësore, transparente dhe të përgjegjshme, që u ofron qytetarëve parashikueshmëri dhe shërbime publike cilësore. Është e nevojshme të ketë garë të drejtë mes partive politike që luftojnë për marrjen e pushtetit, institucioneve demokratike, ndarjes efektive dhe të vërtetë të pushtetit, por edhe përgjegjësisë horizontale dhe vertikale, si dhe cilësi më të lartë të politikave, që arrihet nëpërmjet demokratizimit të hartuesve të politikave dhe orientimit më të madh drejt rezultateve.

8. KRIJIMI I POLITIKAVE ME PJESËMARRJEN E ORGANIZATAVE QYTETARE, QYTETARËVE DHE PALËVE TË TJERA TË PREKURA

Me këtë fushë prioritare, mundësohet që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë thelbësore në miratimin e vendimeve, përkatësisht kjo është një mundësi që të gjitha palët e interesuara të ndikojnë në zhvillimin e politikave dhe ligjeve që i prekin. Së dyti, ajo e mbulon të drejtën e kontrollit civil mbi ushtrimin e pushtetit dhe parandalimin e abuzimeve të tij, nëpërmjet organizatave qytetare aktive, qytetarëve dhe palëve të prekura të përfshirë në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet. Kjo nënkupton sigurimin e kushteve për numrin më të madh të qytetarëve të informuar, por edhe konsultimin e tyre në rast kur duhet të miratohen politikat dhe vendimet. Bie në sy trendi pozitiv i forcimit të koordinimit dhe rrjetëzimit të shoqërisë civile në bashkëpunim me Qeverinë, veçanërisht në pjesën e reformave në sektorin e drejtësisë.

Qëllimi: Shoqëria e fortë civile dhe mediat e lira dhe të pavarura

Shoqëria e fortë civile dhe mediat e lira janë shtyllat më të rëndësishme për krijimin e shoqërisë demokratike, funksionale dhe të begatë. Duhet të krijohet korniza kombëtare që do të mundësojë dhe inkurajojë funksionimin e sektorit civil aktiv si palë e prekur kryesore në planifikimin dhe zbatimin e ndryshimeve në të gjitha nivelet. Krijimi i mjedisit në të cilin mediat do të jenë të lira të shprehin qëndrimet e tyre, të pavarura nga ndikimet politike dhe të biznesit, me nivel të lartë etik, përgjegjësi dhe paanshmëri.

Prioritetet

1. SEKTORI I FORTË CIVIL SI BAZË PËR SHOQËRINË LLOGARIDHËNËSE, TRANSPARENTE DHE DEMOKRATIKE

Forcimi i vazhdueshëm i sektorit civil, i cili paraqet bazën dhe sigurinë për zhvillimin afatgjatë dhe krijimin e politikave në pajtim me nevojat e qytetarëve. Është e nevojshme ofrimi i mbështetjes së përhershme dhe të qëndrueshme financiare dhe jofinanciare për sektorin civil dhe përfshirjen e tij formale dhe joformale në të gjitha proceset reformuese të shtetit në të gjitha nivelet. Krijimi i mjedisit për partneritetin real të sektorit civil me sektorin publik dhe komunitetin e biznesit do të jetë baza për krijimin e ndryshimeve transparente, llogaridhënëse dhe afatgjata të qëndrueshme.

2. LIRIA E MEDIAVE PËR INFORMIMIN OBJEKTIV

E drejta e lirisë së shprehjes është një nga bazat më thelbësore të shoqërive demokratike dhe një nga kushtet kryesore për përparimin e saj. Në sistemet demokratike, çdo individ ka të drejtë të shprehë mendimin e tij, të komunikojë, të marrë dhe të transmetojë informacione dhe ide, dhe kjo e drejtë duhet të jetë funksionale. Mediat mundësojnë kontroll dhe vlerësim të vazhdueshëm të aktiviteteve të pushtetit dhe ndihmojnë që çështjet me interes të debatohen siç duhet në sferën publike. Mediat duhet të jenë të lira të shprehin qëndrimet e tyre, të pavarura nga ndikimet politike dhe të biznesit, me nivel të lartë etik, përgjegjësi dhe paanshmëri. Parakusht për këtë janë korniza juridike moderne, që do të garantojë të drejtën e shprehjes dhe do të mbrojë punonjësit e mediave; rregullimi i pavarur i mediave; qëndrueshmëria e tyre financiare; zhvillimi profesional i gazetarëve dhe punonjësve të mediave; respektimi i standardeve etike, dhe mbi të gjitha, vullneti politik.

Qëllimi: Zero korrupsion, siguria juridike dhe drejtësia joselektive

Krimi i organizuar, korrupsioni dhe format e reja të krimit, si krimet ekonomike, ekologjike ose kompjuterike, të cilat po depërtojnë gjithnjë e më shumë në të gjitha sferat e shoqërisë, paraqesin kërcënimin më serioz për liritë dhe të drejtat e njeriut. Lufta më efikase kundër këtyre dukurive është zbatimi konsekuent i standardeve universale të qeverisjes së mirë. Prandaj, është i domosdoshëm legjitimiteti i ligjeve, të cilat duhet të jenë të qarta, të publikuara dhe të disponueshme për të gjithë, të qëndrueshme dhe me pasoja të parashikueshme. Nevojitet ligjet dhe mekanizmat juridikë të promovojnë barazinë gjinore dhe të parandalojnë diskriminimin ose paanshmërinë në procedurat ose rezultatet juridike. Zbatimi i tyre duhet të jetë joselektiv dhe të garantojë mbrojtje të barabartë të lirive dhe të drejtave, të sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit. Shteti duhet të sigurojë qasje të lirë në gjykatë, procedurë të drejtë dhe efektive për zbatimin e ligjeve për të gjithë qytetarët dhe drejtësi e shpejtë dhe e disponueshme dhe mbrojtje gjyqësore, e cila zbatohet nga individë dhe institucione kompetente, integrale etike dhe të pavarura, të organizuara mirë dhe të gatshme për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve.

Prioritetet

1. ZBATIMI I STANDARDEVE UNIVERSALE TË QEVERISJES SË MIRË

Zbatimi i standardeve universale të formuluar në konventat ndërkombëtare, të cilat i referohen abuzimit me pushtetin, krimit dhe korrupsionit ose parashikohen në mënyrë eksplicite si kritere politike që duhet të përmbushë çdo vend kandidat për anëtarësim në BE ("Kriteret e Kopenhagës").

2. LUFTA EFIKASE KUNDËR KORRUPSIONIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE ABUZIMEVE ME PUSHTETIN NË TË GJITHA NIVELET

Rritja e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit nëpërmjet ndjekjes së vazhdueshme të korrupsionit, krimit të organizuar dhe abuzimeve me pushtetin. Është e nevojshme të ndiqet zhvillimi i krimit dhe korrupsionit në format më të reja dhe mënyra e funksionimit të tyre, profilimi i kryerësve dhe analizimi i motiveve të tyre. Ky prioritet do të realizohet nëpërmjet rishikimit të praktikave të vendosura, identifikimit të problemeve sistematike, rekomandimeve dhe konstatimeve për të gjithë pjesëmarrësit relevantë për aktivitetet e tyre të mëtejshme, njëkohësisht duke iu adresuar deficiteve në zbatimin e drejtësisë.

3. INSTITUCIONET SHETËRORE TË PAVARURA, FUNKSIONALE DHE TË MIRËKOORDINUARA

Garancia për përmbushjen e funksioneve të institucioneve shtetërore është respektimi konsekuent i parimeve të ligjshmërisë, transparencës, profesionalizmit, llogaridhënies dhe përgjegjësisë. Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional është një nga parakushtet e rëndësishme për institucionet funksionale.

Qëllimi : Mbrojtja efiKase e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe mbrojtja e komuniteteve

Në kuptimin legjislativ, Maqedonia e Veriut i përmbush detyrimet e saj ndërkombëtare në respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut duke ratifikuar konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sfidat është respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në praktikë. Kjo veçanërisht i referohet mbrojtjes së grupeve të marginalizuara, të drejtat e të cilave janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të shpeshta, ato nuk kanë mbrojtje adekuate dhe efiKase dhe në fushën e mbrojtjes së tyre në mënyrë joadekuate zbatohen rekomandimet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat e ndjekin zbatimin e të drejtave të njeriut. Në lidhje me mbrojtjen efiKase të të drejtave të mjedisit jetësor, si pjesë e lirive dhe të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë, Maqedonia e Veriut duhet të jetë shoqëri që do të krijojë politika, formulime ligjore dhe zgjidhje në fushën e mjedisit jetësor për t'u përballur me ndryshimet klimatike globale dhe sfidat ekologjike, duke e njohur këtë problem në nivel qendror dhe lokal. Ky qëllim supozon forcimin e instrumenteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut përpara gjykatave dhe administratës publike, përfshirë edhe para Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet reformave të Kushtetutës dhe ligjeve materiale e procedurale, si dhe me forcimin e funksionit social të organeve dhe organizatave që janë kompetente që të kujdesen dhe mbrojnë kategori të cënueshme të personave. Forcimi i drejtësisë ekologjike imponon kërkesë për ngritjen e kornizës së re kushtetues dhe ligjore, në përputhje me konceptin e ekonomisë së gjelbër dhe drejtësisë dhe solidaritetit ndër breza.

Prioritetet

1. SHTETI KU MBRETËRON BARAZIA, MOSDISKRIMINIMI DHE DREJTËSIA

Promovimi i të drejtave themelore, mosdiskriminimi dhe mundësitë e barabarta për të gjithë janë çelësi i shoqërisë funksionale dhe të drejtë dhe procesi i suksesshëm integruar në BE. Në këtë kuptim, shteti duhet të sigurojë mbrojtje efikase të të drejtave dhe lirive të komuniteteve të marginalizuara, dhe mbi të gjitha, të moshuarve, të papunëve afatgjatë, personave me invaliditet, pakicave racore dhe etike, personave që kanë vuajtur dënimin me burg, të varfërve, të pastrehëve, individëve të marginalizuar, personave që janë pjesë e rrjedhave të migrimit ose grupeve. Parimet e mosdiskriminimit nënkuptojnë se çdo person i interesuar do të jetë në gjendje në mënyrë të barabartë të qaset në të dhënat e mbuluara nga kjo strategji. Sipas parimit të mosdiskriminimit, organet dhe organizatat e përfshira në këtë strategji duhet të ofrojnë qasje në të dhënat si për personat e kategorive të cënueshme ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuara, bazuar në parimin e barazisë, paanshmërisë dhe objektivitetit, parimin e orientimit në shërbim të organeve publike dhe parimin e ndihmës aktive për palën.

2. MULTIKULTURALIZMI, RESPEKTI RECIPROK I KOMUNITETEVE ETNIKE, FETARE DHE TË TJERA DHE PATRIOTIZMI KUSHTETUES

Shteti duhet të kujdeset dhe t'i avancojë të drejtat kolektive të komuniteteve kombëtare, etnike, fetare dhe të tjera, që nënkupton kultivimin dhe zhvillimin e kulturës, gjuhës, traditave dhe besimit kombëtar. Politikat kulturore, nga ana tjetër, duhet t'u përgjigjen nevojave për ruajtjen e trashëgimisë së pasur kulturore të vendit, për të promovuar identitetet heterogjene, dinamike, sociale dhe kulturore në vend dhe në të njëjtën kohë për të nxitur zhvillimin më të gjerë kulturor të qytetarëve.

3. MBROJTJA E KOMUNITETEVE PAKICË, TË VARFËRVE DHE PERSONAVE QË JANË PJESË E RRJEDHJAVE TË MIGRIMIT

Ndërtimi i shoqërisë me zhvillim gjithëpërfshirës është i lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave të njeriut në kuptimin më të gjerë dhe mbrojtjen nga çdo formë diskriminimi. Kohezioni social është elementi thelbësor i shoqërisë së suksesshme dhe shpesh shërben si tregues se shteti është vend i mirë për të jetuar dhe punuar. Shteti përpaket për realizimin dhe avancimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, para se gjithash, përmes realizimit të të drejtave në fushën e punësimit, arsimit, kulturës dhe fushave tjera në të cilat të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve rregullohen me ligj. Me realizimin e këtij prioriteti do të përmirësohet zbatimi i të drejtave të komuniteteve, do të lehtësohet ndjekja e shkallës së realizimit të tyre dhe do të sigurohet mbikëqyrja e realizimit të këtyre të drejtave nga institucionet në nivel qendror dhe lokal. Në mënyrë plotësuese, koncepti i zhvillimit të politikës integruese ndaj të huajve me qëndrim të rregulluar në vend, azilkërkesve dhe refugjatëve, duhet të mundësojë politika/masa shtetërore, me të cilat do të mundësohet, nëpërmjet integritit në procesin arsimor dhe në veprimtaritë e tjera sociale, që ky grup i prekur të bëhet pjesë e përgjegjshme e jetës ekonomike, shoqërore dhe politike në vend, me respekt të plotë të dallimeve kulturore dhe sociale, si dhe të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor.

4. SISTEMI HUMAN I BURGJEVE DHE RISOCIALIZIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË DËNUAR MË PARË

Kjo fushë prioritare garanton përmirësimin e pozitës dhe realizimin e të drejtave të personave të dënuar, përfshirë gratë, por edhe përmirësimin e gjendjeve në ekzekutimin e sanksioneve, trajtimin e personave të dënuar dhe kushtet në të cilat ata jetojnë dhe punojnë. Me ta duhet të vepohet në mënyrë njerëzore, me respekt për personalitetin dhe dinjitetin njerëzor, duke ruajtur shëndetin e tyre trupor dhe shpirtëror, duke pasur parasysh qëllimet e sanksioneve të veçanta, të cilat do të kontribuojnë në risocializimin dhe riintegrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri pas vuajtjes së dënimit. Maqedonia e Veriut duhet të kujdeset për kryerësit e mitur të veprave penale, fëmijët në rrezik dhe fëmijët në konflikt

me ligjin, duke zbatuar proces të detyrueshëm arsimor dhe programe që inkurajojnë tipare pozitive dhe zhvillimin e personalitetit dhe mundësojnë trajnimin dhe aftësimin për risocializim dhe riintegrim në shoqëri.

5. MBROJTJA EFIKASE E TË DREJTAVE PËR MJEDIS TË SHËNDETSHËM JETËSOR

Prioriteti për mbrojtjen më të lartë të mjedisit të shëndetshëm jetësor është i rëndësishëm në kontekstin e disa qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm - ujë i pastër i pijshëm dhe nevoja sanitare, energjia e pastër, prodhimi dhe konsumi i qëndrueshëm, përballimi i ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e tokës. Prandaj, nevojitet sigurimi i vazhdueshëm i mjedisit jetësor të sigurt, të pastër dhe të qëndrueshëm. Kërcënimi ndaj mjedisit jetësor mund të kenë pasojë veçanërisht të rënda në realizimin e të drejtave të grupeve më të cenueshme, si fëmijët, të rriturit, personat me aftësi të kufizuara, gratë dhe njerëzit me sëmundje kronike, ose mbi të drejtat e atyre që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të veçantë nga dëmi i shkaktuar në mjedisin jetësor, ku, mbi të gjitha, mendohet për fermerët, peshkatarët, punëtorët e ndërtimit dhe të gjithë ata që janë të ekspozuar ndaj pasojave drastike të motit të ndryshimeve klimatike. Si rrjedhojë, progresi në këtë sferë do të reflektojë pozitivisht në kontributin e vendit në realizimin e agjendës globale për zhvillim të qëndrueshëm.

6. QASJA NË DREJTËSI

Instrumentet që Maqedonia e Veriut mund dhe duhet të përdorë për të arritur qasje në drejtësi për personat e marginalizuar përfshijnë: mbrojtjen juridike (njohjen e aftësisë juridike, afariste dhe hetimore), forcimin e ndërgjegjësimit dhe informacionit juridik, ndihmën juridike falas, procedurën e drejtë gjyqësore dhe administrative, zbatimin efektiv dhe rritjen e rolit të parlamentit, Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile. Roli i procesit të digjitalizimit dhe teknologjive të reja për sundimin e së drejtës dhe menaxhimin e mirë.

Digjitalizimi forcon sundimin e së drejtës dhe menaxhimin e mirë dhe paraqet mundësi të madhe për të rritur efikasitetin, efektivitetin, transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë, të cilat janë me rëndësi vendimtare për lulëzimin e shoqërisë demokratike. Teknologjia forcon kontrollin efikas parlamentar me platforma digjitale që mundësojnë mbikëqyrje në kohë reale dhe komunikim të vazhdueshëm midis organeve të pushtetit shtetëror. Mjetet digjitale janë të pazëvendësueshme në synimin e Maqedonisë së Veriut për sektorin publik transparent, llogaridhënës dhe efikas. Iniciativat e e-menaxhimit modernizojnë ndërveprimet e qytetarëve me shtetin, i bëjnë shërbimet më të disponueshme dhe i racionalizojnë proceset. Platformat e të dhënave të hapura jo vetëm që i bëjnë të dhënat e sektorit publik të disponueshme për të gjithë qytetarët, por edhe të lehta për t'u kuptuar, duke rritur kështu llogaridhënien e qeverisë. Progresi digjital i jep përparësi të rëndësishme kërkimit të sigurisë juridike dhe drejtësisë jouselektive. Shërbimet juridike online dhe gjykatat digjitale përmirësojnë qasjen në drejtësi dhe përshpejtojnë procedurat ligjore. Angazhimet e Maqedonisë së Veriut për të ruajtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe mbrojtjen e komunitetit marrin kuptim të ri në botën digjitale.

5.5. FUSHA STRATEGJIKE: SHOQËRI E SIGURT DHE REZISTENTE

Profili i rreziqeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut karakterizohet nga ndikimi i një sërë rreziqesh natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, të dominuara nga përmytjet, tërmetet, ngjarjet ekstreme të motit, rrëshqitjet e dheut, thatësitat, epidemitë dhe incidentet tekniko-teknologjike. Përmytjet janë më të shpeshtat me intensitetin dhe magnitudën më të madhe; ngjarjet e lidhura me motin janë në rritje; zjarret në pyje po rriten në frekuencë dhe pasoja për natyrën dhe biodiversitetin, ndërsa tërmetet kanë potencialisht ndikimin më të madh në aspektin e humbjeve të jetëve të njerëzve dhe dëmeve dhe humbjeve afatgjata. Ky trend pritet të vazhdojë me ritme të shtuara, duke marrë parasysh: rritjen e temperaturës mesatare, pasojat e pritshme të ndryshimeve klimatike dhe ngjarjet ekstreme, përkeqësimin e kushteve të mjedisit jetësor, urbanizimin intensiv, etj.

Sipas Fondit Global për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (ang. Global Facility for Disaster Risk Reduction - GFDRR), përmytjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nivel vjetor prekin mesatarisht 70.000 njerëz, ndërsa dëmi arrin në 500 milionë dollarë amerikanë, (3,68% e BPV-së për vitin 2022). Analizat tregojnë edhe se mesatarisht 40.000 qytetarë të Maqedonisë janë të prekur nga tërmetet, ndërsa efektet negative janë 200 milionë dollarë amerikanë (1,47% e BPV-së për vitin 2022)¹⁸. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), vendi ka rrezik mesatar deri në rrezik të lartë të tërmeteve, ndër të cilët më shkatërrues në kohët e fundit ishte tërmeti në Shkup në vitin 1963, kur më shumë se 1000 njerëz vdiqën, kurse 80% e qytetit u shkatërrua. Rreziqet e mundshme brenda kapaciteteve kimike të shtetit gjithashtu duhet të menaxhohen siç duhet.

Nga viti 1999 deri në vitin 2021, në baza vjetore, sipërfaqja mesatare prej 8.837 ha është prekur nga zjarret pyjore që kanë shkaktuar dëme prej rreth 7,8 milionë euro¹⁹. Thatësitat e shpeshta dhe të rënda, veçanërisht në pjesët jugore dhe lindore të Republikës së Maqedonisë së Veriut i përkeqësojnë kushtet socio-ekonomike. Për shembull, thatësira e gjatë në vitin 1993 shkaktoi dëme të konsiderueshme në të korrat dhe çoi në humbjen e të ardhurave kombëtare prej 7,6%²⁰. Në dy dekadat e fundit, në 14 fatkeqësi të këtij lloji ka pasur 79 viktima njerëzore, janë prekur rreth 1,3 milionë banorë dhe vetëm tetë nga këto fatkeqësi kanë shkaktuar dëme në vlerë prej gjysmë miliardë dollarë amerikanë. Më së shumti viktima njerëzore u regjistruan gjatë përmytjeve të rrëmbyeshme në Shkup në gusht 2016 (22), zjarret pyjore në korrik 2007 prekën pothuajse gjysmën e popullsisë së vendit, ndërsa përmytjet në vitin 1995 kishin dëmin më të madh prej 245 milionë dollarë amerikanë.

Shteti përballlet me vështirësi në përballimin e dukurive hidrologjike, si thatësitat dhe përmytjet, si rezultat i resurseve të kufizuara financiare, kapaciteteve teknike të vjetruara dhe mbështetjes së pamjaftueshme (joadekuate) institucionale dhe kornizave ligjore. Ministria e Shëndetësisë e njej nevojën për të forcuar kapacitetet shëndetësore, prandaj RMV-ja është prioritet në Programin e Rasteve Urgjente Shëndetësore të OBSH-së për rajonin evropian²¹. Një në katër (23%) gra thonë se kanë jetuar në situatë ku ka pasur konflikt aktiv të armatosur për të paktën një javë gjatë jetës së tyre, por jo të gjitha mund të klasifikohen si të prekura drejtpërdrejt nga konflikti. Kjo është më e përfaqësuar në mesin e grave shqipfolëse, 50% e të cilave thonë se kanë jetuar në konflikt aktiv të armatosur (krahasuar me 13% të grave që flasin maqedonisht). Mes atyre që jetuan në periudhën e konfliktit për të paktën një javë, shumica (82%) kishin të paktën një nga përvojat e lidhura me konfliktin të pyetura në anketë. Më të përmendurat janë dëgjimi i të shtënave me armë ose tingujt e bombardimeve (66%), të jetuarit në vend ku personeli i armatosur ishte i vendosur ose lëvizte në numër të madh për të paktën një javë (54%), dëshmitar i drejtpërdrejt i luftimeve (48%), nuk mund të gjejnë punë për shkak të konfliktit (30%) ose duhet të largohen nga shtëpia e tyre (27%)²².

¹⁸ Global Forum for Disaster Reduction and Recovery. North Macedonia section. 2017. <https://tinyurl.com/47pdmfa>

¹⁹ Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Plani i Katërt Kombëtar i Ndryshimeve Klimatike, 2023. f. 233. Në dispozicion në: <https://shorturl.at/fpyBF>

²⁰ WMO. 2012. Strengthening Multi-Hazard Early Warning Systems and Risk Assessment in the Western Balkans and Turkey: Assessment of Capacities, Gaps and Needs. Geneva.

²¹ WHO, Investing for safe and healthy North Macedonia, Health Emergencies Programme at the country level

²² https://www.osce.org/files/f/documents/3/5/419264_1.pdf

Sipas vlerësimit të Bankës Botërore²³, sistemi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj rasteve urgjente në Maqedoninë e Veriut është shumë funksional, por përballet me sfida të mëdha. Problemi kryesor është ekzistimi i faktorëve të shumtë me role të mbivendosura dhe shpërndarja e paqartë e përgjegjësisë. Për të rritur efikasitetin, sistemi duhet të ndryshojë nga qasja reaktive, ad-hoc në qasjen më të organizuar, konsistente dhe më të integruar të udhëhequr nga vizioni strategjik afatgjatë. Raporti diagnostikues i identifikon dobësitë dhe propozon prioritizimin e aspekteve themelore, si përmbytjet dhe zjarret në pyje. Gjithashtu, i njeht sfidat e reja si ndryshimet klimatike, migracionet, pandemitë dhe turizmi, duke rekomanduar përmirësime në pajisje, ndërtimin e kapaciteteve dhe teknologjinë.

Vitet e fundit, rezistenca e shoqërisë dhe komuniteteve të Maqedonisë së Veriut është kërcënuar nga një sërë rreziqesh dhe kërcënimesh të reja dhe të mundshme, si kriza e emigrantëve që filloi në vitin 2015, ndotja e ajrit në Shkup dhe qytete të tjera të mëdha në mbarë vendin, si dhe kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Numri i pacientëve në pandemi është 348.411 raste të konfirmuara që nga shtatori 2023 dhe 9.941 vdekje (0,54% e popullsisë së përgjithshme sipas Regjistrimit të popullsisë të vitit 2021²⁴ dhe humbjet kumulative të prodhimit për vitin 2020 dhe 2021 vlerësohen në 3,7 miliardë dollarë²⁵ (27,29% e BPV-së për vitin 2021). Megjithatë, të gjitha këto rreziqe ndikojnë në dobësimin e rezistencës së përgjithshme të vendit, si dhe në shpenzimin e resurseve të tij të kufizuara. Në mënyrë shtesë, pasojat e ndotjes së ajrit po marrin gjithnjë e më shumë përmasa shqetësuese, përkatësisht në vitin 2017, 13,7% e vdekjeve në Shkup ishin të lidhura me ndotjen e ajrit²⁶.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si edhe vendet e tjera, përballet me cenueshmëri nga sulmet kibernetike të drejtuara kundër sektorëve kryesorë, si infrastruktura, qeveria, arsimit dhe biznesi, të cilat shkaktojnë ndërprerje në shërbimet dhe dëmet ekonomike. Shembull i kësaj janë sulmet DDoS[9] (Distributed Denial of Service) në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve gjatë zgjedhjeve të korrikut 2020, kërcënimet e dërguara përmes e-postës për vendosjen e bombave në 76 institucione arsimore dhe 42 institucione të tjera në vitin 2023 dhe sulmet me softuer shantazhimi (ransomware) ndaj institucioneve shtetërore (Fondi i Sigurimit Shëndetësor në vitin 2023). Në mënyrë shtesë, MONEYVAL, organi për parandalimin e pastrimit të parave të Këshillit të Evropës, e inkurajoi Republikën e Maqedonisë së Veriut të zgjerojë masat për të parandaluar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe shpërndarjen e armëve, veçanërisht gjatë hetimeve dhe ndjekjeve gjyqësore²⁷.

Sipas Indeksit të Krimit të Organizuar, vendi ka rezultat prej 5,32, që e pozicionon në vendin e 74-t mes 193 vendeve, përkatësisht i 11-të nga 44 vende në Evropë. Për sa i përket rezistencës, RMV-ja ka rezultat prej 5,21, përkatësisht është në vendin e 76-të mes 193 vendeve dhe i 32-të nga 44 vende në Evropë²⁸. Të dhënat shtetërore tregojnë rënie prej 28,2% të numrit të personave që kanë vdekur nga vdekja e dhunshme²⁹. Numri i personave që humbën jetën në këtë mënyrë vitin e kaluar ishte 486 dhe përbën 2,2% të numrit të përgjithshëm të vdekjeve.

RMV-ja e pranoi Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030 (ang. Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015 – 2030)³⁰, që e theksoi lëvizshmërinë si rrezik potencial, veçanërisht në lidhje me njerëzit dhe mjedisin e tyre. Menaxhimi i krizës së emigrantëve që nga viti 2015 ka nxjerrë në pah nevojën për të integruar këto çështje në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë brenda

²³ Diagnostic Report Emergency Preparedness and Response Assessment, 2021 International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank

²⁴ <https://popis2021.stat.gov.mk/>

²⁵ Social and Economic Evaluation of the COVID-19 impact in North Macedonia. UNDP. June 2020. p. 8.

²⁶ <https://tinyurl.com/y48dbjba>

²⁷ <https://www.coe.int/da/web/portal/-/moneyval-calls-on-north-macedonia-to-improve-investigation-and-prosecution-for-combating-money-laundering-and-financing-of-terrorism>

²⁸ https://ocindex.net/country/north_macedonia

²⁹ https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie_en.aspx?rbrtxt=12

³⁰ <https://www.undrr.org/publication/sendai-framework-disaster-risk-reduction-2015-2030>

Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Krizave. Si rezultat, Vlerësimi Kombëtar i Rreziqeve tani përfshin emigrantët si element rreziku, duke vlerësuar ndikimin e tyre në sigurinë e vendit³¹.

Personat me aftësi të kufizuara janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në sistemet ekzistuese të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Ata shpesh anashkalohen dhe konsiderohen si pjesë e popullatës më të cenueshme. Si pasojë, ata nuk merren parasysh në përpjekjet për të reduktuar rreziqet e klimës dhe rreziqet e fatkeqësive dhe nuk kanë qasje të barabartë në aktivitetet për krijimin e politikave, miratimin e vendimeve dhe ndërtimin e rezistencës. Qasja aktuale për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë mbetet kryesisht reaktive në vend proaktive dhe fokusohet më shumë në përgjigje sesa në parandalim dhe zbutje. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2023 - 2030 dhe politikat përkatëse nuk njihen në mënyrë adekuate si bazë për zhvillimin e politikave, rregulloreve, praktikave dhe veprimeve gjithëpërfshirëse për të forcuar rezistencën e kësaj kategorie të qytetarëve³². Është duke u përgatitur Plani Kombëtar i Adaptimit (PKA), i cili bazohet në qasjet e lidhura në fusha të ndryshme, duke përfshirë ujin, ushqimin, energjinë, shëndetin, biodiversitetin, turizmin, pylltarinë, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, humbjet dhe dëmtimet dhe infrastrukturën³³.

Për t'u përballur me disa nga problemet e përmendura më parë, vendi ka përgatitur strategjinë e tij të mbrojtjes dhe sigurisë përmes Strategjisë së Mbrojtjes dhe Planit Afatgjatë për Aftësitë Mbrojtëse 2019-2028. Për transformim efikas digjital dhe siguri të përforcuar, Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të investojë shumë më tepër në zhvillimin e aftësive digjitale dhe sigurisë kibernetike. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të kapërcyer hendekun që ekziston midis stafit të kualifikuar dhe vendeve të punës në dispozicion - politikat në fushën e TIK-ut, brezit të gjerë dhe sigurisë kibernetike duhet të sistemohen, gjë që nënkupton miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike dhe të TIK-ut kombëtar, të cilat janë në proces përgatitjeje. Një numër fushash të tjera kyçe si lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, kontrolli i armëve, siguria kibernetike dhe strategjitë e zhvillimit të policisë kanë mbetur me dokumente strategjike të vjetruara që kanë nevojë për rishikim. Nga ana tjetër, shteti nuk ka miratuar ende Strategji Kombëtare për KKK-në, e cila duhet të japë pasqyrë për kornizën strategjike për ndërtimin e rezistencës së shoqërisë dhe komuniteteve në periudhën deri në vitin 2030. Republika e Maqedonisë së Veriut miratoi Strategji gjithëpërfshirëse për Veprimin Klimatik³⁴ e cila është në përputhje me Kornizën e BE-së për vitin 2030. Përgatit rregullisht dokumente sipas UNFCCC dhe në përputhje me Marrëveshjen e Parisit, përkatësisht Komunikimin e Katërt Kombëtar³⁵, Raportin e Tretë Dvyrëçar të Ndryshimeve Klimatike³⁶ dhe Kontributin e Përcaktuar Kombëtar të Rishikuar³⁷.

Megjithatë, korniza ligjore e Maqedonisë së Veriut për ndryshimet klimatike nuk është harmonizuar plotësisht me legjislacionin e BE-së. RMV-ja ndodhet në rrugën kryesore të migrimit në Ballkan dhe përballlet me sfida që lidhen me emigrantët. Kjo përfshin kampe të mbipopulluara, ngarkim të resurseve dhe pengesa logjistike në menaxhimin e fluksit të emigrantëve, ndër të tjera, edhe luftën me krimin e organizuar, kontrabandën e emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe mbrojtjen e kategorive të cenueshme të emigrantëve dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Në të ardhmen, vëllimi i migrimit do të varet ndjeshëm nga kushtet globale dhe rajonale socio-ekonomike dhe të sigurisë politike. Bashkëpunimi ndërmjet qeverive rajonale me trupat ndërkombëtarë, si dhe me vendet fqinje, është vendimtar për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

³¹ "The Refugee and Migrant Crisis in Macedonia associated with Disaster Risk Management", Vasko Popovski, Stevko Stefanoski (published in International Peer Reviewed Journal "Security Dialogues no. 16, August 2017, page 151-159, ISSN 1857-7172, eISSN 1857-8055),

³² [1] Vasko Popovski. Policies for Disability-Inclusive Disaster Risk Reduction in the Context of the Republic of North Macedonia. UNDP. 2023. p. iii. Available at: <https://tinyurl.com/mrytw34> d

³³ United Nations in North Macedonia, Government of the Republic of North Macedonia. Sustainable Development Goals. Voluntary National Review North Macedonia. 2020. p.76. <https://tinyurl.com/zu5pskrz>

³⁴ <https://tinyurl.com/ykdr3fz8>

³⁵ <https://tinyurl.com/yc3kzt35>

³⁶ <https://tinyurl.com/5n6sa27f>

³⁷ <https://tinyurl.com/y9fwtmav>

Varësia nga importi i energjisë elektrike paraqet rrezik për sigurinë energjetike dhe shkakton ndërprerje të furnizimit. Nga ana tjetër, 24% (2020) e popullsisë nuk mund t'i ngrohin shtëpitë e tyre dhe në të njëjtën kohë përballen me shkallë të varfërisë, e cila është më shumë se tre herë më e lartë se norma në BE (7%).

Për të përmirësuar parandalimin e fatkeqësive, sigurinë, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen rezistuese, Qendra e Menaxhimit të Krizave ka vendosur sistem gjithëpërfshirës të TIK-së që përfshin aplikacione dhe baza të ndryshme të të dhënave që mbështesin menaxhimin e rrezikut në të gjitha aspektet e ciklit të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Edhe pse shteti ka bërë progres në miratimin e akteve legjislative në fushën e sigurisë, ende duhet të punohet në këtë fushë për të forcuar më tej masat e sigurisë dhe rezistencën. Duke pasur parasysh se resurset e kufizuara financiare dhe njerëzore për gatishmëri dhe përgjigje mund të kufizojnë aftësinë e shtetit për të investuar në infrastrukturën e sigurisë, është e nevojshme të sigurohet teknologjia e përditësuar dhe trajnimi i duhur i kuadrit për të arritur qasje më të mirë ndërsektoriale dhe të ndërlidhur.

Politikat ndërkombëtare të RMV-së fokusohen në dy aspirata kryesore. Shteti ka bërë përpunim të dukshëm në partneritetet ndërkombëtare. Anëtarësimi në NATO në mars 2020 ofroi siguri dhe qasje në ndihmën humanitare dhe bashkëpunimin shkencor përmes Programit të NATO-s - Shkenca për Paqe dhe Siguri. Vendi aplikoi për anëtarësim në BE në mars 2004 dhe u bë kandidat në 2005. Në mars 2020 filluan negociatat e anëtarësimit dhe në korrik 2022 u mbajt Konferenca e parë Ndërqeveritare me BE-në. Nga ana tjetër, procesi i vazhduar për negociatat me BE-në mund të konsiderohet rrezik që së bashku me situatën aktuale dhe rreziqet e tjera mund ta çojnë vendin në situatë komplekse. Përfshirja në organizatat rajonale si Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor promovon stabilitetin, bashkëpunimin ekonomik dhe diplomacinë, i forcon lidhjet kulturore, e lehtëson qasjen në ndihmën ndërkombëtare dhe i forcon partneritetet e sigurisë. Prosesi i Berlinit paraqet platformë të rëndësishme rajonale që fokusohet në infrastrukturën, biznesin, shkencën, shkëmbimin (lëvizshmërinë) e të rinjve, por edhe harmonizimin e politikave që japin rezultate reale siç është marrëveshja rajonale për roaming, e cila ofron përfitime për banorët e rajonit. Iniciativa Ballkani i Hapur ka përshpejtuar gjithashtu një pjesë të proceseve integruese në nivel rajonal, nëpërmjet harmonizimit të standardeve dhe procedurave që e lehtësojnë tregun e përbashkët të njerëzve, produkteve dhe shërbimeve. Kjo iniciativë kontribuoi ndjeshëm edhe në tejkalimin e një pjese të sfidave të shkaktuara nga krizat e shumta dhe të lidhura me to (Kovidi, çmimet e energjisë, ushqimi). RMV-ja është anëtare e më shumë organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë Kombet e Bashkuara (KB), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Këshillin e Evropës.

Vendi është anëtare e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së që nga shkurti 2012. Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i BE-së ka mobilizuar ndihma për disa ngjarje katastrofale, si p.sh. përmbytjet në vitin 2015, përmbytjet e rrëmbyeshme në Tetovë dhe Shkup në vitet 2015 dhe 2016, si dhe zjarret katastrofale në gusht 2021. Kjo e nënvizon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe vlerat e BE-së, duke përfshirë edhe kujdesin për mjedisin jetësor.

RMV-ja, si anëtare e NATO-s, i shfrytëzoi përfitimet nga Sistemi i Menaxhimit të Krizave të Aleancës gjatë pandemisë. Përvoja e NATO-s ndihmoi në organizimin e ndihmës ushtarake dhe sigurimin e pajisjeve mjekësore nga Aleatët. Përfitimet e anëtarësimit në BE i ndiejnë edhe institucionet, të cilat mund të marrin pjesë në vendimmarrje dhe në forcimin e kapaciteteve të Aleancës. Kjo vlen për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën, e cila është në të njëjtin nivel me 30 vendet e tjera anëtare. Përveç kësaj, komuniteti i biznesit gëzon përpunim të shumta, prandaj promovimi aktiv i këtyre përfitimeve i inkurajon kompanitë të marrin pjesë në tregun më të madh në botë, tregun e NATO-s.

5.5.1 Misioni

Misioni ynë është të krijojmë shoqëri të sigurt dhe rezistente që u mundëson të gjithë individëve dhe bizneseve të kenë sukses. Do të përdoren strategji dinamike që inkurajojnë qeverisjen e ndërlidhur dhe të koordinuar, duke u përballur me rreziqet dhe kërcënimet në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Fokusi ynë kryesor është të përmirësojmë rezistencën përmes përpjekjeve të koordinuara të të gjithë sektorëve relevantë që janë vendimtarë për sigurinë kombëtare dhe

ndërtimin e rezistencës. Shkëmbimi efektiv i informacioneve është me rëndësi të madhe si brenda kornizës së sigurisë kombëtare, ashtu edhe në korrelacion me bartësit kryesorë të vendimeve. Fokusi është prioritizimi i sigurisë njerëzore, përmirësimi i rezistencës shtetërore dhe shoqërore, promovimi i zhvillimit shoqëror, mbrojtja e identitetit kombëtar dhe kulturor dhe forcimi i sigurisë dhe stabilitetit për të gjithë në nivel lokal me fokus të veçantë në sfidat dhe dobësitë specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat. Për të arritur këto qëllime, miratojmë qasje të integruar shtetërore që përfshin angazhimin ndërkombëtar sipas nevojës për të parashikuar dhe zgjidhur në mënyrë efektive rreziqet dhe kërcënimet aktuale dhe të mundshme.

5.5.2 Qëllimet

Për realizimin e misionit, janë përcaktuar këto qëllime:

1. Shoqëria rezistente ndaj krizave dhe fatkeqësive;
2. Komunitetet rezistente ndaj ndryshimeve klimatike;
3. Siguria integrale si çelës për përballimin e sfidave që lidhen me sigurinë dhe politikën e jashtme.

Qëllimi: Shoqëria rezistente ndaj krizave dhe fatkeqësive

Fokusi ynë është të kultivojmë shoqëri që jo vetëm do t'u rezistojë goditjeve të krizave dhe fatkeqësive, por gjithashtu do të theksohet në menaxhimin parandalues dhe proaktiv të rreziqeve dhe ndërtimin e rezistencës. Kjo do të arrihet duke njohur rreziqet sistematike dhe duke përdorur mësimet dhe përvojat e nxjerra për të përmirësuar masat dhe përgjigjet parandaluese. Për këtë qëllim, do të kryhen vlerësime të detajuara dhe gjithëpërfshirëse të rrezikut në sektorë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe lokal, duke zhvilluar strategji, politika dhe veprime të ndërthurura strategjiksht të informuara për rrezikun, me ç'rast perspektiva gjinore dhe e aftësisë së kufizuar janë përfshirë dhe janë pjesë integrale e qasjes për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, forcimin e koordinimit dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe subjekteve kompetente që marrin pjesë në reduktimin e rreziqeve dhe sigurimin e përfshirjes së të gjithëve në shoqëri, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve për parandalim, gatishmëri, përgjigje dhe rimëkëmbje.

Prioritetet

1. SISTEMI I TRANSFORMUAR I MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË ME FOKUS NË PARANDALIMIN

Decentralizimi shtesë i kompetencave për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë me qëllim që pjesët e sistemit (p.sh. pushtetet lokale) të kryejnë në mënyrë më efikase dhe efektive parandalimin dhe jo vetëm të reagojnë pasi do të ndodh fatkeqësia. Çelësi është ndërtimi i rezistencës, para se gjithash përmes parandalimit dhe zbutjes së pasojave nga rreziqet ekzistuese dhe parashikimit të rreziqeve të mundshme, si dhe gatishmërisë dhe përgjigjes në kohë, në mënyrë efikase dhe efektive ndaj fatkeqësive dhe rimëkëmbjes rezistuese prej tyre. Çështja është menaxhimi i rrezikut të fatkeqësive, jo menaxhimi i fatkeqësive. Kjo përfshin vlerësimin sistematik dhe gjithëpërfshirës të rreziqeve, masat parandaluese dhe zbutëse, gatishmërinë, përgjigjen efektive dhe efikase dhe rimëkëmbjen rezistuese nga fatkeqësitë dhe krizat, ndërtimin e kulturës së rezistencës, pasqyrën e përgjegjësisë, ndryshimet e nevojshme në legjislativ dhe rregullativë dhe koordinimin efektiv me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë. Gjithashtu, nevojitet qasja e ndjeshme gjinore dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar në çdo fazë, duke njohur dobësitë dhe potencialet e ndryshme dhe duke promovuar përfshirjen aktive të grave dhe grupeve të cënueshme dhe të margjinalizuara të qytetarëve në politikën dhe masat për parandalim, gatishmëri, përgjigje dhe rimëkëmbje.

2. SISTEMI FUNKSIONAL I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PËR MË SHUMË RREZIQE

Transformimi i sistemit ekzistues të paralajmërimit të hershëm nëpërmjet rritjes së kuptimit të rreziqeve, ndjekjes dhe parashikimit më të mirë, paralajmërimit dhe alarmimit të hershëm dhe në kohë dhe të saktë të të gjithë popullsisë, si dhe udhëzimet e qarta për publikun, shërbimet e gjendjeve urgjente dhe faktorët relevantë mbi sjelljet dhe procedurat për t'iu përgjigjur rreziqeve të ndryshme, me ç'rast do të adresohen nevojat specifike të popullsisë në komunikimin gjatë rrezikut që do të jetë i ndjeshëm gjinor dhe do të përfshijë aftësinë e kufizuar.

Ky sistem do të përfshijë përdorimin e teknologjive dhe zgjidhjeve të ndryshme, burimet e të dhënave dhe kanalet e komunikimit për të zbutur ndikimin e fatkeqësive, duke shpëtuar jetë njerëzish dhe duke reduktuar dëmet e mundshme duke mundësuar gatishmërinë dhe veprimet për përgjigjen në kohë, efikase dhe efektive. Prandaj, parashikimi i bazuar në pasojat (ang. Impact-based Forecasting) do të jetë baza kryesore e këtij sistemi dhe proceseve të lidhura.

3. PLANIFIKIMI I PARANDALIMIT DHE REDUKTIMI I RREZIKUT

Jepuni prioritet vlerësimeve të rreziqeve dhe përfshijuni në planifikimin e parandalimit dhe reduktimit të rrezikut brenda strategjive, politikave dhe planeve zhvillimore dhe sektoriale në të gjitha nivelet. Duke vepruar kështu, do të zbatohet qasja e ndërtimit të rezistencës së shoqërisë, komuniteteve dhe sistemeve. Për shembull, politikat, masat dhe mjetet do të aplikohen për të ndërtuar rezistencën e infrastrukturës dhe sistemeve kritike.

4. FINANCIMI I INTEGRUAR DHE PËRKATËS PËR REZISTENCËN

Buxheti gjithëpërfshirës, i përgjegjshëm gjinor, me përfshirjen e aftësive të kufizuara dhe të mjaftueshme të sigurisë dhe ndërtimit të rezistencës që mbulojnë parandalimin dhe zbutjen, ndërtimin e rezistencës së infrastrukturës, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj fatkeqësive, rrjetet e mbrojtjes sociale dhe sigurisë, bashkëpunimin ndërkombëtar, kapacitetet e subjekteve në nivel kombëtar dhe lokal dhe financimin sipas rreziqeve të vlerësuara. Me siguri, financim të integruar dhe adekuat për parandalimin dhe rezistencën për të ndërtuar shoqërinë e sigurt dhe rezistuese. Përfshirja e sektorit privat është thelbësore për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rezistues dhe në këtë kuptim është thelbësor që të kultivohen partneritetet dhe të ndërtohet rezistenca e kompanive dhe industrive.

5. INOVACIONET SHKENCORE DHE TEKNOLOGJIKE PËR REZISTENCËN NDAJ FATKEQËSIVE DHE REZISTENCA KLIMATIKE

Duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe rëndësisë së shfrytëzimit të inovacioneve për të zgjidhur sfidat komplekse dhe të ndërlydhura përmes qasjes multidisiplinore, të ndjeshme gjinore dhe e përfshin aftësinë e kufizuar që i kombinon arritjet shkencore, përdorimin e teknologjisë dhe qeverisjen efektive për të përmirësuar rezistencën ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese dhe potenciale. Zhvillimi i arritur i inovacioneve dhe zgjidhjet ekzistuese të TIK-së në QMK dhe faktorët e tjerë paraqesin bazë solide për përparimin e agjendës së digjitalizimit dhe inovacionit dhe në të njëjtën kohë nuk lënë askënd pas.

6. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET REZISTENTE – NIVELI KOMBËTAR DHE RAJONAL

Zgjerimi i politikave dhe praktikave të ndërtimit të rezistencës për kapacitetet kryesore të infrastrukturës, mjetet, shërbimet dhe resurset. Dizajni, përgatitja, ndërtimi, rikonstruksioni dhe funksionimi i infrastrukturës parandaluese dhe infrastrukturës dhe shërbimet e nevojshme për rezistencë - me rivalizim të menjëhershëm të infrastrukturës ekzistuese të dizajnuar për të përmbushur standardet e rezistencës dhe për të siguruar qasje për të gjithë.

Zhvillimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike është përpjekje komplekse që kërkon qasje gjithëpërfshirëse për të siguruar qëndrueshmëri të mjedisit jetësor, barazi sociale dhe efektivitet. Përshtatja multidimensionale ndaj ndryshimeve klimatike është proces i vlerësimit dhe hartëzimit të rajoneve më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe njohjes së nevojave dhe zgjidhjeve të nevojshme. Qasja e tillë në zbatimin e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike do të rrisë aftësinë e komuniteteve për të zhvilluar rezistencën e tyre. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet integritimit gjinor, integritimit të grupeve sociale dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar për të garantuar cilësi, si dhe zgjidhje të qëndrueshme, të cilat në vetvete integrojnë qasje që i njeh dobësitë dhe nevojat specifike të grupeve të ndryshme në shoqëri. Nevojitet koordinimi efektiv ndërmjet niveleve të ndryshme, duke përfshirë nivelet ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale, në mënyrë që të sigurohen mekanizma efikasë të përshtatjes ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike. Edukimi i publikut në lidhje me masat e gatishmërisë dhe sigurisë është gjithashtu bazë e nevojshme, sepse në këtë mënyrë sigurohen njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të mbrojtur vetë qytetarët dhe komunitetet e tyre.

Prioritetet

1. VLERËSIMI, HARTIMI DHE PLANIFIKIMI I PËRSHTATJES NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Identifikimi dhe hartimi i rajoneve më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe përgatitja e strategjive të përshtatjes që përfshijnë të gjithë faktorët. Përcaktimi i resurseve, financiare dhe jofinanciare, që mund të ndahen për masat për përshtatje dhe sigurimin nëpërmjet vendimmarrjes gjithëpërfshirëse. Kjo duhet të çojë në opsionet për përshtatjen hapësinore dhe përshtatjen e bazuar në rreziqe në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe kontributin e faktorëve.

2. GATISHMËRIA DHE PËRGJIGJA NDAJ RREZIQEVE KLIMATIKE

Vlerësimi i masave rajonale dhe lokale të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike që kërkojnë zhvillimin e kapaciteteve parandaluese dhe përgjigje, zhvillimin e programeve të trajnimit për nëpunësit që fokusohen në aftësitë kryesore dhe ngritjen e rregullt të kapaciteteve me informimin dhe ushtrimet në të gjitha nivelet. Inkurajimi i ndarjes së praktikave më të mira dhe organizimi i fushatave të përshtatjes, gatishmërisë dhe përgjigjes. Integrimi i edukimit të gatishmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në programet mësimore dhe krijimi i platformave të komunikimit për informimin në rastet urgjente që i adresojnë nevojat specifike të popullsisë, veçanërisht grupeve të cenueshme të qytetarëve dhe promovojnë komunikim gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm gjinor.

3. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET LOKALE DHE RAJONALE REZISTENTE NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Sigurimi i mekanizmave financiarë të përgjegjshëm gjinor që përfshijnë prioritizimin, përgatitjen, ndërtimin, rikonstruksionin e infrastrukturës rezistente ndaj ndryshimeve klimatike dhe funksionimin e infrastrukturës dhe shërbimeve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike në nivel rajonal dhe lokal. Në mënyrë shtesë, revalorizimi i infrastrukturës ekzistuese të dizajnuar për të përmbushur standardet e rezistencës. Vendosja e kornizës dhe pasqyrës së harmonizimit të investimeve kapitale dhe infrastrukturës për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Qëllimi: Siguria integrale si çelës për përballjen me sfidat që lidhen me sigurinë dhe politikën e jashtme

Koncepti i sigurisë integrale është vendimtar për arritjen e zgjidhjeve sistematike të sfidave të sigurisë, përcaktimin e zhvillimeve të sigurisë dhe ndjekjen e perspektivave të shoqërisë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe politikës së jashtme, duke i njohur ndikimet e

ndryshme gjinore të sfidave të sigurisë dhe promovimin e gjithëpërfshirjes në zhvillimin, zbatimin e politikave për sigurinë, mbrojtjen dhe politikën e jashtme. Përmes ndërtimit të tij përgatitemi për të ashtuquajturën siguri të përgjithshme nga të gjitha format e kërcënimeve të armatosura ose të paarmatosura dhe realizimin e sigurisë së plotë dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet dhe segmentet e jetës. Koncepti i sigurisë integrale të Maqedonisë së Veriut do të mundësojë përgjigje adekuate ndaj kërcënimeve të reja dhe më të gjera të mundshme të sigurisë, mbi të gjitha zhvillimin ekonomik, shkatërrimin e mjedisit jetësor, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe lëvizjet e migracionit.

Prioritetet

1. KONCEPTI MODERN PËR KRIJIMIN E POLITIKËS SË SIGURISË

Nëpërmjet miratimit të ligjit të veçantë për sigurinë integrale, i cili njih dhe adreson nevojat dhe rreziqet specifike gjinore të sigurisë, të zbatohet sistemi i ri i sigurisë dhe pajisjet, që do të ruajë segmentin e lidhjes me mbrojtjen kolektive përmes NATO-s dhe bashkëpunimit me BE-në.

Krijimi i modelit të sistemit të integruar të sigurisë dhe mbrojtjes që ka një pikë të vetme të bashkimit për politikën e sigurisë kombëtare, pikë që siguron koordinimin midis shërbimeve të ndryshme të sigurisë dhe inteligjencës. Zgjerimi i konceptit të sigurisë në Maqedoninë e Veriut mundëson parandalimin, paralajmërimin e hershëm dhe përballjen me kërcënimet e reja dhe më të gjera potenciale për sigurinë, në radhë të parë zhvillimin ekonomik, shkatërrimin e mjedisit jetësor, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe lëvizjet e migracionit.

2. FUNKSIONI I KONTROLLIT TË KUVENDIT MBI KRIJIMIN DHE ZBATIMIN E POLITIKËS SË SIGURISË, MBROJTJES DHE TË JASHTME

Kuvendi, si bartës i pushtetit legjislativ, duhet të zbatojë në mënyrë më të prerë funksionin e tij parësor në siguri dhe politikën e sigurisë. Karakteristikë për sistemet parlamentare është realizimi i funksionit kontrollues, ndaj për nevojat e reformave është i nevojshëm forcimi i funksionit të tij kontrollues në sistemin e sigurisë. Nevoja për ekzistimin e Institutit Shkencor për Politikën e Sigurisë, orientimi programor i të cilit duhet të synojë kërkimet themelore dhe të aplikuara (veprimet) mbi problemet më të ndryshme të sigurisë për mënyrën e zgjidhjes së tyre dhe vendosjen e proceseve integrale të sigurisë.

3. SHATMADHORIA E ARMATËS, PJESE E MINISTRISË SË MBROJTJES

Integrimi i Shtatmadhorisë së Armatës në sistemin e mbrojtjes në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe promovimi i mjedisit gjithëpërfshirës që promovon barazinë gjinore në Armatë, duke ruajtur kompetencën ekskluzive për çështjet ushtarake për të vepruar në përputhje me rregullativat ligjore, Kushtetutën dhe misionet e përcaktuara.

4. ALEATI I SIGURT DHE I BARABARTË I NATO-S

Përmes politikës së jashtme gjithëpërfshirëse, Maqedonia e Veriut do të vazhdojë të krijojë dhe të ofrojë mundësi për përshtatjen në kohë me rrethanat e reja dhe pozicionimin ndërkombëtar si aleat i vlefshëm, i sigurt dhe i barabartë i NATO-s dhe aleat i fortë strategjik me SHBA-në, në mënyrë që të mund të mbrojë dhe të avancojë vlerat dhe interesat e saj dhe të garantojë strategji dhe politika diplomatike gjithëpërfshirëse që promovojnë barazinë gjinore dhe janë të përkushtuara ndaj vlerave dhe interesave të shoqërive të ndryshme në nivel ndërkombëtar. Partneriteti me BE-në mbetet prioriteti kryesor i politikës së jashtme. Vazhdimi i multilateralizmit dhe bashkëpunimit efektiv. Promovimi i interesave ekonomike të shtetit përmes diplomacisë ekonomike dhe zhvillimit të planeve të veprimit nga Agjenda e Gjelbër.

Roli i procesit të digjitalizimit dhe teknologjive të reja në krijimin e shoqërisë së sigurt dhe rezistente.

Në mjedisin global që sundon lidhshmëria e ndërsjellë e fortë, predispozita për kriza të ndryshme është evidente, pavarësisht nëse bëhet fjalë për pandemi shëndetësore ose dobësi kibernetike. Megjithatë, SKZH-ja thekson se është e mundur të përdoret analiza e të dhënave në kohë reale në kombinim me kuadër të përcaktuar digjitale për të ndërtuar shoqëri që do të jetë në gjendje të përballet me këto sfida. RMV-ja synon të identifikojë dhe të përballet me kërcënimet e mundshme paraprakisht duke zhvilluar sisteme të sofistikuara të paralajmërimit të hershëm që përdorin inteligjencën artificiale dhe mësimin e makinës. Falë kësaj qasjeje proaktive, përgjigjet nuk do të jenë thjesht reagime, por zbutje strategjike të krizave. Sot, siguria i kalon kufijtë fizikë dhe hyn në domenin digjital. SKZH-ja e merr këtë parasysh dhe e thekson rëndësinë e sigurisë integrale si element bazë.

Propozohet komunikim digjital pa ndërprerje midis sektorëve të inteligjencës, trupave të zbatimit të ligjit dhe kreatorëve të politikës për të siguruar përgjigje të koordinuar ndaj kërcënimeve shumëdimensionale. Me digjitalizimin si udhërrëfyes, krijojmë mjedis - të ardhme ku rezistenca nënkuptohet, siguria është e gjithëpranishme dhe mund të përballemi me sfidat në mënyrë përkatëse.

5.6. FUSHA STRATEGJIKE – TRANSFORMIMI I GJELBËR

Maqedonia e Veriut përballet me sfidën e vendosjes së ekuilibrit midis rritjes ekonomike, konsumit të energjisë dhe ruajtjes së mjedisit jetësor. Konsumi i energjisë për banor është dukshëm më i ulët në krahasim me BE-në. Në vitin 2020, vendi shënoi konsum të energjisë primare prej vetëm 1,2 toe/banor (ton i naftës ekuivalente për banor), që është më shumë se dy herë më pak se BE-ja, ku konsumi i energjisë primare është në nivelin prej 2,8 toe/banor. Ngjashëm është edhe me konsumin final të energjisë, i cili në këtë vend është në nivelin prej 0,9 toe/banor, që është gjysma e shumës në BE, që është në nivelin prej 2 toe/banor. Më tutje, konsumi i energjisë finale të familjeve ishte 248 ktoe, që është më shumë se dyfishi më i ulët se 555 ktoe në BE, dhe si rrjedhojë, këta numra janë tregues adekuat i shkallës së varfërisë energjetike të vendit. Me gjithë konsumin e ulët të energjisë për banor, Maqedonia e Veriut nuk e arriti qëllimin e përcaktuar për vitin 2020 të pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme në bruto konsumin final të jetë në nivelin prej 23%, atë vit kjo përqindje ishte shumë më e vogël, afërsisht 19%. Në të kundërt, BE-ja e tejkaloi qëllimin e saj, duke arritur 22% në të njëjtin vit. Produktiviteti i vendit tonë për njësi të energjisë së konsumuar është pothuajse tre herë më i ulët se ai i vendeve anëtare të BE-së, përkatësisht Maqedonia e Veriut prodhon vetëm 3,3 euro për çdo 1kgoe të konsumuar, ndërsa BE-ja me të njëjtën energji prodhon 8,8 euro. Kjo ndikohet edhe nga shkalla e lartë e ekonomisë joformale. Në mënyrë shtesë, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, ose rreth 24% në vitin 2020, u përballën me varfërinë energjetike, pa mundësinë për të ngrohur shtëpitë e tyre. Ky numër është më shumë se tre herë më e lartë se përqindja e BE-së, e cila është 7%. Në të njëjtën kohë, varfëria energjetike kontribuon që vendi të përballet me nivele të larta të ekspozimit ndaj grimcave PM2,5, gjë që çon në humbjen e dyfishit të viteve të jetës (1632 vite jetë të humbura në - nivel vjetor) krahasuar me BE-në ku humben 762 vjet. Arsyeja kryesore është përdorimi i gjerë i druve për ngrohjen e shtëpive, i cili ndonëse konsiderohet si burimi i rinovueshëm i energjisë, megjithatë e imponon nevojën e kalimit në teknologjitë më efikase, të tilla si pompat e nxehtësisë.

Derisa këta numra për konsum më të ulët të energjisë kontribuojnë për emisionet më të ulëta të gazrave serrë për banor, vendi përballet me nevojë urgjente për të forcuar njëkohësisht rritjen ekonomike. Për të arritur të ardhme të ekuilibruar dhe të qëndrueshme, vendi duhet të fokusohet jo vetëm në uljen e varfërisë energjetike, por edhe në përmirësimin e produktivitetit të tij ekonomik, njëkohësisht duke e ruajtur konsumin e ulët të energjisë. Edhe pse vendi ka mbulim me pyje të ngjashëm me mesataren e BE-së, prej afërsisht 40%, ai mbetet ndjeshëm për sa u përket zonave të mbrojtura, me vetëm 12,5% që është më pak se gjysma e mesatares së BE-së (25,9%). Kjo mospërputhje midis pyjeve dhe zonave të mbrojtura nxjerr në pah nevojën për fokus strategjik në ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve natyrore.

Në mënyrë shtesë, vendi përballet me nevojë urgjente për t'i zgjidhur parregullsitë në menaxhimin e mbetjeve, pasi për momentin shkalla e riciklimit të mbetjeve është vetëm 0,7%, që është shumë më e ulët se ajo e BE-së, e cila është 48%. Ka mungesë të konsiderueshme të stacioneve të pastrimit, si dhe mungojnë edhe deponitë e standardizuara për mbetjet komunale. Për të zbutur këto çështje, nevojiten aktivitete urgjente, duke përfshirë edhe formimin e depove që i plotësojnë standardet ndërkombëtare, si dhe përpjekjet për të reduktuar mbetjet që dërgohen në deponi, kryesisht duke rritur shkallën e riciklimit. Në të njëjtën kohë, ndërtimi i stacioneve të pastrimit është me rëndësi vendimtare për t'iu përgjigjur këtij shqetësimi ekologjik, duke i hapur rrugën të ardhmes më të qëndrueshme.

Degradimi i ekosistemeve ujore po rritet si rezultat i ndikimit të kombinuar të presioneve të lidhura me zhvillimin, siç janë për shembull, ndryshimet demografike, urbanizimi, bujqësia dhe industrializimi, dhe ndryshimet globale, duke përfshirë ndryshimet klimatike.

Ndotja e ujërave është problem i madh në vend, veçanërisht në ato pjesë që janë pranë zonave të urbanizuara dhe industriale, si dhe në zonat me prodhimtari bujqësore të përqendruar dhe intensive. Resurset ujore të disponueshme vjetore për banor janë rreth 3,074 m³/vit, që është afër kufirit të

resurseve ujore të disponueshme të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm. Përdorimi i ujit të freskët si përqindje e resurseve të rinovueshme të ujit të freskët është 11.29% dhe është rreth tre pikë përqindje më i lartë se mesatarja e 27 vendeve anëtare të BE-së (8.39%). Përqindja e ndotjes së ujërave është e lartë, përkatësisht edhe 75%, në kushtet e shkarkimeve të parregulluara dhe mospastrimit të ujit. Megjithatë, përkundër rëndësisë së ujërave, përgjigjja institucionale dhe më e gjerë shoqërore duket në mënyrë të pamjaftueshme e ndjekin kompleksitetin në rritje të sfidave.

Grupet e cenueshme të identifikuar që ballafaqohen me varfërinë energjetike të cilat përdorin dru si ngrohje në familje janë: Nënata e vetme që jetojnë në shtëpi me fëmijë nën 18 vjeç, baballarët e vetëm që jetojnë në shtëpi me fëmijë nën 18 vjeç, gratë mbi 65 vjeçe, personat me të ardhura mujore nën 12.000 denarë, beqaret gra, të divorcuara ose të veja dhe gratë që jetojnë vetëm, burrat mbi 65 vjeç, personat me të ardhura mujore nën 12.000 denarë, beqarët, burra të divorcuar ose të ve dhe burrat që jetojnë vetëm. Nga ana tjetër, pjesa e grave në shkallën e papunësisë dhe varfërisë është më e lartë se ajo e burrave, që është në korrelacion me mundësitë (financiare) të blerjes, si dhe me modelet e sjelljes. Sipas studimeve mbi gjininë dhe ndryshimet klimatike, gratë shfaqin më shumë shqetësime për problemin e ndryshimeve klimatike dhe janë më të gatshme të pranojnë praktika të reja të sjelljes që kontribuojnë në reduktimin e emisioneve të gazit, por ato janë më pak të përfshira në pozicionet vendimmarrëse, me më pak ka të ngjarë të menaxhojnë dhe kontrollojnë buxhetet e familjes për shkak të modeleve kulturore, si dhe varësisë së tyre nga të ardhurat e familjes³⁸.

5.6.1 Misioni

Misioni strategjik i Maqedonisë së Veriut është përforcuar të punojë në transformimin e gjelbër energjetik dhe të pozicionohet si lider rajonal në zhvillimin e qëndrueshëm dhe kujdesin ndaj mjedisit jetësor, duke zbatuar kalimin në ekonomi me karbon të ulët njëkohësisht duke siguruar rritje. Qëllimi primar kryesor në këtë drejtim është reduktimi i ndjeshëm i emisioneve të gazrave serrë, përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe përmirësimi i efikasitetit energjetik, duke siguruar në këtë mënyrë mjedis jetësor më të shëndetshëm për qytetarët, duke integruar perspektivën gjinore në politika dhe programe për mjedisin jetësor. Në të njëjtën kohë, duhet të rinovohet sistemi i menaxhimit të mbetjeve dhe ujërave të zeza duke rritur shkallët e riciklimit dhe duke vendosur deponitë e standardizuara, duke reduktuar kështu gjurmën tonë ekologjike. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit është me rëndësi thelbësore për përmirësimin e mjedisit jetësor.

5.6.2 Qëllimet

Për realizimin e misionit janë përcaktuar këto qëllime

1. Shoqëria neutrale ndaj klimës me përqindje të ulët të varfërisë energjetike;
2. Mjedis jetësor i shëndetshëm dhe i pastër.

Qëllimi: Shoqëria neutrale ndaj klimës me përqindje të ulët të varfërisë energjetike

Fokusi ynë është të arrijmë neutralitetin klimatik, përkatësisht të minimizojmë emisionet e gazrave serrë, me reduktim paralel të popullsisë së varfër energjetikisht. Nevojitet energjia e pastër, e prodhuar nga burimet e rinovueshme, si dhe rritja në efikasitetin energjetik, që do të reduktojë energjinë përfundimtare të konsumuar për banor, dhe do të rrisë produktivitetin për njësi të energjisë së konsumuar, duke zbatuar politika të ndjeshme gjinore që sigurojnë pjesëmarrjen aktive dhe të grave dhe përfitim të barabartë nga projektet e energjisë së pastër. Më tutje, është i nevojshëm kalimi drejt burimeve më të pastra dhe më të

³⁸ <https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/07015e39ea890385d9fb9786be635fa574f1313f56f64879be43002c9a8f6b7c.pdf>

qëndrueshme të energjisë, njëkohësisht duke marrë parasysh që kategoritë e cenueshme të kenë qasje në shërbimet bazë të energjisë termike dhe energjisë elektrike gjatë këtij kalimi.

Prioritetet

1. EFIKASITETI ENERGETIK - ZGJEDHJA E PARË E QYTETARËVE DHE KOMPANIVE

Ky parim është me rëndësi të veçantë dhe prioritarë për Maqedoninë e Veriut sepse efikasiteti energjetik është resurs i rëndësishëm vendor. Së pari, ndihmon në uljen e konsumit dhe shpenzimeve lidhur me energjinë. Ky paraqet fitim për individët, bizneset dhe për të gjithë vendin në tërësi, pasi do të ketë ulje të shpenzimeve për instalimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë. Përfshirja e grave (sidomos gratë në zonat rurale) në planifikimin dhe zbatimin e masave të efikasitetit energjetik mund të përmirësojë efektivitetin dhe gjithëpërfshirjen e këtyre iniciativave pasi gratë shpesh luajnë role kryesore në menaxhimin e përdorimit të energjisë, si gatimi, ngrohja dhe punët e shtëpisë. Në mënyrë shtesë, efikasiteti energjetik kontribuon në zbutjen e ndryshimeve klimatike duke prodhuar më pak energji nga lëndët djegëse fosile. Në fund, prioriteti i efikasitetit energjetik nxit shoqëri më të shëndetshme dhe më rezistuese, pasi redukton ndotjen e ajrit duke çuar në përmirësimin e shëndetit publik.

2. HEKURUDHA E ELEKTRIZUAR DHE E DIGJITALIZUAR DHE PËRQINDJA E LARTË E AUTOMJETEVE ME ENERGI TË PASTËR

Infrastruktura e modernizuar e transportit nëpërmjet elektrifikimit të rrjeteve hekurudhore dhe përdorimit të automjeteve ekologjike, veçanërisht ato që mbushen me energji elektrike ose hidrogjen dhe lëndë djegëse të tjera të pastra, do të kontribuojë në reduktimin e emisioneve të karbonit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në të ardhmen, duke pasur parasysh që energjia elektrike do të prodhohet nga burimet e rinovueshme. Theksi te automjetet, të cilat në të ardhmen do të mbushen me lëndë djegëse të pastra, veçanërisht në transportin publik, e thekson përkushtimin e vendit për të promovuar zgjidhjet novatore ekologjike të transportit që mund ta çojnë vendin drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe më të avancuar teknologjiksht.

3. INDUSTRIJA ME TEKNOLOGJI TË PASTRA SHUMË TË ZHVILLUARA

Inkorporimi i teknologjive më moderne në proceset industriale (Industria 4.0 dhe më gjerë), me qëllim të përmirësimit të efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe inovacioneve, që kontribuon në rritjen e produktivitetit, uljen e konsumit të energjisë dhe rritjen e përgjegjësisë për mjedisin jetësor. Teknologjitë e reja duhet kuptuar si sfidë dhe si mundësi për zhvillim. Duke investuar në kërkimin dhe zhvillimin e teknologjive të tilla në vend, inkurajohet konkurrueshmëria ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës në sektorin e pastër energjetik, duke siguruar që gratë kanë qasje të barabartë në trajnim, punësim dhe kanë mundësi për sipërmarrësi në tranzicionin drejt teknologjive të pastra shumë të zhvilluara.

4. TRANSICION I DREJTË I TERMOCENTRALEVE QË PËRDORIN QYMYR

Proces i tranzicionit i rumbullakuar me sukses që përfshinë mbyllje në etapa të termocentraleve me qymyr, pasuar me hapjen e termocentraleve të reja të burimeve të rinovueshme të energjisë, duke përfshirë edhe hidrogjenin. Hidrogjeni i gjelbër momentalisht shihet si një burim energjieqë do të ndihmojë për integrimin e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme. Paralelisht, ky proces ka për qëllim që t'i jap prioritet përfshirjes sociale, gjinore dhe ekonomike, duke siguruar një mirëqenie të komuniteteve dhe punëtorëve të rrezikuar në rajonet e goditura. Pritet që kjo mirëqenie të mos cenohet gjatë tranzicionit, duke i kushtuar vëmendje të posaçme pabarazisë së fitimit. Përmes këtij prioriteti, shteti tenton që të zvogëlojë emetimet e karbonit dhe ndikimit ndaj ambientit jetësor, si dhe të zbus pasojat socio-ekonomike të tranzicionit.

5. VARFËRIA ENERGJETIKE E ZVOGËLUAR PËRMES PËRKRAHJES SË SYNUAR

Zbatimi i politikave dhe mekanizmave për përkrahje për të siguruar një energji të pastër dhe të qëndrueshme, në dispozicion për të gjithë, me theks të veçantë ndaj atyre që ballafaqohen me vështirësi ekonomike. Përmes adresimit të nevojave energjetike të kategorive të cenuara, vendi ka për qëllim që të zvogëlojë varfërinë energjetike, ta përmirësojë përfshirjen sociale, si dhe mirëqenien e qytetarëve. Kjo kontribuon për shoqëri të drejtë sociale ku të gjithë mund të qasen deri te resurset dhe shërbimet energjetike elementare.

Qëllimi: Ambient jetësor i shëndoshë dhe i pastër

Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve dhe mbrojtja e tyre si një interes afatgjatë kombëtar është prioritet për shtetin. Kjo do të nda ndihmojë për të siguruar një ambient të shëndoshë dhe të pastër si një parakusht për një jetë kualitative dhe mirëqenie. Ambienti i pastër jetësor gjithashtu e siguron baraspeshën ekologjike, duke e ruajtur llojllojshmërinë biologjike dhe raportet e ndërlikuara të ekosistemeve. Me këtë, kemi për qëllim që ta ruajmë bukurinë natyrore të vendit dhe resurset që e ruajnë jetën, përfshirë ajrin e pastër, ujin e freskët dhe sipërfaqen pjellore.

Prioritetet

1. EKONOMIA QARKULLUESE ËSHTË TËRËSISHT E VENDOSUR

E zvogëlon shpenzimin e tepruar të resurseve duke promovuar riciklimin dhe përdorimin e serishëm, me çka minimizohet shkatërrimi i vendbanimeve dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore, përmes promovimit të praktikave përfshirëse që i marrin parasysh rolet e ndryshme gjinore dhe nevojat e grave dhe burrave për menaxhimin e mbeturinave, riciklimin dhe mbrojtjen e resurseve. Këto praktika, dukshëm e ulin vëllimin e mbeturinave që përfundon nëpër deponi, duke e zvogëluar ndotjen emetimet e metanit dhe rëndimin e kapaciteteve të deponisë, që rezulton me ajër, ujë dhe tokë të pastër.

2. VENDBANIME TË MENÇURA DHE TË QËNDRUESHME

Lagje të mençura dhe të qëndrueshme me një fokus të posaçëm në menaxhimin e kualitetit të ajrit, resurseve ujore dhe mbeturinave. Kjo përfshinë digjitalizimin dhe implementimin e inovacioneve më bashkëkohore dhe teknologjive të pastra si dhe politikave për përmirësimin e kualitetit të ajrit.

Njëkohësisht, fokus i veçantë i vihet edhe ruajtjes së ujit, me strategji gjithëpërfshirëse për menaxhimin efikas të resurseve ujore, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për pasuri natyrore. Krahas kësaj, Maqedonia e Veriut është e përkushtuar ndaj optimizmit të praktikave të menaxhimit me mbeturina, uljen e mbeturinave dhe largimin e vazhdueshëm të minimizimit të ndikimit ndaj ambientit jetësor dhe promovimit të efikasitetit të resurseve, duke u siguruar se gratë (sidomos në zonat rurale) janë aktive dhe i shfrytëzojnë përfitimet e zgjidhjeve novatore për menaxhim me mbeturina, ruajtjen e ujit dhe menaxhimin me ajrin e pastër.

3. LLOJLLOJSHMËRIA E MBROJTUR BIOLOGJIKE DHE VENDBANIMET ME MENAXHIM TË QËNDRUESHËM

Implementimi i zgjidhjeve siç janë rritja e zonave të mbrojtura, pyllëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm me tokën, përpjekjet gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e integritetit ekologjik të ekosistemeve ujore, minimizimi i ndikimit njerëzor dhe zbutja e dëmeve ekologjike, në mënyrë shtesë e ruajnë llojllojshmërinë biologjike dhe kontribuojnë për ajër dhe ujë më të pastër, ndërsa e ruajnë edhe trashëgiminë e vetme natyrore. Krijimi i një sistemi të posaçëm me zgjidhje afatmesme për trajtimin e

vatrave ekologjike (p.sh. deponive të lindanit, etj.) dhe zvogëlimin e ndikimit të tyre ndaj ambientit jetësor dhe shëndetit të njerëzve.

4. BUJQËSIA DHE SISTEMI USHQIMOR ME PRAKTIKAT E QENDRUESHME BUJQËSORE, MENAXHIMI EFIKAS ME RESURSET DHE ZBATIMI I TEKNOLOGJIVE TË PRANUESHME EKOLOGJIKE

Ky prioritet shumë shtresor përfshinë miratimin e metodave të përgjegjshme ekologjike në bujqësi, zvogëlimin e mbeturinave nga resurset dhe integrimin e teknologjive më bashkëkohore për përmirësimin e produktivitetit bujqësor gjatë minimizimit të ndikimit ndaj ambientit jetësor, përmes përfshirjes aktive dhe njohjes së rolit specifik të grave fermerë në shfrytëzimin e resurseve, realizimin e teknologjive ekologjike dhe rritjen e vetëdijes për mbrojtjen e ambientit jetësor gjatë menaxhimit bujqësor. Përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve dhe mjeteve tjera kimike dhe favorizimin e zbatimit të masave agroteknike ekologjike dhe prodhimit të organike. Me rëndësi të veçantë është edhe ruajtja e prodhimit të organike si një sistem i përgjithshëm i menaxhimit me feramat dhe prodhimit të ushqimit që kombinon praktikën më të mirë në raport me ambientin jetësor dhe aksioneve klimatike, nivelin të lartë të biodiversitetit, ruajtjes së resurseve natyrore dhe zbatimit të standardeve të larta të mirëqenies së standardeve jetësore dhe atyre të prodhimit në pajtim me kërkesat për produkte të prodhuara përmes substancave dhe proceseve natyrore.

Me këtë sigurohet një sektor rezistent dhe ekologjik bujqësor që kontribuon për sigurimin e ushqimit, rritjes ekonomike dhe mbrojtjen e resurseve natyrore, duke zbutur ndotjen me çka synon për një të ardhme më të qëndrueshme dhe më të përgjegjshme ekologjike. Në mënyrë shtesë nxitet edhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i tokës dhe ulet probabiliteti për erozion dhe degradim të tokës. Ndjekja me vëmendje e sistemit ushqimor në drejtim të sigurimit të ushqimit të drejtë shëndetësor dhe vlera nutritive për popullsinë. Siguria e ushqimit është një determinues i konsiderueshëm për pozitën konkurruese të produkteve bujqësore-ushqimore në tregun vendor dhe tregjet e jashtme.

5. SHFRYTËZIMI RACIONAL I RESURSEVE NATYRORE DHE VETËDIJA E LARTË PËR AMBIENTIN JETËSOR

Qasje afatgjate gjithëpërfshirëse në drejtim të shfrytëzimit të planifikuar dhe racional të resurseve natyrore në funksion të një ambienti të shëndoshë jetësor dhe mirëqenie ekonomike. Krijimi i një qasjeje të qëndrueshme të shfrytëzimit të resurseve të xeheve (xehetarisë), tokës, resurseve ujore dhe pyjeve. Faktori njeri është bazë për implementimin e të gjitha prioriteteve të lartpërmendura për jetë në një ambient jetësor të shëndoshë, të pastër dhe me klimë neutrale. Për këtë, prioritet është edhe roli i tyre për arritjen e këtij qëllimi, respektivisht për zhvillimin e vetëdijes më të lartë, duke filluar nga mosha e vogël në sistemin arsimor. Përpjekjet njerëzore dhe institucionale për uljen e mbeturinave, zbutjen e degradimit të ambientit jetësor dhe ruajtjen e qasjes afatgjate në ujë, pyje, minerale dhe në tokë. Arsimimi i vazhdueshëm për ambientin jetësor paraqet prioritet, përfshirë edhe edukimin e medimeve.

6. SISTEMET LIQENORE, LUMORE DHE PYJORE PA NDIKIM TË DËMSHËM ANTROPOGJEN

Përpjekje gjithëpërfshirëse edhe për ruajtjen e integritetit ekologjik të këtyre ekosistemeve vitale, duke e minimizuar ndikimin njerëzor dhe duke zbutur dëmin ekologjik, duke siguruar pjesëmarrje aktive të grave në miratimin e vendimeve për menaxhim të qëndrueshëm me resurset dhe mbrojtjen e ambientit jetësor. Me këtë sigurohet këto sisteme natyrore si vendbanime esenciale për llojllojshmërinë biologjike, që njëkohësisht janë edhe resurse të vlefshme dhe mundësi për rekreacion.

7. SISTEMI FUNKSIONAL PËR MONITORIMIN DHE MENAXHIMIN ME NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE AMBIENTIN JETËSOR

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe krijimit të politikave për ndjekjen efikase dhe ballafaqimin me ndryshimet në ambientin jetësor, veçanërisht si përgjigje e sfidave klimatike. Një sistem efikas dhe mirë i strukturuar do t'i mbrojë resurset natyrore dhe do të krijojë njohuri të vlefshme për miratimin e qëndrueshëm të vendimeve dhe zhvillimit të politikave.

Roli i procesit të digjitalizimit dhe teknologjive të reja në tranzicionin e gjelbër të vendit

Integrimi i teknologjive digjitale paraqet një mjet të fuqishëm për mundësimin e një tranzicioni të gjelbër dhe të qëndrueshëm, që ka rëndësi kyçe edhe për gjeneratat e tanishme dhe ato të ardhshme. Digjitalizimi i metodologjive të bazuara në të dhëna do të kenë rëndësi të madhe për krijimin e politikave për ambientin jetësor dhe do ta harmonizojnë Maqedoninë e Veriut me standardet globale të qëndrueshmërisë. Rrjeti i strukturuar me sensorë nëpër tërë sektorët urban dhe ruralë do të shpërndajë të dhëna në kohë reale që janë esenciale për krijimin e politikave të bazuara në informata. Me ndihmën e analitikëve të avancuara të të dhënave, krijuesit e politikave do të fitojnë rezultate të besueshme për tendencat e shpenzimit të energjisë elektrike, metrikës për krijimin e mbeturinave. Të dhëna të detajuara dhe konkrete që merren nga tërë vendi do të prezantohen si të dhëna të rëndësishme për intervenimet e bëra në kuadër të politikave.

SKZH përpiqet për krijimin e platformave digjitale të lehta për qasje. Këto platforma, që kanë rëndësi të posaçme për informimin e shoqërisë, do ta nxisin komunikimin transparent ndërmjet krijuesve të politikave dhe publikut. Gjithashtu do të mundësohen mekanizma për informata kthyesë dhe do të kujdesen që politikat e ambientit jetësor vazhdimisht të përsosen dhe të jenë në pajtim me realitetin në terren.



6. PËRGGJIGJA E POLITIKAVE – NDRYSHIME SISTEMORE

Transformimi sistematik në mënyrë të barabartë e përmirëson efikasitetin dhe shkathtësinë e punës tonë dhe dukshëm ndikon në zhvillimin potencial të shoqërisë. Me shpërndarjen strategjike të resurseve dhe integrimin e shfrytëzuesve në to, hapet rruga për politika, masa dhe procese të punës më të thjeshta dhe më efikase. Ky ndryshim kërkon procese novatore të mendimit, redizajnim, qasje të reja dhe miratimin e teknologjive të reja. Me rëndësi është që të theksohet se ndryshimi i qasjeve/qëndrimeve detyrimisht e përfshinë edhe rezistencën, që në fakt mundëson që sistemet e tona të jenë mjaftë të përshtatshëm sa t'u përshtaten rrethanave të ndryshueshme.

Gjatë formulimit të SKZH, përmes një procesi të gjerë dhe pjesëmarrës me të gjitha palët e interesuara, kemi identifikuar 20 ndryshime esenciale që duhet të realizohen në 20 vitet e ardhshme me qëllim që të realizohet vizioni dhe të vendosen orientimet kyçe për një zhvillim afatgjatë të vendit. Që këto ndryshime të kenë sukses, është me rëndësi që ato të merren parasysh nga të gjitha palët e interesuara dhe implementimi i tyre të fillojë menjëherë pas miratimit zyrtar të këtij dokumenti më të lartë strategjik.

1. Vlera e re gjithnjë e më shumë të krijohet përmes sipërmarrësisë dhe proceseve të udhëhequra nga inovacionet

Vlera e re gjithnjë e më shumë krijohet përmes sipërmarrësisë dhe përmes inovacioneve dhe më pas nuk kufizohet vetëm në një aspekt, por e inkadron tërë ekosistemin e sipërmarrësisë dhe mënyrën e menaxhimit me inovacione, që në esencë e ndryshon rëndësinë e procesit transformues dhe mënyrës së si i shohim dhe e realizojmë rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ndryshimi sistematik fokusohet në integrimin e inovacioneve në të gjitha aspektet e proceseve biznesore, me ç'rast metodat novatore, teknologjitë dhe praktikat shtohen në secilën pjesë të organizatës, që krijojnë një rrjedhë të vazhdueshme të vlerës së re. Zhvillimi i kulturës së inovacioneve dhe sipërmarrësisë është e bazuar në modernizimin e perceptimit të përgjithshëm për sipërmarrësit si grupe dhe individ aktiv dhe të përgjegjshëm. Sukseset e sipërmarrjeve janë të njohura gjerësisht, ndërsa sipërmarrësit promovohen si krijues kritik të vlerës, që nxisin investime dhe krijojnë vende të reja të punës. Organizimi i edukimit për sipërmarrësinë dhe inovacionet në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe krijimin e platformave joformale arsimore për të siguruar qasje në trajnimet e sipërmarrësisë. Sipërmarrësia dhe inovacionet duhet të bëhen pjesë e rëndësishme në krijimin e qëndrueshmërisë ekonomike, derisa krijimi i vlerës së re përmes proceseve novatore siguron rritje të vazhdueshme, përparësi konkurruese dhe përshtatje ndaj kushteve të ndryshueshme të tregut.

2. Njohuritë dhe zhvillimi i shkathtësive janë fleksibile dhe të fokusuar ndaj nevojave

Sistem i kombinuar i arsimit formal me atë joformal, dizajni më fleksibil me programet mësimore, të përshtatura me qasjen/metodologjinë pedagogjike që mundëson mësim të personalizuar dhe përzgjedhje të zhvillimit të karrierës. Krijimi i mekanizmave për njohjen dhe përsosjen e shkathtësive dhe arritjeve në nivel individual, si dhe një sistem për përkrahje të qëndrueshme të projekteve hulumtuese dhe zhvillimore. Mekanizëm funksional për mësim të përgjithshëm që mundëson që njerëzit t'i azhurnojnë shkathtësitë e tyre në pajtim me ndryshimet e shpejta në teknologji dhe biznes. Me fokusimin e nxënësve/shfrytëzuesve ndaj nevojave në lidhje me të ardhmen në vendet e punës, nxiten investimet private dhe punësimi. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik, institucioneve arsimore dhe

kompanive private për të mundësuar transmetimin e njohurive dhe inovacioneve dhe për të siguruar një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet edukimit dhe nevojave të tregut të punës.

3. Arritja e efikasitetit me zbatimin e teknologjive dhe modeleve të reja të biznesit

Riformulimi thelbësor i mënyrës se si realizohen aktivitetet e biznesit, përmes zbatimit të teknologjive të reja dhe të biznes modeleve me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe ndjekjes së vazhdueshme të biznes trendëve moderne. Miratimi i teknologjive të reja do të del nga fitimi i njohurive dhe shkathtësive të reja, por nevojiten edhe modele të reja të biznesit që përfshijnë mendime të pa standardizuara. Për t'u vlerësuar rreziqet, të shpërndahen resurset në mënyrë strategjike dhe të forcohet për përshtatjen e ndryshimeve të reja do të nevojitet një analizë e thellë e industrisë dhe definimin e sfidave dhe drejtimeve të veprimit. Integrimi i teknologjive të reja, riorganizimi i modeleve të biznesit, shfrytëzimi i mjeteve të avancuara për menaxhimin e të dhënave dhe analitikes, automatizimi i proceseve të biznesit i ulin gabimet njerëzore, rrisin shpejtësinë e realizimit të detyrave dhe kontribuojnë ndaj efikasitetit të përgjithshëm. Më tutje, përdorimi i efikasitetit, shfrytëzimin e resurseve (kohë, njerëz, para) në mënyrë më efektive mundëson që bizneset të jenë konkurrentë globalë që ka rëndësi të posaçme në ekonominë e sotme digjitale të bazuar në njohuri, ku kufijtë rriten, ndërsa konkurrenca është e pamëshirshme.

4. Bashkëpunimi ndërmjet faktorëve të ndryshëm mundëson arritjen e rezultateve më të mira

Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe kultura e punës në grup synon të transformojë mënyrën se si kryhen aktivitetet e biznesit që mbështet dhe inkurajon palët e ndryshme të interesit (ekipet, sektorët, partnerët dhe subjektet e tjera) të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përbashkëta. Platformat e reja të bashkëpunimit dhe modelet e biznesit të ekonomisë së ndarjes nënkuptojnë rregullim dhe vetë rregullim në mënyrë që të sigurohet që secila pjesë e zinxhirit të gjenerojë më shumë vlerë. Një qasje e tillë jo vetëm që kërkon sisteme që përfshijnë të gjithë palët e interesuara, por edhe mekanizma transparentë të qeverisjes, udhëzime gjithëpërfshirëse etike dhe mjete të avancuara të analizës së të dhënave për monitorimin dhe shpërndarjen e barabartë të vlerës në të gjithë ekosistemin. Mekanizmat funksionalë janë të domosdoshëm përmes të cilëve aktorët e ndryshëm inkurajohen të ndajnë idetë, burimet, njohuritë, duke kombinuar aftësitë dhe ekspertizën e tyre për të përmirësuar proceset dhe për të arritur qëllimet e përbashkëta. Ky bashkëpunim dhe shkëmbim do të mundësojë më tej unifikimin e perspektivave dhe resurseve të ndryshme, ballafaqimin e përbashkët me sfidat, zgjidhjen e problemeve me rezultate të përmirësuar, rritjen e efikasitetit dhe arritjen e standardeve të larta në realizimin e qëllimeve.

5. Bashkëpunimi ndërsektorial që siguron inkuadrimin e të gjitha palëve të interesuara

Bashkëpunimi ndërsektorial siguron përfshirjen e nevojave dhe interesave të ndryshme. Secila palë e interesuar kontribuon me ekspertizën dhe përvojën e vet që siguron perspektiva dhe ide të ndryshme që çojnë drejt zgjidhjeve kreative dhe novatore. Tranzicioni i politikave ose sektorëve nënkupton më shumë se sa përparim në implementimin ose zbatimin e reformave rregullatorë, respektivisht nevojiten ndryshime strategjike nga puna e pavarur drejt bashkëpunimit të integruar ndërsektorial. Qëllimi është që të lëvizim sa më larg perspektivës së kufizuar dhe të mbyllur drejt një qasjeje holistike, që nxitë inovacione në çdo sistem. Përmes punës me klasterë të lidhur mes vete, palët e interesuara mundën që në mënyrë kolektive t'i shfrytëzojnë resurset dhe ekspertizën. Ky model i bashkëpunimit ka për qëllim që t'i shërbejë secilit pjesëmarrës duke krijuar kështu një ekosistem ku palët e interesuara zhvillohen së bashku, e nuk mbesin në izolim. Ndryshimi i këtillë mundëson përshtatjen efektive ndaj nevojave dinamike dhe sfidave të bashkësisë dhe arritjes së rezultateve të qëndrueshme dhe inkluzive.

6. Shërbimet publike dizajnohen sipas nevojave të shfrytëzuesve dhe efikasitetit/efektivitetit të sigurimit të tyre

Karakteristikë e këtij ndryshimi është përfshirja aktive e shfrytëzuesve në krijimin e shërbimeve publike dhe orientimit drejt nevojave të shfrytëzuesve. Shërbimet që janë të orientuara drejt shfrytëzuesve ju mundësojnë bizneseve dhe individëve që të qasen ndaj një vlere më të lartë përmes përshtatjes dhe harmonizimit të ofertës me nevojat specifike. Për ta realizuar këtë potencial, është e domosdoshme një analizë e të gjitha aspekteve të shërbimeve publike, si dhe partneriteteve të fuqishme ndërmjet palëve të interesuara, përfshirë edhe lidhjen me qeverinë, shoqërinë civile, komunitetin akademik dhe sektorin privat. Së bashku, këto subjekte mund të sigurojnë krijimin e shërbimeve publike që janë të përshtatura me nevojat dhe pritshmëritë e shfrytëzuesve. Kjo qasje bashkëpunuese përmes optimizimit të proceseve dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja dhe metodave novatore, siguron një menaxhim të përgjegjshëm me resurset publike, dërgesë më efikase dhe më të shpejtë të shërbimeve që i plotësojnë kërkesat e ndryshme dhe të ndryshueshme shoqërore.

7. Skemat kombëtare për përkrahje të orientuara drejt transformimit të ekonomisë përmes sigurimit të tranzicionit të lirë dhe të drejtë

Sigurimi sistematik i tranzicionit të papenguar dhe të drejtë – kalimi nga një model i funksionimit ekonomik drejt një tjetri (ekonomi të avancuar, novatore dhe të qëndrueshme), me theks të veçantë në drejtësinë sociale dhe ekonomike. Skemat kombëtare përkrahin një rritje inkluzive, ku përfitimet ekonomike dhe mundësitë shpërndahen në mënyrë adekuate, që e përmirëson barazinë sociale dhe ekonomike. Politikat kombëtare i tejkalojnë rreziqet investuese në teknologjitë e reja, e njëkohësisht edhe i lehtësojnë zhvillimet e modeleve novatore të biznesit dhe strukturat e tregut. Fokusi i nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara, përfshirë edhe sektorin privat, akademik dhe atë civil, ka rëndësi esenciale. Përkrahje e synuar dhe e paanshme e siguruar (përmes kriteve transparente dhe të definuar objektive) për ri pozicionimin e tregut, do t'u mundësojë sektorëve tradicional që të përshtaten ndaj realiteteve të reja. Përkrahja financiare, investimet, stimulimi i inovacioneve, përkrahja e kalimit drejt teknologjive të reja dhe zhvillimit të tregjeve të reja, janë rëndësi të jashtëzakonshme. Në mënyrë shtesë nevojitet implementimi i ndryshimeve sistematike për avancimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore dhe zhvillimit të shkathëtisë të reja të nevojshme për transformimin e suksesshëm.

8. Sistemi shëndetësor dhe aktivizimi i popullsisë bazohen në promovimin e një jetese më të shëndoshë, uljen e rrezikut dhe parandalimin te të gjitha grup-moshat

Transformimi i sistemit shëndetësor, që përkrah në mënyrë më të shëndoshë të jetesës, parandalimin dhe ngritjen e vetëdijes dhe aktiviteteve te të gjitha grup-moshat. Ulja e rrezikut nga sëmundjet dhe parandalimi që përfshinë edhe zbulimin e hershëm dhe kontrollin e problemeve potenciale shëndetësore, arsimimi për jetesë në mënyrë që të ulët rreziku nga sëmundjet, si dhe stimulimi i qytetarëve që të jenë pjesëmarrës aktiv për gjendjen e tyre shëndetësore. Sistemi shëndetësor do të miratojë një qasje në drejtim të njerëzve përmes integritit të plotë të masave parandaluese dhe shërbimeve sociale, juridike-të punës dhe ato shëndetësore, njëkohësisht duke u dhënë prioritet shërbimeve shëndetësore, përfshirë edhe ushqimin, aktivitetin fizik, shëndetin mendor dhe parandalimin me qëllim të krijimit të një qasje gjithëpërfshirëse ndaj kujdesit shëndetësor. Kjo qasje do të mundësojë që të përmirësojmë kualitetin e shërbimeve, të ulim shpenzimet për mbrojtjen shëndetësore dhe për të përmirësuar mirëqenien e plotë të popullsisë. Kjo strategji e bazuar në të dhëna do ta zbusë përdorimin e tepruar të sistemeve shëndetësore dhe do ta përmirësojë efikasitetin e sistemit, që do të çojë deri te një qasje të drejtë universale për mbrojtje shëndetësore.

9. Sistemet e qëndrueshme të prodhimit të ushqimit janë kyçe për kualitetin jetësor dhe rezistencën e vendit

Një sistem ushqimor rezistent i bazuar në produkte me kualitet të lartë, prodhimtari të lokalizuar dhe konsum përgjegjës, me fokus në qëndrueshmërinë e ambientit jetësor, sigurinë e ushqimit dhe drejtësisë sociale. Krijimi i sistemeve për prodhimin e ushqimit të bazuar në parimet e qëndrueshmërisë, që përfshinë shfrytëzimin e balancuar të resurseve, mbrojtjen dhe shfrytëzimin optimal të sipërfaqes, ujit dhe energjisë. Së këndejmë, qëllimi duhet të jetë minimizimi i mbeturinave ushqimore dhe energjisë nëpër tërë zinxhirin e furnizimit. Investime të rritura për modernizimin e bujqësisë dhe sektorit ushqimor, për qëndrueshmëri të ambienteve rurale, rregullimin e tregjeve me produkte bujqësore. Aksione për ballafaqim me probleme strukturore – strukturën e moshës/bujq të riinjë, fragmentim të tokës, vëllimi ekonomik i ekonomive, mos organizimi i prodhuesve të vegjël, etj. Qëllimi ynë parësor është që të ofrojmë opsione të qasshme, ushqyese dhe të sigurta të ushqimit për të gjitha shtresat sociale, duke u dhënë prioritet mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve. Në mënyrë shtesë, politikat tona do të dizajnohen për t'u ballafaquar me sfidat gjinore-specifike, duke promovuar barazi gjinore në praktikën bujqësore dhe duke siguruar qasje deri te resurset dhe mundësitë për të gjithë. Sistemet e qëndrueshme të prodhimit të ushqimit kanë ndikim të drejtpërdrejtë të kualitetit jetësor dhe përmirësimin e rezistencës së vendit ndaj ndryshimeve klimatike, ndotjes dhe sfidave të tjera. Në mënyrë shtesë, i përkrahin edhe bashkësitë lokale përmes promovimit të bujqve lokal dhe prodhuesve, duke kontribuar për stabilitetin ekonomik dhe lidhjes sociale në shoqëri. Ky ndryshim sistematik e përkrah konceptin e bashkëpunimit global për qëndrueshmëri ku palët nxiten që të ndajnë praktikën e mira dhe teknologjitë për përmirësimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit në nivel global, me qëllim të organizimit të prodhimit të ushqimore në harmoni me natyrën dhe duke përkrahur mirëqenien dhe stabilitetin e përgjithshëm.

10. Masat për mbrojtje sociale nxisin ndryshime në gjendjen e grupeve të synuara sociale dhe e përkrahin rritjen e natalitetit

Zbatimi i masave të mbrojtjes sociale që synojnë përmirësimin e gjendjes së grupeve të synuara sociale, stimulimin e rritjes së natalitetit, të cilat njëherë krijojnë një baraspeshë pozitive në komunitet dhe inkurajojnë integrimin social. Për një mbulim më të mirë të masave sociale, një ndryshim paradigme dhe vendosja e përfitimeve është e nevojshme, e kushtëzuar nga punësimi, struktura e përfitimeve me faza dhe masat kundër diskriminimit. Një sistem integral i përdorimit të masave që stimulojnë rritjen e nivelit të lindjeve, stabilitetin financiar, ndihmën dhe arsimimin e prindërve, përfshirjen sociale, disponueshmërinë e shërbimeve dhe mbështetjen për jetesë të pavarur mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në gjendjen e subjekteve të synuara. Bashkëpunimi ndërsektorial është kyç për krijimin e një ekosistemi që inkurajon pavarësinë dhe krijimin e mundësive të punësimit mes përdoruesve. Këto partneritete duhet të përfshijnë palët e interesuara nga qeveria, sektori privat dhe shoqëria civile, në një proces të përbashkët, koheziv drejt qëllimeve të përbashkëta. Duke e riorientuar fokusin tek rikualifikimi dhe punësimi, masat e ridizajnuara të mbrojtjes sociale mund të shërbejnë si katalizatorë për rritjen personale dhe sociale.

11. Miratimi i vendimeve dhe krijimi i politikave që bazohen në të dhëna dhe argumente

Miratimi i vendimeve dhe krijimi i politikave duhet të bazohen në baza të të dhënave dhe analiza që janë të besueshme dhe kualitative. Ndryshimi i këtillë sistematik do të sigurojë ndërtimin më të lehtë të konsensusit, paanshmëri në vendimmarrjes, sqarim transparent të arsytimit të vendimeve dhe politikave të caktuara, por edhe rritjes së besimit të publikut në institucione. Të dhënat dhe analizat kualitative statistikore mundësojnë ndjekjen e vazhdueshme të rezultateve nga vendimet dhe politikat, vlerësimi periodik, shpërndarja më efikase e resurseve, mundësi për inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm. Parakusht i rëndësishëm për këtë ndryshim sistematik është forcimi i kapaciteteve të sektorit publik dhe privat për mbledhjen, sistematizimin dhe publikimin e të dhënave kualitative dhe zbatimin dhe/ose shfrytëzimin e analizave dhe hulumtimeve të bazuara shkencore. Pozita të caktuara të punës në sektorin publik kërkojnë ekspertizë më të madhe gjatë miratimit të vendimeve të informuara dhe krijimit të

politikave dhe duhet të vlerësohen edhe më tepër. Gjithashtu, një pjesë e vendimeve dhe politikave duhet të bazohen në analiza dhe hulumtime më të sofistikuara, që do të përpiloheshin në bashkëpunim me komunitetin akademik, partnerët ndërkombëtar zhvillimor dhe shoqërinë civile. Vlerësimi i implikimeve fiskale dhe ndikimit të rregullativës së re duhet të jetë esenciale, e jo vetëm një obligim formal i institucioneve.

12. Eliminimi i korrupsionit dhe forcimi i transparencës dhe llogaridhënies kanë rëndësi kyçe për një sektor publik efikas, efektiv, dhe të përgjegjshëm

Nevojitet vullnet u fuqishëm politik dhe nivel kritik i përkrahjes shoqërore për ndryshime themelore sistematike për menaxhimin me sektorin publik. Vullneti politik duhet të mundësojë ambient, ku të gjitha institucionet e pushtetit – ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, do t'i realizojnë funksionet e veta në bazë të vlerave dhe standardeve evropiane, me një gjyqësor të lartë efikas, efektiv, llogaridhënës, transparent dhe të digjitalizuar, me një administratë publike të fuqishme, profesionale, të depolitizuar dhe efikase, me qytetarë që janë pjesëmarrës të vërtet në vendimmarrjen politike. Njëkohësisht, nevojitet një pjesëmarrje esenciale e komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe partive politike në krijimin e politikave publike përmes avancimit të vazhdueshëm të raporteve demokratike. Niveli kritik i përkrahjes shoqërore duhet të ndërtohet përmes partive si promovues të sundimit të së drejtës dhe menaxhimit të drejtë, aktivizmit të shoqërisë civile, mediave të lira dhe të pavarura, por edhe përmes edukimit dhe arsimit. Në një periudhë afatmesme dhe afatgjate, arsimimi politik, njohuritë dhe zhvillimi i shkathtësive për mendim kritik me vlera të integruara morale, gjithashtu duhet të ndihmojnë në ndërtimin e një sektori publik efikas, efektiv dhe të përgjegjshëm, të orientuar ndaj nevojave të njerëzve. Eliminimi i korrupsionit, por edhe forcimi i transparencës dhe llogaridhënies kanë rëndësi të jashtëzakonshme për vlerësimin e performancave të sektorit publik, analizës dhe vlerësimit të politikave publike, si dhe ruajtjes së qasjes inkluzive dhe përgjegjësisë gjatë dorëzimit të të mirave dhe shërbimeve publike.

13. Rezistenca e shoqërisë dhe komuniteteve do të sigurohet me transformimin e menaxhimit me rreziqet dhe pjesëmarrjen proaktive për të gjithë

Siguria bashkëkohore dhe rezistenca e shoqërisë i përfshinë faktorët kolektiv dhe individual, shoqëror dhe ato të jashtëm (përfshirë edhe ndryshimet ekologjike dhe klimatike). Këto komponentë e përfshijnë edhe dinamikën globale të sigurisë, kontekstin kombëtar dhe aktivitetet e të gjitha subjekteve në uljen e rreziqeve nga katastrofat. Me qëllim të ballafaqimit me këtë ambient kompleks gjithnjë e më shumë rritet nevoja për krijimin e sistemeve transformuese dhe proaktive për menaxhim me rreziqet, me ç'rast do të parandalohen dhe zbuten pasojat negative nga rreziqet ekzistuese dhe do të anticipohen rreziqet e reja dhe ato potenciale. Kjo qasje e integruar i bashkon të gjitha palët e interesuara nga sektorët e ndryshëm dhe përmes këtij bashkëpunimi, shoqëria mund që më mirë t'i parandalojë, përgatis dhe ballafaqohet me rreziqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu, nga ndryshimet klimatike si dhe nga sfidat dhe kërcënimet e sigurisë.

14. Shfrytëzimi i përparësive të digjitalizimit

Ndryshimet ekonomike, ekologjike, arsimore dhe në përgjithësi ato shoqërore, gjithnjë e më shumë do të varen nga shfrytëzimi i përparësive të transformimit digjital. Avancimi i infrastrukturës për lidhje, digjitalizimin e të dhënave, proceset dhe kualitetin e shërbimeve digjitale duhet të jenë si prioritete më të rëndësishme ndërsektoriale. Interoperabiliteti i shërbimeve të sektorit privat dhe publik, respektivisht aftësia për lidhje funksionale, kompatibilitet dhe për shpërndarje, posedon potencial të madh për përmirësimin e efikasitetit dhe rritjes së qasjes së shfrytëzuesve. Individët, bizneset dhe institucionet që do t'i shfrytëzojnë përparësitë e të ardhmes eksponenciale të inteligjencës artificiale, dot a ulin nyjën digjitale, do ta forcojnë inovacionin dhe do ta përmirësojnë produktivitetin.

15. Integrimi dhe reputacioni ndërkombëtar

Autenticiteti i kulturës maqedonase duhet të vije në shprehje përmes pjesëmarrjes së vendit në iniciativat rajonale, në bashkëpunimin evropian si dhe në ruajtjen e partneriteteve globale. Pjesa maqedonase duhet të jetë pjesë përbërëse e këtij mozaiku. Krahas kësaj, ekspozimi i të gjitha shtresave të qytetarisë në rrjedhat rajonale, evropiane dhe globale, do të kontribuojë për avancimin e të gjitha proceseve. Me këtë rast, domosdo është që vetë procesi edukativ-arsimor t'i inkorporojë vetë respektin, entuziazmin dhe besimin në sukses si lëvizës të zhvillimit të përsheptuar, inkluziv dhe të qëndrueshëm të shoqërisë. Pasurimi i kulturës dhe forcimi i identitetit janë një segment tejet të jashtëzakonshëm të ndryshimit të nevojshëm sistematik për ura të reja të bashkëpunimit ndërkombëtar politik, ekonomik dhe kulturor. Gjatë realizimit të këtyre përpjekjeve në veçanti duhet të forcohen partneritetet strategjike dhe të forcohen dhe thellohen integrimet evropiane.

16. Ulja e pabarazive rajonale dhe lokale përmes qasjes funksionale në shërbime, njohuri dhe infrastrukturë

Për të nxitur një zhvillim të barabartë lokal dhe rajonal, infrastruktura dhe shërbimet duhet të orientohen drejt shfrytëzuesve dhe të përshtatura sipas nevojave dhe dëshirave specifike të banorëve lokal. Decentralizimi funksional dhe hapja e mundësive të reja ekonomike (mes tjerash, përmes tërheqjes së investimeve, nxitjes së inovacioneve dhe ndërtimit të infrastrukturës) duhet të orientohen drejt përkrahjes së zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe uljes së pabarazive lokale dhe rajonale. Nevojitet që rajonet e planit dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale në strategjitë e tyre zhvillimore t'u japin prioritet mundësive unike dhe përparësive konkurruese. Kjo qasje jo vetëm që siguron një shpërndarje të orientuar dhe efektive të resurseve, por edhe e maksimizon vlerën shoqërore. Me këtë, rajonet e planit dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale dot ë përkrahin bashkësi të qëndrueshme, inkluzive dhe më të fuqishme ekonomike.

17. Ruajtja e ambientit jetësor dhe mirëqenies ekologjike paraqesin prioritet gjatë zhvillimit

Ruajtja e ambientit jetësor dhe mirëqenies ekologjike e imponojnë nevojën për ndryshime të rëndësishme sistematike që në masë të madhe do ta përcaktojnë kualitetin e jetës së gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme. Me largimin nga qasja e deritanishme dominuese lineare, sipas së cilës prodhimet dizajnohen, prodhohen, shiten, shpenzohen dhe hidhen, dhe pranimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese, do të minimizohen ndikimet negative ndaj ekosistemeve dhe resurseve natyrore. Teknologjitë dhe materialet e qëndrueshme, siç janë burimet e rinovueshme të energjisë, riciklimi i mbeturinave dhe masat për kursimin e ujit, detyrimisht duhet të integrohen në projektet zhvillimore për të përkrahur dekarbonizimin dhe për të ulur gjurmët ekologjike. Pjesëmarrja e bashkësive lokale dhe opinionit të gjerë, gjithashtu kanë rëndësi në aspekt të asaj se si do të dizajnohen dhe realizohen projektet zhvillimore. Në veçanti si të dobishme janë edhe iniciativat, që njëkohësisht janë ekologjikisht të qëndrueshme dhe të pranueshme në aspekt social. Qasja e këtyre krijon një ndërveprim të qëndrueshëm dhe harmonik ndërmjet njerëzve dhe natyrës, duke siguruar një rezistencë afatgjatë dhe mirëqenie shoqërore.

18. Nga planifikimi afatshkurtër drejt planifikimit dhe vizionit afatgjatë

Planifikimi afatgjatë indikativ është faktor i rëndësishëm për shpërndarjen efikase të resurseve, qëndrueshmërisë së politikave dhe të rezultateve, si dhe realizimit të vizionit për zhvillimin kombëtar. Nevojitet edhe një ndryshim i thellë sistematik, me të cilat planifikimi afatshkurtër dhe bazimi në ad hoc vendime, gradualisht duhet të zëvendësohet me planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë, të krijuar me një konsensus të gjere shoqëror. Rëndësi të veçantë ka edhe planifikimi afatgjatë i atyre politikave dhe reformave, që kërkojnë përkushtim nga disa qeveri me radhë dhe rezultatet e të cilave shihen vetëm në afat të mesëm dhe të gjatë (p.sh., investime në arsimimin kualitativ, investime në infrastrukturën fizike, qasjen e sigurve dhe qasjen në energji, zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e

diversitetit, etj. Ndërtimi i kapaciteteve për parashikim më të madh dhe integrim të rreziqeve, mundësojnë përshtatjen në kohë ndaj ndryshimeve të kontekstit dhe rezistencës më të madhe të shoqërisë ndaj krizave dhe sfidave të reja.

19. Qasja sistematike ndaj përgatitjes dhe realizimit të strategjive

Përgatitja dhe realizimi i strategjive duhet të bazohet në një koordinim të gjerë ndërsektorial në nivele të ndryshme të menaxhimit, mes tjerash, edhe përmes forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal. Integrimi i aspekteve dhe interesave të ndryshme të palëve të interesuara e forcon pronësinë ndaj strategjive, ku strategjitë dhe politikat që dalin prej tyre, janë konsistente dhe të qëndrueshme. Qasja sistematike nënkupton edhe lidhjen e strategjive dhe politikave me planifikimin afatmesëm buxhetor, respektivisht resurset e disponueshme për implementimin e tyre dhe buxhetimin e programuar.

20. Integrimi i resurseve publike dhe private dhe mekanizmave dhe instrumenteve novatore për financimin e zhvillimit

Qasja e re e financimit të Strategjisë Kombëtare Zhvillimore dhe strategjive të tjera (shumë) sektoriale nuk duhet të bazohet vetëm në mjetet buxhetore dhe grantet/huatë e Bashkimit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare. Nevojitet një ndryshim sistematik që do të mundësojë një spektër të gjerë të burimeve, instrumenteve dhe mekanizmave për financimin e projekteve në fushat strategjike, siç janë mobilizimi i kapitalit privat përmes kombinimit të financave, fondeve me garanci, obligacioneve me ndikim shoqëror dhe obligacioneve të gjelbra. Parimi kryesor për mobilizimin e kapitalit privat për qëllimet e SKZH-së duhet patjetër të jetë mbrojtja dhe promovimi i interesit publik. Obligacionet e ardhshme detyrimisht të bazohen në analizë të dobive dhe shpenzimeve të projekteve, që do të financohen, ku duhet të kemi kujdes për stabilitetin fiskal dhe optimizimin e shpenzimeve të borxhit publik.



7. KOORDINIMI DHE IMPLEMENTIMI

Strategjia Kombëtare Zhvillimore (SKZH) miratohet për një periudhë deri në vitin 2044. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miraton SKZH si një dokument më i lartë afatgjatë strategjik i hierarkisë së planifikimit. SKZH mundëson sinergji të nevojave dhe mundësive zhvillimore, sferave zhvillimore, qëllimeve të përgjithshme, prioriteteve për çdo qëllim të përgjithshëm, duke marrë parasysh të gjitha standardet dhe obligimet e pranueshme ndërkombëtare të vendit.


SKZH i pasqyron vlerat themelore të rendit kushtetues të Maqedonisë së Veriut. Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, vlerave themelore edhe të Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, duke përkrahur dhe mundësuar reformat për integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE. Realizimi i të lartpërmendurës nënkupton një proces të planifikimit të integruar zhvillimor, politikave konsistente dhe bashkëpunimit në nivele të ndryshme dhe inkuadrimit të faktorëve kryesor në procesin e planifikimit, realizimit dhe ndjekjes së SKZH-së.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të SKZH-së përmes sistemit të krijuar për implementim dhe në bashkëpunim me palët dhe partnerët e tjerë të interesuar.

SKZH është kornizë kombëtare në të cilën janë integruar të gjitha strategjitë, programet dhe planet sektoriale zhvillimore, si dhe bashkëpunimi me palët e tjera të interesuara. Kjo qasje sistemore është e lidhur fuqishëm me kontributin e vazhdueshëm të sektorit të biznesit, organizatave joqeveritare, komunitetit akademik, medimeve, faktorëve politik, etj.

Në nivelin më të lartë strategjik, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmerr përgjegjësi për ta koordinuar implementimin e SKZH-së me ministritë, agjencitë qeveritare, trupat e tjerë dhe palët e interesuara gjatë përgatitjes së strategjive, politikave dhe programeve dhe realizimit të tyre, përmes integritit të prioriteteve strategjike të SKZH-së në dokumentet e tjera strategjike kombëtare. Qeveria e Maqedonisë së Veriut gjithashtu kujdeset për të harmonizuar implementimin e aktiviteteve që janë pjesë e SKZH-së me politikën kombëtare fiskale, parimet dhe rregullat fiskale.

Në mënyrë shtesë, kujdesemi është për Programin kombëtar për reforma dhe përgjigje të tjera të indikatorëve reformues në lidhje me agjendën e BE-së ku nevojiten rezultate më të larta për harmonizimin e strategjive të qëllimeve. Për të arritur rezultatet, nevojitet një zhvillim i planifikuar dhe bashkëpunim afatgjatë me investuesit privat, sektorin e biznesit, institucionet financiare dhe veçanërisht, partnerët ndërkombëtar zhvillimore që kanë rol të konsiderueshëm në vizionin zhvillimor të vendit.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të sigurohet se realizimi i strategjive, planeve dhe programeve bëhet përmes një pasqyre/vizioni të vazhdueshëm të koordinimit ndërsektorial. Të gjitha planet zhvillimore janë të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe programeve të miratuara nga institucionet e tjera publike që duhet t'i ndjekin qëllimet, prioritetet dhe aktivitetet e përcaktuara në kuadër të SKZH-së. Gjithashtu, Qeveria me infrastrukturën e saj për implementimin e SKZH-së është përgjegjëse për të siguruar SKZH periodike për të vlerësuar, diskutuar kritik, ndërmjet palëve të interesuara dhe për të siguruar një raportim transparent për rezultatet e arritura. Evalvimi dhe monitorimi kanë rëndësi të veçantë në kontekst të agjendës së Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, si dhe në raport me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm global.

Korniza për koordinimin dhe implementimin efikas dhe efektiv të SKZH-së, krahas Qeverisë, përfshinë edhe Këshillin Kombëtar për Zhvillim me Bordin Drejtues dhe Komitetin e Punës.

Korniza e implementimit të SKZH

✓ **Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut** e miraton Strategjinë dhe Programin për realizimin e SKZH (5 vjeçare) me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

✓ **Planifikimi i realizimit të SKZH dhe Programit për realizimin e SKZH** Qeveria e realizon përmes Programit vjetor të punës së Qeverisë. Komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit sigurojnë realizimin e SKZH-së në kuadër të kompetencave të tyre.

✓ **Qeveria formon Këshillin Kombëtar** për zhvillim si një trup i përhershëm këshillues i Qeverisë, që e organizon përgatitjen e Strategjisë dhe Programit për realizimin e Strategjisë. Me Këshillin kryeson Kryetari i Qeverisë ose zëvendësi në mungesë të tij, që propozohet nga ana e tij, Anëtarë të Këshillit janë: Përfaqësuesi i Kabinetit të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut; Koordinatorët e grupeve parlamentare; 3. Kryetari i Qeverisë dhe zëvendësit e tij; Ministri i Financave; Ministri i mbrojtjes; Ministri i Ekonomisë dhe Punës; Kryetari i ASHAM-it; Sekretari gjeneral i Qeverisë; Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut, Odës Ekonomike për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit, Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore dhe Unioni i odave ekonomike të Maqedonisë së Veriut; Kryetari i komunitetit të njësisve të vetëqeverisjes lokale; Kryetarët e tetë këshillave për zhvillimin e rajoneve planore; Nga një përfaqësues i sindikatave përfaqësuese; Përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, Përfaqësues të shoqatave të emëruar nga Këshilli për Bashkëpunim Ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile; Përfaqësuesit e të rinjve, të emëruar nga Këshilli Kombëtar Rinor.

✓ **Komisioni drejtues është trup ndihmës i Këshillit** që siguron bashkëpunim strategjik dhe partneriteti për Këshillin me komunitetin ndërkombëtar, institucionet ndërkombëtare financiare dhe donatorët. Anëtarët e Komisionit drejtues janë Kryetari i Qeverisë ose zëvendëskryetari i Qeverisë i propozuar nga ai dhe ministri i Financave.

✓ **Komiteti i punës është trup ndihmës i Këshillit**, që siguron përkrahje eksperte dhe teknike për këshillin. Komiteti i punës organizohet dhe punon në grupe dhe nëngrupe në fushat sipas modelit të "Quadruple Helix" duke siguruar përfaqësimin e personave profesional të organeve drejtuese, institucioneve të tjera publike, shoqatave, ekonomisë dhe institucioneve të larta arsimore.

✓ **Ndjekja e realizimit të Strategjisë** sipas Programit për realizimin e Strategjisë dhe Programit vjetor për punën e Qeverisë, e realizon Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë përmes një Raporti vjetor për realizimin e Strategjisë, që përmban mesazet e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit. Ndjekja e realizimit të Strategjisë sipas akteve planifikuese të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave të Qytetit të Shkupit që realizohen përmes raportit, që miratohet nga këshilli komunal, respektivisht Këshilli i Qytetit të Shkupit.

✓ **Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë** siguron vlerësimin e suksesit të realizimit të Strategjisë, së paku një herë për një periudhë pesëvjeçare nga dita e miratimit të Strategjisë.

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) do të jetë një faktorë i rëndësishme dhe drejtpërdrejt i inkuadruar në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të SKZH nga ana e institucioneve të sektorit publik. Krahas aspekteve të tjera të revizionit në raportet e revizionit do të rishqyrtohet edhe përparimi i implementimit të qëllimeve dhe prioriteteve strategjike të definuar në SKZH. Në procesin e implementimit të SKZH, aktivisht do të kyçen edhe komunat, rajonet dhe palët e tjera të interesuara (komuniteti akademik, sektori i biznesit, qytetarët/organizatat civile dhe Qeveria). Kjo do të realizohet përmes zhvillimi të vazhdueshëm të kapaciteteve për përgatitjen dhe realizimin e projekteve dhe strategjive, zhvillimit të kapaciteteve të palëve të interesuara për t'u siguruar se strategjitë/projektet e përgatitura do të arrijnë rezultatet e planifikuara. Palët e interesuara në nivel kombëtar dhe lokal do të koordinohen mes vete, me fokus të zhvillimi të kapaciteteve të tyre (njerëzore, financiare dhe juridike) dhe do të investohet në përmirësimin e aftësisë së tyre për planifikim, realizim, aftësi për matje dhe mësim.

Të lartpërmendurat do të sigurojnë forcimin e shoqërisë dhe institucioneve të vendit, duke krijuar:

- stabilitet të institucioneve që garantojnë demokraci, sundimin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve (Kriteret politike)
- ekonomi funksionale të tregut dhe aftësi për t'u ballafaquar me presionin e konkurrencës dhe fuqitë e tregut të BE-së (Kriteret ekonomike), dhe
- aftësi për të ndërmarrë obligimet e anëtarësisë, përfshirë edhe kapacitetin për realizimin efektiv të rregullave, standardeve dhe politikave që e përbëjnë trupin ligjor të BE-së dhe respektimin e qëllimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar.




8. PROJEKSIONET DHE KORNIZA FINANCIARE

8.1. PROJEKSIONET

Projeksionet makroekonomike deri në vitin 2044 janë bërë duke shfrytëzuar Modelin e ardhmërive ndërkombëtare (International Futures Model) të Universitetit në Denver (SHBA). Të njëjtat bazohen në një model global dhe të integruar për 186 vende, që përmban mbi 1.700 variabile, si dhe përfshinë edhe projeksionet demografike deri në vitin 2070, të përpiluara nga Enti Shtetëror i Statistikës (ESHS,2023).

Projeksionet demografike. Sipas projeksioneve demografike të ESHS-së (dhjetor 2023), varësisht nga supozimet për shkallët e fertilitetit dhe mortalitetit dhe intensitetit të migrimeve, janë të mundshme lëvizjet demografike, që do të ishin sipas njëres prej shtatë projeksioneve ose varianteve (Foto 2). Nëse përjashtohen variantet ekstreme (Varianti 7: Mungesa e migrimeve dhe Varianti 6: Vlerat konstante), të realizueshme janë pesë variante demografike. Në këto korniza, modeli makroekonomik e krijon supozimin se struktura demografike e popullsisë do ta ndjekë trajektoren e skenarit të matur, respektivisht Variantin 2: Fertiliteti mesatar. Sipas këtij varianti, popullsia e Maqedonisë së Veriut do të ulet prej në 1,8 milion banorë në vitin 2023, në 1,4 milion banorë në vitin 2044 që do të ishte një rënie prej 23,5%. Njëkohësisht, popullsia e aftë për punë (15-64 vite) pritet që të shënojë rritje prej 1,2 milion persona në vitin 2023 në 815 persona në vitin 2044, respektivisht 31,1% më pak. Në anën pozitive, jetëgjatësia mesatare e do të rritet prej 77,1 vite në vitin 2023, në 82,7 vite në vitin 2044. Trendët e pavalitshme demografike do të kenë implikime serioze ndaj aktivitetit ekonomik, tregut të fuqisë së punës, sistemit të sigurimit pensional dhe mbrojtjes shëndetësore, strukturës së shërbimeve publike dhe preferencave konsumuese.

Figura 2. Numri i popullsisë në skenarë të ndryshme demografike (1971-2044)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, dhjetor 2023.

Skenari themelor (vazhdimi i trendëve të deritanishme). Në mungesë të reformave të reja të konsiderueshme dhe vazhdimi të trendëve nga tri dekadat e fundit, ekonomia e Maqedonisë së Veriut do të kishte një rritje të BPV prej 2,6% në vit gjatë 20 viteve të ardhshme. Dinamika e këtyre rritjes nuk do të sigurojë afrim drejt mesatares së ekonomive evropiane dhe niveleve të zhvillimit ekonomik të disa prej anëtarëve të sapo pranuar (si p.sh. Republika e Kroacisë). Shkallët e ulët të rritjes, në mënyrë shtesë do ta thellojnë një në raport me BPV për banor në BE. Prodhimtaria e energjisë nuk do të mund ta ruaj hapin me kërkesat gjithnjë e më të mëdha të energjisë, ku në kushte të produktivitetit të ulët për njësi të harxhuar të energjisë, do të imponohet nevoja për import të dukshëm të energjisë. Në këto kushte, transformimi i gjelbër do të realizohej me ritëm të ngadalësuar, ndërsa ulja e emetimeve të gazrave të qelqta nuk do të realizohej sipas dinamikës së paraparë sipas obligimeve të ndërmarrja ndërkombëtare. Në kushte të rritjes së ulët të emigrimit të mëtejshëm shkalla e varfërisë vazhdimisht do të ulej deri në nivelin 11,0% në vitin 2044, por 1,1% e popullsisë ende do të jetonin në varfëri ekstreme. Përqindja e popullsisë me arsim të lartë (në moshën 25 deri 34 vjet) edhe më tutje do të ngecin prapa mesatares së BE-së. Mbulimi me infrastrukturë rrugore në vitin 2044 do të realizonte një përparim të konsiderueshëm, por ende nuk do të ishte me 23 pikët e përqindjes në BE. Në skenarin bazë, indeksi i zhvillimit njerëzor do të kishte një rritje të vogël prej 0,89 në vitin 2023 në 0,95 në vitin 2044, por ende nën mesataren e BE-së.

Ndikimi i SKZH. Me realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve zhvillimore në sferat strategjike, ekonomia mund të realizojë shkallë më të larta të BPV për banor, në mesatare prej 4,7% në vjet. Në kuadër të sferave strategjike, realizimi i prioriteteve nga sfera e ekonomisë së qëndrueshme, inovatore dhe konkurrense ka ndikim më të madh në rritjen ekonomike. Prapë se prapë në afat të gjatë, në dy dekadat ardhshme, realizimin e prioriteteve strategjike në domenin e ndikimit të drejtës dhe sundimit të mirë ka ndikim të fuqishëm ndaj efikasitetit, kapacitetit institucional dhe ndaj zhvillimit ekonomik. Realizimi i transformimit të gjelbër, që parasheh zëvendësimin e vazhdueshëm të derivateve fosile, përdorimit më të madh të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe tranzicionit të drejtë, tërheq shpenzime për aftësimin e kompanive dhe qytetarëve dhe do të shkaktonte shpenzime për aftësimin e kompanive dhe qytetarëve dhe do të shkaktonte rritje të vogël të BPV për banorë në krahasim me skenarin e mungesës së reformave. Ndikimi i kombinuar i prioriteteve të realizuara në gjashtë sferat strategjike do të kontribuonte për 24,8% shkallë më të lartë të BPV për banor, krahasuar me skenarin themelor për vitin 2044 (Foto 3). Së këndejmë, BPV për banor në vitin 2044 do të rritet për 42% nga BPV mesatar për banor në BE në vitin 2022 deri në nivelin 56,5% të BPV të projektuar për banor në BE në vitin 2044. Me realizimin e denjë të SKZH shkalla e varfërisë do të ulej deri në nivelin 5,4% në vitin 2044. Me këtë rast, niveli i varfërisë ekstreme në vitin 2030 do të ishte nën 3%, me çka do të arrihej synimi në vitin 2030, i definuar me qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm.

Figura 3. Ndikimi i realizimit të SKZH ndaj rritjes ekonomike kundrejt skenarit vijues të tendencave të deritanishme të vazhduara (viti 2022-2044)



Në dy dekadat e ardhshme, ekonomia joformale (si përqindje e BPV) do të ulej deri në nivelin prej rreth 5% të BPV në vitin 2044, me supozimin se pjesa më e madhe e proceseve, shërbimeve dhe transaksioneve do të digjitalizoheshin. Sipas pragut të deritanishëm të definuar ndërkombëtar prej 6,85 dollarë të SHBA-ve në ditë për një individ, në vendet me të ardhura më të larta mesatare (metodologjia e Bankës Botërore), realizimi i prioriteteve strategjike do të kontribuonte për uljen e shkallës së varfërisë deri në nivel prej 5,7% të popullatës së përgjithshme. Edhe në skenarin themelor edhe në atë zhvillimor, për shkak të ndryshimeve të pavolitshme demografike, sistemi i sigurimit pensional duhet të reformohet, në drejtim të forcimit të qëndrueshmërisë së saj financiare. Indeksi i zhvillimit njerëzor pothuajse e ka arritur indeksin e projektuar mesatar të zhvillimit njerëzor në BE në vitin 2044. Duke marrë parasysh se rezultatet më të rëndësishme të reformave ndihen edhe në afat të mesëm dhe të gjatë, nevojiten politika koherente dhe të denja, që do të realizohen në periudhë më të gjatë se sa cikli zgjedhor dhe do të bazohen në një konsensus më të gjerë shoqëror.

8.2. KORNIZA FINANCIARE

Realizimi i qëllimeve dhe prioriteteve strategjike të SKZH, si dhe afrimi i performancave ekonomike të BE-së, në masë të madhe do të varen nga financimi i sferave prioritare të zhvillimit të shpejtë, inkluziv dhe të qëndrueshëm. Edhe pse financat publike janë tejet të rëndësishme, do të nevojitet edhe përkrahje e konsideruar edhe nga sektori privat, partnerët zhvillimor ndërkombëtarë dhe nga diaspora.

Financat publike karakterizohen me një nivel të lartë të të ardhurave buxhetore si përqindje e BPV, prag i lartë i borxhit publik dhe hapësirë e kufizuar fiskale për ballafaqimin me sfidat dhe krizat e ardhshme. Në skenarin themelor, të ardhurat e përgjithshme buxhetore vazhdimisht do të rriteshin prej 31,1% nga BPV në vitin 2023 në 35,0% nga BPV për vitin 2044 (projeksione të Universitetit në Denver). Me realizimin e SKZH, fillimisht si rezultat i uljes së ekonomisë joformale, kapacitetit të rritur institucional dhe reformave strukturore, të ardhurat e përgjithshme buxhetore do të mund të rriten deri në nivelin prej 44,8% nga BPV në vitin 2044. Pa marrë parasysh dinamikën e integriteteve evropiane, nevojitet një konsensus më i gjerë shoqëror dhe politik për rolin e shtetit, nivelin e ngarkimit publik me borxh dhe sistemin optimal tatimor në kontekst të qëllimeve dhe prioriteteve të definuar strategjike të SKZH. Kufijtë formal të buxhetit publik duhet të zëvendësohen me ato optimalet, respektivisht shpenzimet e obligimeve shtesë që të jenë më të ulëta se sa rritja plotësuese ekonomike, që do të gjenerohej përmes atij ngarkimi me borxh. Optimizimi i sistemit tatimor nënkupton reforma tatimore, uljen e konsiderueshme të ekonomisë joformale dhe evazionit tatimor, si dhe vlerësimin të nevojës për burime të reja të të ardhurave, siç janë tatimet dhe taksat ekologjike.

Në strukturën e të ardhurave buxhetore, rekomandohet rritja e pjesëmarrjes së tatimeve direkte, në pajtim me prioritetet strategjike por edhe trendëve tatimore në BE. Gjithashtu, edhe shpenzimet buxhetore duhet ta ndryshojnë strukturën e tyre në favor të shpenzimeve kapitale (investimet qeveritare), që do të duhet së paku të ndahen në aspekt të nivelit të deritanishëm. Fokus i konsiderueshëm duhet t'i vihet efikasitetit dhe efektivitetit, respektivisht kualitetit të shpenzimeve buxhetore dhe prioriteteve të projekteve investuese të sektorit publik. Nevojiten investime të mëdha në infrastrukturën fizike, përkrahjen financiare dhe zhvillimin lokal dhe rajonal, si dhe kohezionit territorial, financimin e transformimit dhe digjitalizimit të gjelbër, inkluzionit dhe kohezionit social, sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe prioriteteve të tjera strategjike të SKZH. Jashtëzakonisht e rëndësishme është investimi i njerëzve edhe në kapitalin njerëzor si resurs më i rëndësishëm, përmes investimeve në kualitetin dhe qasjen në arsim dhe shkencë, hulumtimin dhe zhvillimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale.

Zbatimi i rregullave fiskale do ta lehtësonte menaxhimin me financat publike dhe realizimin e rolit të tyre zhvillimor. Në nivel vjetor, deficitin buxhetor dhe borxhin publik nuk duhet të tejkalojnë në 3% dhe 60% prej BPV, me atë renditje. Në vitet kur ka arkëtim më të lartë të të ardhurave buxhetore, do të krijoheshin rezerva buxhetore, që vazhdimisht do të shfrytëzoheshin për investime më të mëdha publike kapitale, si dhe për ballafaqimin me sfidat dhe krizat e ardhshme. Krahas rregullave fiskale ligjore duhet që vazhdimisht të zbatohen të dy rregullat e arta – të mos ketë ngarkime me borxh publik për shpenzime publike si dhe investimet kapitale vazhdimisht të rriten nga deficitin i përgjithshëm buxhetor. Ngarkimet e reja me borxh në sektorin publik gjithnjë e më shumë duhet të bazohen në mekanizma dhe instrumente novatore financiare, siç janë obligimet tematike, që bazohen në analiza të arsyeshmërisë ekonomike, orientimit drejt një përparimi të caktuar në domenin e prioriteteve strategjike dhe transparencës dhe llogaridhënies së lartë për mjetet e shfrytëzuara.

Mobilizimi i kapitalit privat dhe përkrahja nga partnerët zhvillimor Institucionet ndërkombëtare, investuesit privat dhe institucionet financiare, janë tejet të rëndësishme për realizimin e qëllimeve zhvillimore dhe prioriteteve strategjike të SKZH. Parimi kryesor i mobilizimit të kapitalit privat për qëllimet e SKZH patjetër duhet të jetë mbrojtja dhe promovimi i interesit publik, veçanërisht te partneritetet publike-private dhe koncesionet për eksploatimin e resurseve natyrore. Në ekonominë e

tregut, nxitja e sektorit privat duhet të realizohet përmes partneriteteve publike-private, të mirave tatimore, subvencioneve, qasjes me pjesëmarrje gjatë miratimit të vendimeve dhe në përgjithësi ngritjen e përgjegjësisë korporative shoqërore.

Gjithmonë kur ka mundësi, rekomandohet inkuadrimi i kapitalit privat dhe partnerëve zhvillimorë përmes financimit të kombinuar (angl. “blended finance”) të burimeve publike dhe private për realizimin e projekteve dhe iniciativave në domenin e prioriteteve strategjike të SKZH.

Në përgjithësi, shkallët më të larta të rritjes inkluzive dhe të qëndrueshme, duhet të përkrahen nga një produktivitet më i madh faktorial dhe një aktivitet i fuqishëm investues, respektivisht bruto-investime, mesatarisht me mbi 25% të PBB-së vjetore gjatë dy dekadave të ardhshme.

Strategjia për tërheqjen e investimeve direkte të huaja, duhet të mundësojë një qasje të synuar, përmes dizajnit të ndihmës shtetërore, në pajtim me prioritetet strategjike të SKZH, strategjisë për specializim të mençur dhe strategji të tjera (shumë)sektoriale. Në kontekst të SKZH, inkuadrimi i sektorit privat mund të nxitet përmes hartave për investime sipas qëllimeve të SKZH dhe qëllimeve globale për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe promovimin dhe inkurajimin aktiv të përgjegjësisë shoqërore të kompanive. Përdorimi i fondeve publike për përkrahjen e sektorit privat duhet të jetë në drejtim të uljes së rrezikut dhe para se gjithash, rritjes së investimeve private në pajtim me prioritetet strategjike të SKZH. Kombinimi i burimeve publike dhe private duhet të realizohet përmes mekanizmeve dhe instrumenteve financiare tradicionale dhe gjithnjë e më shumë, novatore. Financimi novatore i zhvillimit duhet të sigurojë plotësim, shpeshherë edhe zëvendësim të burimeve dhe mekanizmeve tradicionale të financimit. Investimet e reja duhet të jenë gjithnjë e më shumë të bazuar në përkrahjen financiare përmes obligimeve tematike siç janë të gjelbrat, obligacionet sociale ose gjinore dhe obligacionet në lidhje me qëndrueshmërinë.

Ato bazohen në arritjen e një përparimi të caktuar (performancave) dhe/ose një dedikimi të definuar preciz të mjeteve të huazuara: garantëve dhe fondeve të tjera për përhajtimin e transformimit të gjelbër dhe digjital; partneritete novatore publike-private; financim të bashkuar; sipërmarrësi të qëndrueshme, etj.

Institucionet Financiare duhet të sigurojnë përkrahje të konsiderueshme për financimin e SKZH përmes “gjelbërimit” e sistemit financiar dhe zhvillimin e shërbimeve financiare në aspekt të qëllimeve dhe prioriteteve strategjike. Ulja e ekonomisë joformale në mënyrë shtesë do ta rris potencialin e institucioneve financiare. Gjithashtu, ekzistojnë shumë mundësi financiare për tërheqjen e fondeve ndërkombëtare, veçanërisht ato evropiane për kapital të sipërmarrjeve dhe për përkrahje të kompanive fillestare (startup-eve). Zhvillimi i sipërmarrësisë së qëndrueshme duhet të nxitet përmes një qasje më të madhe të financimit, njohurive të reja dhe kulturës së startup-eve, për çka nevojitet një fokus më i madh i sipërmarrësisë në arsimimin formal dhe joformal.

Financat, njohuritë dhe shkathtësitë e diasporës paraqesin një potencial të rëndësishëm, të pashfrytëzuar për zhvillimin e qëndrueshëm. Duke marrë parasysh se të ardhurat në para nga jashtë, fillimisht përdoren për konsum privat, është tejet e rëndësishme të krijohen edhe mekanizma novatore dhe instrumente financiare për tërheqjen e kapitalit të diasporës. Parakusht për këtë është ambienti i volitshëm i biznesit, që mes tjerash, do të karakterizohet me sundimin e së drejtës dhe menaxhimin e drejtë. Financat e diasporës kanë potencial që t'i përkrahin sipërmarrësinë dhe bizneset e vogla (p.sh. përmes projekteve me ndikim pozitiv shoqëror), për t'i inkurajuar investimet në sektorin publik (p.sh. përmes obligacioneve të posaçme për diasporën), ta nxisin zhvillimin e kapitalit njerëzor, etj.

Dinamika e integritimeve evropiane, gjithashtu në masë të madhe do të ndikojë në financimin e SKZH. Ndihma buxhetore dhe investuese e BE-së, si dhe shkalla e shfrytëzimit të tyre, direkt ndikon në financimin e prioriteteve strategjike. Në periudhën 2024-2027, Plani për rritjen e Ballkanit Perëndimor, i propozuar nga Komisioni Evropian, siguron 859 milion euro për Maqedoninë e Veriut. Ndikimi indirekt do

të ndihet përmes kapaciteteve të rritura institucionale në nivel qendror dhe lokal për aplikimin dhe absorbimin e fondeve evropiane. Rekomandohet që të përcaktohen synime afatmesme për shfrytëzim minimal (tërheqje) të fondeve të BE. Shfrytëzimi i rekomanduar i fondeve para aderuesve të BE-së është minimum 75% ndërsa pas vitit 2030, rekomandohet që të shfrytëzohen minimum 85% të fondeve kohezive të unionit që janë në dispozicion.



9. MENAXHIMI ME RREZIQET

Rreziqet paraqesin potenciale ose shmangja e ardhshme me rezultatet e pritshme dhe udhëzojnë në pasigurinë me të cilën mund të ballafaqohet Maqedonia e Veriut gjatë realizimit të qëllimeve të saja afatgjata dhe afatshkurta në implementimin e SKHZ. Gjatë realizimit të SKZH, u morën parasysh aspektet e ndryshme të sfidave me të cilat vendi do të orientohet për realizimin e qëllimeve kombëtare, e në kuadër të këtij procesi, janë shqyrtuar rreziqet e llojeve dhe prejardhjes së ndryshme që dalin nga gjendjet e ndryshme nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, që mund të dalin nga burimet e brendshme dhe të jashtme. Rreziqet e përcaktuara mund të vlerësohen dhe të grupohen në bazë të natyrës së tyre dhe sferës që kanë ndikim. Për t'u realizuar ndryshime të qëndrueshme në secilën kategori, nevojitet një qasje e përshtatur që përfshinë faktorë të ndryshëm, përfshirë edhe Qeverinë, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Rreziqet kyçe, që u potencuan në veçanti gjatë analizave, diskutimeve dhe punëtorive të shumta të realizuara me palët e interesuara dhe që kanë vlerë të madhe kombëtare dhe potencial të konsiderueshëm që ndikojnë në zhvillimin afatgjatë, janë si vijon:


- Shfrytëzimi jo i mjaftueshëm dhe erozioni i kapitalit njerëzor dhe rrezikut afatgjatë për ekonominë, sepse në atë mënyrë ulet produktiviteti dhe konkurrenca, rritet papunësia, ndërsa përkeqësohet përgjigja e ndryshimeve në tregun global.
- Korniza kombëtare për menaxhim të drejtë të disa aspekteve ende karakterizohet me mungesë transparence, llogaridhënie dhe efektiviteti. Kjo situatë, e plotësuar me shkallën e konsiderueshme të politizimit të shoqërisë, e rrit mundësinë për udhëheqje joefikase/miratimi i vendimeve dhe paraqet rrezik për stabilitetin dhe efektivitetin e sistemeve menaxhuese dhe për implementimin e suksesshëm të SKZH.
- Shkalla e lartë e cenueshmërisë në raport me shokun e jashtëm, që në një ekonomi të vogël dhe të hapur, dukshëm mund t'i ndryshojnë sfidat socio ekonomikë dhe më tej të ketë implikime potenciale për prioritetet e përcaktuara zhvillimore dhe reformuese.
- Korrupsioni dhe efektiviteti i ulët i gjyqësisë, administratës dhe procedurës gjyqësore mund të sjellë deri te rezultate të pavolitshme politike, pakënaqësi të shtuar publike, humbje potenciale financiare ose shpërndarje të gabuara dhe keqësim të mëtejshëm të sigurisë juridike.

Në rreziqe të matura, që gjithashtu kanë rëndësi adekuate politike dhe potencial të konsiderueshëm për të ndikuar në zhvillim, bëjnë pjesë:

- Fokusi momental ekonomik ndaj përfitimeve afatshkurta mund të cenojë qëndrueshmërinë dhe rezistencën afatgjate dhe potencialisht të sjellë jo stabilitet ekonomik dhe degradim të ambientit jetësor.
- Ekzistimi i lëshimeve në standardet e menaxhimit paraqet një rrezik të konsiderueshëm për rrënimin e besimit publik, mungesës së llogaridhënies, praktikave potenciale korruptive dhe uljes

së jo efikasitetit të politikave publike që më tutje do të krijojnë kufizime në realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve.

- Rreziku nga mospërshtatja sociale dhe barra e shtuar ndaj infrastrukturës urbane si rezultat i lëvizjeve demografike në kombinim me vështirësitë për krijimin e vendeve të mjaftueshme të punës, ka mundësi potenciale për të përkeqësuar pabarazinë dhe për të rritur tensionet socio-ekonomike dhe rëndimin e tepërt të sistemeve urbane.
- Mungesa e bazave adekuate me të dhëna dhe regjistra paraqet një rrezik të konsiderueshëm për miratimin efektiv të vendimeve dhe për zbatimin e politikave. Kjo mungesë mund të sjellë deri te menaxhimi joadekuat me informata, që rezulton me planifikim të keq, strategji jofunksionale dhe me mossakses potencial për menaxhim dhe propagim të politikave.
- Ndryshimet në strukturën demografike dhe trendët në rritje të migrimit të fuqisë punëtore shkaktojnë brengë të madhe për shkak të mungesës së kuadrit të arsimuar sipas nevojave të tregut në sektorë kyç. Ata paraqesin kërcënim për ofrimin e shërbimeve dhe efikasitetin operativ.
- Shkalla e lartë e informalitetit në rrjedhat ekonomike paraqet uljen e besimit të sistemit të tregut, kufizimin e efikasitetit të politikave dhe reformave, pamundëson përcaktimin dhe menaxhimin me resurset kombëtare dhe ndikon në stabilitetin fiskal të vendit.
- Sigurimi i burimeve të financimit në pajtim me drejtimit e definuar zhvillimore dhe prioritetet e SKZH, veçanërisht në sigurimin e financimit adekuat dhe harmonizimit të strukturës buxhetore me proceset reformuese të sektorëve ku nevojiten burime të konsiderueshme të mjeteve siç janë shëndetësia, mbrojtja sociale, arsimimi, transformimi i gjelbër, infrastruktura dhe zhvillimi rajonal.
- Krizat, shokët dhe rreziqet globale që mund të jenë të natyrës së ndryshme: energjetike, klimatike, financiare, shëndetësore dhe të sigurisë.
- Janë përcaktuar edhe rreziqet që janë më pak të mundshme, por prapë se prapë mund të ndikojnë dukshëm në zhvillim:
- Mungesa e vullnetit politik, llogaridhënies, si dhe mekanizmave të mira të vlerësimit/monitorimit të realizimit të SKZH mund të sjellë rrezik të rrënimit të kapacitetit të qeverisë dhe përgjegjësisë fiskale. Kjo mund të sjellë deri te realizimi joefikas i reformave dhe ta rrezikojë harmonizimin e shtetit me agjendën e BE-së dhe ta pengojë rrugën e saj drejt zhvillimit.



Ballafaqimi me rreziqet

Rreziqet ekonomike dhe të tregut janë pjesë e rreziqeve që kanë ndikim më të madh ndaj zhvillimit të ardhshëm kombëtar e njëherë me gjasë edhe të realizohen. Për t'u adresuar këto rreziqe, nevojiten politika të forcimit të shkathtësive, diversifikimi i tregut dhe për krijimin e praktikave konkurruese afariste. Me rëndësi është që të sigurohet përkrahje e fuqishme e institucioneve dhe të realizohen reforma adekuate institucionale në lidhje me menaxhimin e drejtë dhe me ballafaqimin me rreziqet politike. Në aspekt të rreziqeve demografike dhe sociale, janë të domosdoshme disa politika që e përkrahin zhvillimin e barabartë rajonal dhe do të krijojnë vende të punës për të gjithë. Reformat në gjyqësi kanë rëndësinë më të madhe për ballafaqim me rreziqet e sistemit juridik, e si rezultat i tyre do të përmirësohet, llogaridhënia dhe sundimi i së drejtës në vend. Kur bëhet fjalë për sfida në lidhje me menaxhimin me të dhëna dhe me infrastrukturën, rëndësi të posaçme ka investimi në sistemet gjithëpërfshirëse të të dhënave që krijojnë një bazë solide për miratimin e vendimeve të bazuara në informata/të dhëna adekuate. Ballafaqimi me këto rreziqe përmes strategjive të posaçme mund të sjellë përmirësime të konsiderueshme në stabilitetin ekonomik, kualitetin në menaxhim/menaxhment, kohezionin shoqëror dhe besimin në institucione. Në mënyrë shtesë për krijimin e ndryshimeve të qëndrueshme dhe afatgjate është kyçe që krijuesit e politikave, sektori privat dhe shoqëria civile të investojnë përpjekje të posaçme të përbashkëta të bashkëpunimit. Rreziqet që kanë ndikim të caktuar i përfshijnë problemet ekonomike dhe infrastrukurore me të cilat mund të menaxhohet përmes investimeve strategjike dhe strategjive financiare për amortizimin me ndryshimet e tregjeve. Për sfidat demografike dhe sfidat në lidhje me fuqinë e punës, nevojiten politika për zhvillimin e kapitalit njerëzor, ruajtje dhe tërheqje të resurseve kualitative njerëzore. Mungesat në sistemet e menaxhimit dhe legjislaturë imponojnë nevojën për miratimin dhe realizimin e zgjidhjeve ligjore gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme, në bazë të parimeve të menaxhimit të drejtë. Optimizimi dhe ballafaqimi me rreziqet në lidhje me administratën publike mund të bëhet duke krijuar sisteme për ndjekje të suksesit, kornizës për zhvillimin e kapaciteteve, krijimin inkluziv të politikave dhe shkallës së lartë të digjitalizimit.

Korniza gjithëpërfshirëse për ballafaqim me sfidat dhe rreziqet kombëtare paraqet Strategji Kombëtare Zhvillimore (SKZH).

SKZH përfshirë edhe qëllimet dhe prioritetet e caktuara në fakt paraqet një bazë dhe mjet për ballafaqim me sfidat dhe rreziqet kyçe kombëtare në secilën sferë strategjike. Së këndejmë zbatimi i suksesshëm i SKZH ka rëndësi kyçe për adresimin e secilit rrezik të zbuluar duke krijuar një bazë të fuqishme për zhvillim afatgjatë kombëtar.

Gjatë implementimit të SKZH, secili institucion përgjegjës në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive do t'i përcaktojë dhe analizojë rreziqet dhe do të krijojë qasje të menaxhimit me të njëjtat. Konstatimi i hershëm i rreziqeve është kyç për minimizimin e ndikimit të tyre. Së këndejmë do të nevojitet që të integrohen sistemet e vlerësimit dhe parashikimit të hershëm në secilën sferë strategjike në kornizën e zbatimit të SKZH, me qëllim të krijimit të sistemit për menaxhimin optimal me rreziqet.

Kjo strategji publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ANEKS

Qëllimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim për vitin 2044

Përforsimi i konkurrencës dhe zhvillimi i vendit përmes ekosistemit funksional dhe novator, përsosja e shkathtësive, njohurive, përfshirja e rezistencës së qytetarëve



	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044
Indeksi i inovitetit në Evropë (përqindja e mestares evropiane)	46,3% (2023) Inovator në zhvillim	75% Inovator mesatar	110% Inovator i fuqishëm
Eksporti i teknologjisë së lartë (% e eksportit total të produkteve industriale)	4,18% (2020)	5%	7%
Indeksi i kapitalit njerëzor	0,56 (2020)	0,7	0,8
Produktiviteti i punës	20,64\$ (2021)	30\$	40\$

Modelet e menaxhimit që janë të hapura, llogaridhënëse dhe të forta, të afta për të parandaluar dhe për të reaguar në mënyrë adekuate, duke nxitur prosperitetet për të gjitha grupet shoqërore



	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044
Indikatorë për qeverisje të mirë (Banka Botërore)	0,1 (2022)	0,7	1,5
Indeksi për perceptimin e korrupsionit	-0.35 (2021)	0.06	0.72
Nivele mesatare vjetore të grimcave atmosferike (PM2.5 dhe PM10) në qytetet (të ponderuar sipas numrit të popullsisë)	25,17 (2019) mikrogramë për metër kub	18 mikrogramë për metër kub	12 mikrogramë për metër kub
Përqindja e popullsisë që përdor ujë të pastër përmes furnizimit të sigurt me ujë	77 (2020)	83	90

Përfshirja sociale që nënkupton sisteme të përmirësuara sociale, shëndetësore dhe arsimore në drejtim të sigurimit të dobive për individët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi.



	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044
Indeksi i zhvillimit njerëzor	0,770 (2021)	0,850	0,910
Koeficienti i pabarazisë së të ardhurave (koeficienti i Xhinit)	33,5% (2019)	30%	25%
Aktiviteti i grave në tregun e fuqisë punëtore në lidhje me aktivitetin e grave në tregun e fuqisë punëtore (në %)	66,2% (2022)	75%	85%

Fusha strategjike: Ekonomia e qëndrueshme, novatore dhe konkurruese

Ekonomia e bazuar në njohuri, inovacione dhe digjitalizim



Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ
PBV për kokë banorë në euro	7.115 (2022)	8.000	12.000	2.2, 8.1.1,
Rritja e PBV-së (% në nivel vjetor)	2,4% (2023)	4%	5%	2.2, 8.1.1,
Shfrytëzimi i kapaciteteve	73,9%	85%	100%	8, 9
Rritja e PAK për kokë banorë (% në nivel vjetor)	5,18%	7,5%	8%	8, 9

Ekonomia e integruar fuqishëm në tregtinë ndërkombëtare dhe financat ndërkombëtare

Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ
Indeksi për penetrim në tregjet eksportuese	4,19 (2021)	5	7	8,9
Tregtia (% nga PBV)	140,4% (2021)	170%	200%	8, 9
Indeksi për performansa ligjistike	3,1 (2023)	3,7	4,2	9.1.2.1

Fuqia punëtore që i përmbush nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës


Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ
Konsumi bruto vendor i hulumtimit dhe zhvillimit, si përqindje e PBV-së	0,38 (2020)	0,7	1,2	9.5.1
Shkalla e punësisë	45,7% (3Q 2023)	52%	60%	2.2, 8.1.1,

Fusha strategjike: Zhvillimi i qëndrueshëm dhe rajonal që siguron kohezion

Pabarazi të zvogëluara ndërmjet rajoneve



Infrastruktura kapitale në funksion të një jete më të mirë/Njerëzit kanë dobi nga infrastruktura e rezistueshme kapitale



Komuna të qëndrueshme funksionale dhe fiskale

Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ për Maqedoninë
 <p>Balanca e migrimeve</p>	<p>1.381 (2022) -0,481 për 1000 kokë banorë</p>	2.000	3.000	10.7.2
 <p>Indeksi i presioneve demografike (10,0)</p>	4,2 (2023)	3	2	10.7.2

Fusha strategjike: Revitalizimi demografik dhe zhvillimi social dhe kulturor

Lëvizjet e balancuara dhe të qëndrueshme demografike




Njerëz të shëndoshë dhe të lumtur



Identiteti i njohur kulturor dhe vlera



Sistemi inkluziv dhe efikas i mbrojtjes sociale dhe sigurisë sociale



Shoqëri e bazuar në njohuri, të menduarit kritik dhe vlerat



Fusha strategjike: Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë


Sundimi i ligjit dhe parimi i zbatuar në mënyrë konsekuente i ndarjes së pushtetit dhe kontrolli parlamentar efektiv



Sektor publik transparent, llogaridhënës dhe efikas



Zero korrupsion, siguri juridike dhe drejtësi joselektive



Mbrojtja efikase e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe mbrojtja e komuniteteve


Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ për Maqedoninë
Indeksi për të drejtat e njeriut sundimit të ligjit (10:0)	2,7 (2022)	1,5	1	
Lirë të civile (7:1)	3 (2020)	2	1	

Media të lira dhe të pavarura

Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ për Maqedoninë
Statusi global i lirisë	68/100 (2022)	72	85	

Fusha strategjike: Shoqëri e sigurt, e mbrojtur dhe rezistente

Shoqëri që është e rezistente ndaj krizave dhe fatkeqësive



Shoqëri dhe komunitete neutrale dhe të rezistueshme ndaj klimës




Siguria integrale është çelës për sfidat lidhur me sigurinë dhe politikën e jashtme



Fusha strategjike: Transformimi i gjelbër

Shoqëria neutrale ndaj klimës me përqindje të ulët të varfërisë energjetike



40 <https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/07015e39ea890385d9fb9786be635fa574f1313f56f64879be43002c9a8f6b7c.pdf>

41 https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/T2020_RD310/default/table?lang=en

Mjedis i shëndoshë dhe i pastër jetësor

Tregues	Gjendja aktuale	Vlera afatmesme 2034	Vlera e synuar 2044	Lidhshmëria me treguesit e QZHQ për Maqedoninë
---------	-----------------	----------------------	---------------------	--



Përqindja e popullsisë urbane e cila është e ekspozuar ndaj përqendrimeve të substancave ndotëse (SO₂, PM₁₀, HE₂), që e tejkalojnë nga kufiri/vlerat e synuara

- 3% e popullsisë është ekspozuar ndaj përqendrimeve të dioksidit sulfurit që e tejkalonin 125g/m³ në vitin 2008 dhe 2009
- PM₁₀ – vërehet se gjatë gjithë periudhës nga viti 2004 deri në vitin 2021, 100% e popullsisë është ekspozuar ndaj përqendrimeve të grimcave të suspenduara që edhe atëherë e tejkaluan kufirin ditor mesatar prej 50g/m³.
- NO₂ – në periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2021, nga 0 deri 69% e popullsisë është ekspozuar ndaj përqendrimeve të dioksidit azotit ose mbi gjithçka që është mbi vlerat kufitare për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

0/20/20

0/0/0 % (SO₂, PM₁₀, HE₂)
Statusi i lartë ekologjik i lumenjve dhe liqeneve, nga të cilat 30% janë mbrojtur, nuk ka popullsi të ekspozuar ndaj zhurmës që e tejkalon vlerën e rekomanduar

G5, G2

Mbeturina që është gjeneruar, ricikluar ose mënjeluar nga deponia

Sasia vjetore e mbeturinës së gjeneruar komunale për kokë banor në vitin 2022 është 487kg
Përqindja e mbeturinës së ricikluar komunale është rritur dhe është 1,97% në vitin 2021, 0,7% e mbeturinës komunale u riciklua.

10% qëllim për parandalimin e krijimit të mbeturinës së ngurtë në nivel komunal
40% të ricikluar
80% të mbeturinës të mënjeluar në deponinë sanitare

30% qëllim për parandalimin e krijimit të mbeturinës së ngurtë në nivel komunal
65% ricikluar
30% përqindje më e lartë e mbeturinës totale komunale që duhet të mënjanohet në deponinë



Bilanci vjetor i tregtisë me agrourshqim

38% (2021)


30%

15%

2.1.1, 2.1.2, 2.3.1, 2.3.2, 8.4.1, 8.2.2

TREGUES PËR DIGJITALIZIM

Shoqëri e përparuar digjitale



Burimet:

<https://drmkc.jrc.ec.europa.eu/inform-index/INFORM-Risk/Country-Risk-Profile>

<https://drmkc.jrc.ec.europa.eu/inform-index/INFORM-Climate-Change/INFORM-Climate-Change-Tool>

<https://data.footprintnetwork.org/#/countryTrends?cn=154&type=BCpc,EFCpc>

1 ITU Report – Digital Skills Assessment - Herth Macedonia, December 2021

43 DESI

44 DESI max

45 ITU Report – Digital Skills Assessment - Herth Macedonia, December 2021

46 DESI

47 DESI max

48 eGovernment-Benchmark-2022

49 eGovernment-Benchmark-2022

50 eGovernment-Benchmark-max



Emri i shtypshkronjës:

DATAPOINT BMG

Titulli i botimit:

“Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2024 – 2044”

Përkthimi:

BESTEL

Lektura:

BESTEL

Fotografitë në pronësi të

Agjencisë për Promovimin dhe
Mbështetjen e Turizmit

Dizajni:

4Virtus

Viti i botimit dhe shtypjes:

Janar 2025

Vendi i botimit:

Shkup



SKENONI PËR MË SHUMË
INFORMACION



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

